# MAQEDONIA:

# NUK KA VEND PËR VETËKËNAQËSI

23 tetor 2003

international
crisis group

Raporti i ICG-së për Evropë, N°149
Shkup/Brisel

# TABELA E PËRMBAJTJES


**RAPORTI PËRMBLEDHËS DHE REKOMANDIMET** ........ i

**I. HYRJE** ........ 1

**II. POLITIKA DHE KUFIJTË E KAPACITETEVE SHTETËRORE** ........ 4

A. Dyshimet E Përbashkëta Dhe Ministria E Punëve Të Mbrendshme ........ 6

B. Shqipëtarët Dhe Autoritetet Shtetërore ........ 7

C. Luenjtë Ulurisin Përsëri ........ 8

D. Dera E Politikës Dhe Eufor/Konkordia ........ 8

E. Elementet E Misionit Të Suksesshëm Të Sigurisë ........ 10

**III. MOSKËNAQËSITË EKONOMIKE** ........ 12

A. Identiteti Dhe Vështirësitë Për Punë ........ 14

**IV. KORUPCION DHE KRIMI I ORGANIZUAR** ........ 16

A. Fushata E Anti Korrupcionit: Shkatërrim Apo Lojë Politike? ........ 16

B. Nevoja Për Pavarësi Më Të Madhe Të Gjyqeve ........ 18

**V. DECENTRALIZIMI DHE KUFIJTË KOMUNAL** ........ 19

A. Qasje E Centralizuar Ndaj Decentralizimit ........ 20

B. Ligji Për Kufijtë Komunal ........ 23

**VI. MARRËDHËNIET NDËR ETNIKE** ........ 25

A. Pas Konfliktit ........ 25

B. Suksesi Zhgënjyes I Kthimit Të Refugjatëve ........ 26

C. Kontestet Shkollore ........ 27

D. Tensionet ndërmjets shqiptarëve dhe turqve ........ 28

E. Ballafaqimi Me Trashigiminë E Vitit 2001 ........ 29

F. Roli I Dy Liderëve ........ 31

1. Qasja prej fillimit e Cërvenkovskit ........ 32

2. Stili i butë i Ahmetit ........ 33

G. Kërcënimi Prej Xhaferit And Thaçit ........ 34

H. Nikolla Gruevski Dhe VMRO-DPMNE "Ere" ........ 35

**VII. PËRFUNDIM** ........ 36

**SHTESAT**

A. KRONOLOGJIA E INCIDENTEVE TË MËDHA TË SIGURISË ........ **37**

B. HARTA E MAQEDONISË ........ **41**

C. LIDHUR ME GRUPIN NDËRKOMBËTAR TË KRIZËS ........ **42**

D. RAPORTET E ICG DHE DOKUMENTET E INFORMIMEVE TË SHKURTA ........ **43**

E. ANËTARËT E KËSHILLIT TË ICG ........ **49**

ICG
international crisis group

**Raport i ICG-së për Evropë, N°149** **23 tetor 2003**

# MAQEDONIA: NUK KA VEND PËR VETËKËNAQËSI

## RAPORTI PËRMBËLEDHËS DHE REKOMANDIMET

Ndodhitë më të vonshme kërkojnë që krijuesit e politikës të revidojnë në mënyrë thelbësore vlerësimin konvencional që Maqedonia është nga pikëpamja politike "tregimi (storia) më i suksesshëm" në gadishullin Ballkanik. Në të vërtetë, Maqedonia edhe më tutje mbetet një shtet post konfliktuoz me zbatim të dobët, si edhe më tutje mbetet si shtet me rrezik të madh. Maqedonia mbetet e paaftë që të ndikojë -- operacionalisht ose politikisht -- që t'ju përgjigjet plotësisht sfidave të saja të sigurisë pa e çrregulluar baraspeshimin etnik të pasigurtë. Vetëm se analizat e qarta dhe themelore të dinamikës se shqetësimit që po vazhdon në Maqedoni -- prej kriminalitetit dhe politikës së dobët deri tek e njejta ekonomi e dobët dhe korrupcioni -- do ti lejojë shtetit që për shumë pak evitoi luftën para dy viteve që të sigurojë stabilitet afatgjatë. Të jemi më specifik, Maqedonia edhe më tutje nuk mundet që të veprojë pa prezencën e forcave ndërkombëtare të sigurisë.

Është e vërtetë se qeveria e re e moderuar e Maqedonisë, e udhëhequr nga Kryeministri Branko Crvenkovski dhe nga ish udhëheqësi i rebelëve (kryengritësve) Ali Ahmeti, ka patur suksese. Që të dy këta njerëz i mbeten besnik marrëveshjes paqësore të Ohrit dhe unitetot të shtetit. Që kur ata i fituan zgjedhjet e vitit 2002, Maqedonia ka eksperiencuar një freskim të dukshëm të retorikës dhe të zërit (tonit). Crvenkovski dhe Ahmeti janë sjellur me përgjegjësi dhe, kohë pas kohe, madje edhe me trimëri në një sëri të çështjeve të ndijshme, përfshirë këtu edhe legalizimin e Univerzitetit të Tetovës (për një kohë të gjatë simbol i tensioneve etnike) si edhe për përdorimin e gjuhës shqipe edhe në Parlament edhe në pasaportën shtetërore. Gjithsesi, ky përparim në çështjet simbolike nuk ka qenë i ndjekur edhe në çështjet thelbësore. Reformat në sektorin e sigurisë kanë mbetur shumë mbrapa, si edhe decentralizimi dhe tentimet për të zmadhuar numrin e shqipëtarëve në sektorin public -- dy komponentat kryesore të marrëveshjes së Ohrid. Shkatërrimi lidhur me korrupcioni nË nivel të lartë ka ngecur.

Shumë seriozisht, edhe kriminelët edhe ekstremistët edhe më tutje vazhdojnë të paraqiten si kërcënues të drejtëpërdrejtë. Policia mënyrë të dukshmë është duke reflektuar përbërjen e popullatës vendore, por ata edhe më tutje po mundohen që të imponojnë ligjin dhe rendin publik. Vrasjet janë shtuar më shumë se një e treta në krahasim me tre vitet e kaluara dhe një varg i eksplodimeve të bombave, kidnapimeve si edhe plasarritjeve me armë janë shtuar në aspektin e paligjësisë. Komunikimi i vobegët për çështjet e sigurisë shpesh herë ka ushqyer tensionet etnike mbrenda në qeveri si edhe midis komuniteteve, e kjo më shume se ndonj dhune të organizuar "pan -- shqipëtare", është rreziku më i madh aktual për stabilitetin.

Këta çështje u dukën në pah në fillim të shtatorit të vitit 2003 kur policia ndërmorri një aksion të rëndë dhe të pasuksesshëm për të zënë një rebel famëkeq shqipëtar gjë që e hidhëroi shumë Ali Ahmetin, duke e lënë atë politikisht të eksponuar dhe me këtë edhe u paraqit konfrontimi intern më serioz mbrenda qeverisë. Sa edhe për më tepër, ky aksion nuk ndihmoi shumë për rritjen e sigurisë të Maqedonisë. Rebeli edhe më tutje është në liri dhe, përkrahas tentimeve që të jenë në përputhshmëri me çështjet e ndijshme lokale, shumica e shqipëtarëve kanë zhvilluar reafirmimin e dyshimit madje edhe ndaj forcave të përziera policore.

Sipas një ankete rë paradokohshme të bërë nga Kombet e Bashkuara (UN), dy të tretat e plota të maqedonasve dhe të shqipqtarëve presin përsëri më tepër konflikte dhe shfaqin brengosjen e tyre për stagnimin e ekonomisë. Ata që punojnë në shpërndarjen e ndihmave përshkruajnë polarizimin edhe më të madh të komuniteteve etnike në rajon e ish krizës, pasiqë ata edhe më tutje vazhdojnë të ballafaqohen me taktikat e ndryshme të presioneve. Mosmarrëveshjet e hidhëta lidhur me shkollat kanë vë në sfidë ndërhyrjen dhe kanë shfaqur qartë ndarjet e vazhdueshme etnike. Papunësia edhe më tutje mbetet shumë e lartë dhe ka krijuar mundësi potenciale politike për udhëheqësit e paskrrupullt të punëtorëve që të nxisin prishje të rendit publik. Prospekti i

mëtutjeshëm i jo stabilitetit edhe më tutje ndikon që investimet e huaja të qëndrojnë më larg dhe me këtë të ngulfatet ekonomia.

Banorët etnik shqipëtarë kanë rezistuar edhe operacionet me qëllim të mirë dhe paraprakisht të lajmëruara të policisë dhe ndonjëherë edhe me mos plotësimin e pagimit të tatimeve, duke e nënvlerësuar ndjenjën e përgjegjësisë së përbashkët që është thelbësore për të patur sukses marrëveshja e Ohrit. Tensioni është në rritje të sipërt midis shqipëtarëve dhe turqve të religjionit të njejtë të cilët po frikësohen se marrëveshja e Ohrit nuk po dërgon kah një "shtet qytetar" por kah një shtet "bi nacional", shtet në të cilin do të dominojnë shqipëtarët dhe maqedonasit. Ish Kryeministri Lubço Georgievski dhe kryetari i PDSH-së Arben Xhaferi së bashku kanë shprehur dëshirë që të luajnë me shqetësimet (ankthet) dhe me armiqësitë, duke punuar haptazi për shkatërrimin e marrëveshjes së Ohrit dhe duke shkuar aq larg sa që kërkojnë ndarjen etnike të Maqedonisë.

Udhëheqësit e Maqedonisë dhe ndërrmjetësuesit ndërkombëtar shumë shpesh janë ballafaquar me sfidat shtetërore me një ndjenjë të vetëkënaqësisë. Në vend që të ballafaqohen me shpatullgjërësi radikalizmin e Georgievskit dhe Xhaferit, diplomatët në disa raste kanë luajtur rolin e apologjetëve të tyre. Afatet përfundimtare të Ohrit po kalojnë pa asnjë koment, dhe tentimet e rëndësishme siç është rirregullimi i vijës kufitare, dorrëzimi i fuqisë pushtetit lokal, si edhe shpallja e parashikuar e rezultateve të regjistrimit të popullatës në përgjithsi sjell tkurje. Shumë shpësh Kryeministri Branko Crvenkovski ka dështuar që në tërësi të ngërthejë mandatin e tij të gjërë zgjedhor dhe në vend të kësaj ai ka bërë implementimin e marrëveshjes së Ohrit në një lojë të shumës zero të bashkëbisedimeve. Ahmeti i moderuar ka toleruar edhe pakompetencën e ministrave të tij partiak dhe është duke vërrejtur se "autoriteti" i tij në mesin e popullatës ka degraduar në masë të madhe. Disa nga simpatizuesit e tij dyshojnë se Kryeministri e bën këtë me qëllim që të krijojë imazh të keq për partinë e tyre.

Mungesa e tentimeve me më shumë brengosje për të implementuar dhe për të përqafuar me të vërtetë marrëveshjen e Ohrit, vendosjes së rendit publik dhe sgtetit ligjor, lufta kundër korrupcionit dhe stimulimi i ekonomisë, mundet shumë lehtë të shparrtallojë qetësinë relative që është prezente. Misioni ushtarak i suksesshëm i Komunitetit Eurpojan "Konkordia" duhet të qëndroj në vend edhe pas datës së paracaktuar të 15 dhjetorit, përderisa në tërësi nuk vendoset misoni policor "Proxima", dhe derisa policia dhe qeveria e Maqedonisë nuk janë plotësisht të aftë të kryejnë operacione të suksesshme dhe të pengojnë rrëzimet politike. Maqedonia duhet të mbyllë dyert e trashigimisë të konfliktit të vitit 2001. Nuk egziston asnjë arsye për shtetin dhe për zyrtarët ndërkombëtar që të injorojnë nevojën pëv të vendosur një mekanizëm që të shqyrtojë mundësitë e shumta të rasteve të mundshme të krimeve të luftës dhe të ndërtojë kishat dhe xhamitë e rrënuara dhe të zgjedhë çështjen e njëzet njerëzve të zhdukur që edhe më tutje mbesin me status të tillë. Donatorët duhet gjithsesi të insistojnë që institucionet e mediumeve që janë në agoni të cilat ata i mbështesin të fillojnë të funkcionojnë, veçantërisht në lëminë e monitorimit në terren dhe të kontrollimit të fjalimit që shpreh urrejtje.

Gjithsesi, asnjë nga këta hapa muk duken sikur do të ndërmerren pa një vlerësim të vetëdijshëm dhe me më pak vetëlëvdata të të gjitha shënimeve egzistuese deri tani.

## REKOMANDIMET

### Të përgjithshme

1. Kryeministri Branko Crvenkovski dhe Kryetari Boris Trajkovski duhet të ngërthejnë secilën mundësi që kanë pët përqafuar në tërësi marrëveshjuen e Ohrit në emër të të gjithë qytetarëve e jo vetëm të bëjnë koncesione të plota për popullatën etnike shqipëtare. Kryeministri Branko Crvenkovski duhet të ndërpresë praktikën e tij të vejë obligimet më të rëndësishme nga marrëveshja e Ohrit në shkallën zero të negociatave me Kryetarin e BDI-së Ali Ahmetin.

2. Kryetari i BDI-së Ali Ahmeti duhet të intenzifikojë tentimet e tij që të ndërtojë një respekt të plotë të shqipëtarëve ndaj autoriteteve shtetërore, përfshirë këtu edhe pagimin e tatimeve, pagesave për shërbimet dhe obligimeve të tjera.

3. Që të dy, edhe Branko Crvenkovski edhe Ali Ahmeti duhet të theksojnë decentralizimin e qeverisë si pika më e rëndësishme e marrëveshjes së Ohrit, të largohen nga punësimet (emërtimet) joefektive të anëtarëve të partive të tyre politike, veçantërisht të atyre që pengojnë decentralizimin dhe reformat ekonomike, duke u munduar që të përmirësojnë komunikimin midis ministrave të njërit komunitet etnik dhe zëvendësve të tyre nga komuniteti tjetër etnik.

**Siguria**

4. Kryetari Boris Trajkovski dhe Kryeministri Branko Crvenkovski duhet të ndryshojnë insistimin e tyre që misioni ushtarak Komuniteti Europjan "Konkordia" të largohet në ditën e kalimit të afatit të tij në dhjetor të vitit 2003 dhe që misioni të qëndrojë në vend derisa në tërësi nuk vendoset misoni policor i Komunitetit Europjan "Proxima", dhe derisa policia dhe qeveria e Maqedonisë nuk janë plotësisht të aftë të kryejnë operacione të suksesshme dhe të pengojnë rrëzimet politike.

5. Qeveria duhet të rezistojë që të ngjyrosë me ngjyrë shumë të bardhë fotografinë për gjendjen e sigurisë për shkak të frigës se konkurimit të Maqedonisë për anëtarësim në NATO, dhe duhet urgjentisht një mënyrë të qartë dhe komprehensive të njoftimit dhe të konsultimit, përfshirë këtu edhe BDI-në në operacionet më të mëdha të sigurisë, të vazhdojnë të implementojnë reformat e rekomanduara ndërkombëtare të sigurisë, dhe të vejnë theks të veçantë në çështjes së sjelljes dhe punës së policisë.

6. NATO duhet të vazhdojë edhe më tutje rolin mbështetës për misionin "Konkordia" si edhe për misionin e propozuar policor "Proxima" që duhet të vendoset në dhjetor të vitit 2003. NATO duhet qartë të mos e lidhë prezencën e "Konkordi"-së ose të cilit do qoftë mision të sigurimit ndërkombëtar nga çështja e anëtarësisë së Maqedonisë në NATO, ndërsa Uashingtoni duhet që edhe formAlisht të njohë se pas pjesëmarrjes së Shkupit në që të dy misionet në Afganistan dhe në Irak, të konsidërojë Maqedoninë si "kontribues të sigurisë" (jo si një "shfrytëzues të sigurisë") për qëllime të anëtarësisë në NATO. Më tutje, NATO duhet të kërkojë të gjitha mënyrat e mundshme për të përshpejtuar anëtarësimin e Maqedonisë në këtë aliancë, edhe nëse ajo nuk arrin që të plotësojë të gjitha qëllimet e reformave. Më së fundi, NATO dhe Komuniteti Europjan duhet të ndërpresin garrën e tyre për dominim në ndihmën për sigurinë.

7. Si një mjet kritik për përforcimin e stabilitetit (të mbrendshëm dhe të jashtëm), qeveria dhe NATO-ja duhet të dyfishojë tentimet që të sigurojë që Maqedonia kualifikohet për hyrje në NATO jo më vonë se sa zgjerimi i ardhshëm i madh, nëse jo edhe më herët.

8. EUFOR-Konkordia duhet të kërkojë mundësi më të mëdha që të ndajë dhe transferojë përgjegjësinë me armatën e Maqedonisë. Patrullat e përbashkëta me njësitë maqedonase do të mundësonin që mos shkohet në varshmëri dhe të ndihmojnë të ndërtojnë besimin në forcat e armatosura të shtetit nga ana e shqipëtarëve.

9. Planifikimi për forcat e misonit të Komuniteti Europjan "Proxima" dhe të largimit eventual të "Konkordia", duhet ti drejtohet dobësive të vërteta dhe të qarta të punës policore, oërfhsirë këtu shkëmbimin e vobegët të informatave kundërzbuluese, komunikimit dhe koordinimit të dobët, kontrollit të madh të centralizuar, punën e dobët të kryer nga ekipet multietnike të policisë, dhe mbështetjes të mëtutjeshme në taktikat, dhe në veçanti për:

   (a) "Proxima" duhet tË planifikojë që aktivisht të ndihmojë në situatan në teren, e jo vetëm të monitorojnë;

   (b) EUMM (Misioni i Komunitetit Europjan për Monitoring) duhet që plotësisht të inkorporohet në strukturën mbrojtëse të Komunitetit Europjan dhe që në masë të madhe të marrë rolein e funksionit lidhës (ndërmjetsues) të krijuar nga NATO dhe që tani e luajnë si roj forcat e Komunitetit Europjan (EUFOR);

   (c) OSBE-ja duhet të bëje paraqitjen e saj politike si prioritet më të madh dhe të sigurojë që ushtrimet (trajnimet) e tyre jo vetëm që u përgjigjen kuotave por edhe që të krijojë nga ta kadetë të fuqishëm policor; dhe

   (d) Donatorët e tjerë duhet të kërkojnë mundësi për përmirësimin e mbledhjes dhe shpërndarjes të informatave.

**Ekonomia**

10. Kryeministri Branko Crvenkovski duhet të implementojë propozimin të dhënë nga komuniteti afarist dhe nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që të

formojë një grup pune në nivelin ministror që tju ndihmojë investitorëve kryesor të huaj të tejkalojnë pengesat administrative

11. Banka Kombëtare, me ndihmën e Bankës Botërore dhe Fondit Ndërkombëtar Monetar (FNM), duhet të bëjë një hulumtim thelbësor të huazimit të parave të bankave, të sigurojë që nuk egziston diskriminim në huazimin e parave ndaj popullatës etnike shqipëtare ose ndaj banorëve të Maqedonisë perëndimore dhe të ndihmojë me një plan të sigurohen investime në Maqedoninë perëndimore, për qëllim të përfitimeve të të gjithe etniciteteve që jetojnë atje.

12. Komuniteti Europjan duhet të lehtësojë regjimin e tij të vështirë të marrjes së vizave për udhëtim jashta shtetit, me qëllim që të ndihmojë papunësinë në Ballkan që të jetë burim i jostabilitetIt në rajon.

**Decentralizimi**

13. Qeveria dhe FNM duhet të përshpejtojnë rrugën e decentralizimit me implementimin e hapave afat-shkurtëra të identifikuara nga përfaqësuesi special i Komunitetit Europjan dhe Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për shembull për ridyfishimin e bashkëpunimit me Shoqatën e Bashkive të Maqedonisë (ZELS) për të shpejtuar pilot projektet për grumbullimin e tatimeve të pronësinë nga vetë komunat dhe të lejojnë që komunat të ndajnë lejet për ndërtim.

**Korrupcioni**

14. Banka Botërore, në bashkëpunim me OSBE-në dhe me ekipin e tyre për Shtetin ligjor, duhet të bashkohen me Komunitetin Europjan (KE) në marrjen e rolit udhëheqës në reformat e korrupcionit dhe ata ligjore, me.komuniteti ndërkombëtar që duhet të jape mbështetje materiale dhe politike për Komisionin kundër korrupcionit, në veçanti duke bërë presion mbi qeverinë që të pranojë Programin, me prioritet për rekomandimet e saja në ndërtimin e pavarësisë së sistemit luridik, përfshirë këtu edhe krijimin e institucioneve të reja për të zëvendësuar Këshillin e politizuar Republikan të Gjykatësve.

15. Gjykatat, mbrojtësit (avokatët) dhe prokuri publik duhet më rreptë të ndjekin rekomandimet e Komisionit lidhur me anulimin e privatizimit të Fershped-it, ku qeveria duhet të formojë një komision ekspertësh lidhur me skandalin bankier të piramidës së TAT-it dhe Ministri i ekonomisë duhet të japë një sqarim më të plotë për blerjet e karburanteve në kohën para fillimit të luftës në Irak nëpërmjet të Makpetrol-it.

16. Banka Botërore dhe Fondi Ndërkombëtar Monetar duhet të ryshqyrtojnë mundësinë që opracionet për shpërlarjen e parave të mos kaljonë në Maqedoni duke e ndjekur shembullin e Qipros për të hyrë në Komunitetin Europjan.

**Zhvillimet politike**

17. Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet edhe formalisht ti tërhjekin vërrejtjen Kryetarit të PDSh-së Arben Xhaferit, nënkryetarit të PDSh-së Menduh Thaçi edhe udhëheqësit të PPD-së Abdylmenaf Bexhetit dhe të tjerëve të cilët edhe më tutje publikisht mbështesin ndarjet etnike, opozIcionohen ndaj marrëveshjes së Ohrit dhe ndërmarrjeve private të lidhura me kriminalitetin dhe me ekstremistët që do të rezultonte me përfshirje në listat e azhuruara për tu vëzhguar. Ngjajshëm me këtë, vetëpërcaktimi duhet të anulohet edhe nga platformat e tyre partiake respektive. Grupet politike europjane duhet të përjashtojnë politikantët dhe partitë të cilat bashkëpunojnë me retorikën e ekstremistëve nga asociacionet e tyre në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës.

**Arsimi**

18. Prioritet duhet gjithsesi ti jepet edukimit të numrit të madh të të rinjve shqipëtar të cilët nuk kanë mbaruar shkollimin në shkollat e mesme, përfshirë këtu edhe trajnimet për vokacionin dhe të përsmirësimit, si edhe të tërhjekin femrën shqipëtare në edukimin e lartë, veçantërisht në Univerzitetin e Tetovës.

19. Kryetari i BDI-së Ali Ahmeti duhet të mbështesë reformat në Univerzitetin e Tetovës duke e kontrolluar ish rektorin që ëhtë tani si renegat, Fadil Sulejmanin, si edhe aleatin e tij,

Izahir Samiun (ish komandantin e UÇK-së "Komandant Baci"), të cilët përsëri po e pengojnë me masa kritike dhe komplikime procesin e legalizimit të këtij institucioni që gjatë kohë ishtë burim i ngatërresave.

**Përfaqsimi i banorëve shqipëtarë**

20. Qeveria dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të bëjnë prioritet prezencën e shqipëtarëve në tre sektoret më të rëndësishme të sigurisë: armatë, forcat speciale policore dhe në policinë secrete, që do të jenë në përputhje me kërkesat për njësitet speciale që të rekrutohen dhe ushtrohen edhe popullata etnike shqipëtare të cilët do të mundeshin, me ndihmë përkatëse, të bëhen kandidatë cilësor.

**Përmirësimi i marrëdhënieve ndër etnike dhe trashigimia nga konflikti i vitit 2001**

21. Komuniteti Europjan dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet plotësisht të mbështesin komisionin e përbashkët qeveritaro-parlamentar që të vërtetojë se ku gjenden njëzet personat të cilët edhe më tutje mbesin si të humbur, dhe Ministria e punëve të mbrendshme duhet të caktojë një afat të fundit në të cilin shqipëtarët duhet të japin informata për atë se ku gjenden të humburit maqedonas, pas të cilës ata duhet të japin të gjitha informatat lidhur që ka për shqipëtarët të cilët janë të humbur.

22. Qeveria duhet të përgadisë një listë përfundimtare dhe të pandryshueshme për personat që dyshohet se kanë kryer krime të luftës dhe të ftohet Tribunali i Hagut që të shqyrtojë këta raste dhe të theksojë përcaktimin e tyre se a thua ka baza për gjykimin e tyre.

23. Donatorët tjerë duhet të Bashkohen me Agjensionin për Rekonstruim të Komunitetit Europjan që të vazhdojë projektet tanimë të filluara për rindërtimin e objekteve religjioze të shkatërruara gjatë konfliktit me ndihmën dhe këshillat e UNESKO-s.

**Shkup/Brisel, 23 tetor 2003**

**Raport i ICG-së për Evropë, N°149** **23 tetor 2003**

# MAQEDONIA: NUK KA VEND PËR VETËKËNAQËSI

## I. HYRJE

Kur bëhet fjalë për Maqedoninë, qeveria dhe komuniteti ndërkombëtar pandërprerë e theksojnë vetëm atë që është positive. Diplomatët e kanë nënvlerësuar kërcënimin e konflikteve të mbrendshme dhe i lanë pas dore grupet ekstremiste etnike shqipëtare si të pakoordinuara dhe të izoluara. Komuniteti ndërkombëtar gjithashtu shpëjtoi shumë duke quajtur rishpërndarjen e policisë nën udhëheqjen e OSBE-së si një sukses të pakualifikuar.[1]

Maqedonia ka bërë tentime të rëndësishme në mbushjen e vakumit të sigurisë që mbet nga konflikti i vitit 2001. Numri i shqipëtarëve etnik në polici është rritur ngadalë, dhe monitorët në teren dhe këshilltarët policor të OSBE-së kanë bërë punë të madhe. Fshatarët shqipëtarë, të cilët instinktivisht kanë bllokuar edhe vetë mendimin për hyrjen e policisë në vitin 2002, tanimë në përgjithsi i mirësepresin patrolat multietnike dhe kanë rritur bashkëpunimin në tentimet e implementimit të ligjit.[2] Grupi Këshilltar i Qytetarëve (Citizen Advisory Groups) që është sponsoruar nga OSBE-ja ka bërë të mundur që të bashkojë qytetarët dhe policinë për të biseduar dhe për të zgjedhur brengat. Përkundrejt ankesave të pandërprera të prezencën e armatës, incidentet kufitare janë reduktuar.

Në një numër të caktuar të rajoneve, popullata shqipëtare dhe zyrtarët kanë kërkuar madje edhe për një prezencë më të madhe të forcave policore dhe kanë njohtuar që nevojiten ekipe mirë të armatosura që të ballafaqohen me kriminelët. Një kryetar komune theksoi që mungesa e policisë në komunë ishte komplot i maqedonasve me qëllim që në zonat shqipëtare të lulëzojë kriminaliteti.[3] Shumica e fshatarëve vendosën që të jenë larg tensioneve të 12 qershorit të vitit 2003 dhe qëndruar në anën e policisë në Haraçinë.[4] Rritja e numrit të shqipëtarëve në polici ka qenë gjithashtu njëlloj e rëndësishme edhe jashta rajoneve të ish konfliktit, në qytetet si Gostivari, Dibra, Kërçova dhe rreth Strugës dhe Ohrit.

Shumë nga lëvdatat për përmirësimet në marrëdhëniet me policinë duhet të drejtohen kah Ministri për Punë të mbrendshme Hari Kostov. Paraardhësi i tij, Lube Boshkovski, pothuajse provokonte konfrontimet me armë me banorët shqipëtar në më së paku tre raste të tilla,[5] dhe reputacioni i kësaj ministrie vuajti shumë si pasojë e veprimeve të tija dhe të atyrë të forcave speciale, të Luenjve. Kostov, një ish bankier, ka qenë një reformator aktiv. Në një situatë me fshatarët në afërsi të fshatit Vejce, ai u dha shenjë helikopterëve dhe mjeteve të tjera tradicionale për "zgjedhjen" e problemeve, u ul me banorët vendor shqipëtar dhe

---

[1] Në janar të vitit 2003, për shembull, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk pranoi sygjerimet që situate e sigurisë në vend mbetet edhe më tutje delikate. Pwr shembull, "Unë, në të vërtetë, jam i dëshpëruar nga shumë raportet që po lexoj në shtypin ndërkombëtar për atë se sa delikate është situate dhe sa afër Maqedonia po shkon përsëri nga konflikti", tha Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Lorens Batler në një konferencë shtypi në 29 janar të vitit 2003.

[2] "Gadishmëria e qytetarëve që të kërkojnë ndihmë policore kur ka të bëje me dhunën" ishte pika e vetme positive në nje listë të nëndë treguesve siç janë siguria në punë, kriminaliteti, korrupcioni dhe papunësia në raportin e prillit të vitit 2003. Anketa e UNDP-së e udhëhequr nga BRIMA, për afërsinë e maqedonasve të Gallup International dge e botuar në "IRJ Maqedonia: Raporti i hershëm që tërheq vëmendjen", më tutje me emër raporti i UNDP-së. C Shiko faqen (UNDP Early Warning Report, p. 9). Sipas Ministrit të Mbrojtjes Vlado Buçkovskit, armata po sheh qartë një përmirësim të bashkëpunimit me popullatën vendore dhe përmirësimit të sigurisë në kufijtë. Shiko "Popullata vendore në Pollog bashkëpunon me ta (Armatën) përsëri", Dnevnik, 10 korrik 2003.

[3] ICG intervistë, Bogovinjë, janar 2003.

[5] Në Trebosh, afër Tetovës në nëntor 2001; me festën provokuese të Luenjve në janar 2002, me rritjen e tensionit në ish rajonet e krizës ku shqipëtarët bllokonin rishpërndarjen e policisë; dhe pas një fushatës dhe vetë mbajtjes së zgjedhjeve të shtatorit 2002.

ndëgjoi ata gjatë një negociate emocionale që në fund solli uljen e tensionit të situatës.

Por edhe më tutje egziston ana e errët. Duke e konsideruar sidoqoftë jo si listë të plotë të incidenteve të mëdha të cilat kanë ndodhur në dhjetë muajt e fundit:[6]

- Në dhjetor të vitit 2002, një bombë shume e fuqishme eksplodoi përpara shkollës së mesme që ka kryesisht nxënës maqedonas, kur u vra një kalimtar i rastit. Vetëm fati ndihmoi që mos jetë numri më i madh i viktimave.
- Anëtarë të armatosur të Luanjve paramilitarë bllokuan rrugën kryesor për në Kosovë në janar të vitit 2003. Ministri Kostovi u detyrua që të dërgoi një njësi të forcave të tjera speciale policore, Tigrat në vendin e ndodhisë, dhe gjendja e tendosur dy ditëshe në atë vend u zvogëlua pas marrëveshjes që të mbahen në punë 600 anëtarë të Luenjve në Ministrinë e Punëve të MbrendshmE dhe të Mbrojtjes, edhe përkrah reputacionit të tyre të keq.
- Në 24 janar, u vranë tre prostitute të huaja, një u lëndua seriozisht dhe një burrë shqipëtar u therr gjatë një gjuajtje më armnë në një shtëpi publike në fshatin Dobër Doll.
- Dy polakë, anëtarëve të forcave të NATO-s "Harmonia e përbashkët" (Allied Harmony") dhe dy qytetarë u vranë në fillim të marsin nga një minë që thuhet se ka qenë dedikuar kundër patrullës së armatës maqedonase.
- Në mesin e marsit, një bombë eksplodoi në hekurudhën në afërsi të kufirit me Serbinë pas kalimit të trenit.
- Në mars dhe prill të vitit 2003 ndodhën dhjetë kidnapime.
- Në maj, fshatarët shqipëtarë në rajonin e Tetovës bllokuan një delegacion të maqedonasve të udhëhequr nga Ministri Kostovi dhe i shoqëruar nga Ambasadori Batler, që të marrin pjesë në një komemoracion (përkujtim) të pusisë së vitit 2002 të forcave të armatosura të Maqedonisë. Si rezultat, tenkat ishin të angazhuar në kazermën më të afërt dhe helikopteri bëri fluturime mbi ta, gjë që rriti tensionin. Më vonë ngatërresat u shtuan në Tetovë, ku në kazermë u hodhën disa granata dhe një patrullë policore u sulmua pas përleshjes së të rinjve shqipëtarë dhe maqedonas në qendrën e qytetit.
- Në mes të muajit maj, pasiqë 180 nxënës shqipëtarë u larguan nga shkolla e mesme në Kumanovë, më shumë se 1000 banorë shqipëtarë e bllokuan rrugën kryesore.
- Në 5 qershor, një bombë e fuqishme eksplodoi në qendër të Kumanovës.
- Në mes të qershorit në Haraçinës që kohë të gjatë ishtë problematike, policia maqedonase ndoqi dhe vrau një kriminel banor shqipëtar që thuhej se ishte i njohur si i tillë. Tensionet u ngritën pasiqë farefisët e tij dhe shoqëria dhe një ish komandant renegat i UÇK-së rrethuan policinë. Disa gazetarë të televizioneve u rrahën në vendin e ndodhisë.
- Në 20 qershor, "mbreti" i njohur në trafikimin me femra, Dilaver Bojku, iku nga burgu i Strugës.
- Dy bomba eksploduan në 22 qershor afër ndërtesës së Telekomit maqedonas dhe qendrës tregtare "Mavrovka" në Shkup.
- Në sulmin në mes të ditës të 9 korrikut afër ndërtesës së qeverisë në Shkup, sulmues të maskuar hynë në një çajtore të shqipëtarëve duke gjuajtur me armë dhe hudhur granatë, gjatë së cilës vranë pesë e plagosën katër persona. Caku i tyre ishte ish komnadanti i UÇK-së Ridvan Neziri, që kishte një reputacion se është thellë i përzier në "reketimin" me dhunë. Të vdekurit arritën numrin e përgjithshëm prej 42 personave -- 30 përqind më shumë se në vitin 2002 dhe më shumë se 40 përqind gjatë viteve 2000-2002.
- Gjithashtu në 9 korrik, fshatërët nga të dy anët bllokuan rrugën që të pengojnë hapjen e kalimit kufitar me Kosovën.
- Në 16 korrik, disa qindra protestues të punësuar në objektet elektroenergjetike shtetërore -- pjesë nga numri në rritje kryesisht i maqedonasve të cilët humbin vendet e punës

[6] Një përshkrim më i plotë i këtyre dhe ngjarjeve të ngjajshme mund të gjindet në Shtesën A.

> si rezultat i tentimeve që bëhen për të rritjen e numrit të shqipëtarëve të punësuar në ndërmarjet publike -- u përleshën me policinë para parlamentit.

Kriza më e keqe e sigurisë deri më tani ndodhi prej 27 gushtit deri në 07 shtator të vitit 2003, por pasojat edhe më tutje vazhdojnë. Një rebel, Avdi Jakupi ("Komandant Çakalla") kidnapoi dy njerëz, njëri prej të cilëve ishte polic. Ata u çliruan pas një ndërmjetësimi të politikantëve shqipëtar por në 27 gusht gjithashtu ishte vendosur një minë në hekurudhën Shup-Beograd, dhe ditën e ardhshme, në tre raste u sulmuan qeveria dhe armata në Shkup. Gjatë dy operacioneve të para që të gjendet Avdi Jakupi, një numër i banorëve shqipëtarë braktisën rajonin e fshatit Vaksince (afër Kumanovës). Operacioni (sulmi) i dytë, në 07 shtator, solli deri tek gjuajtja në fshatin me banorë shqipëtar të Brezës ku u vranë së paku dy të rinj, që sikur duket ishin në grupin e një renegati tjetër (Hamdi Bajrami, "Komandant Breza"),[7] e hidhëroi shumë partinë BDI të Ali Ahmetit [8] dhe i la ata shumë keq të eksponuar. BDI akuzoi zyrtarët maqedonas për tejkalimin në masë të madhe të përfshirjes së operacioneve në dallim me atë që ishin marrë vesh më parë. Ahmeti dhe të tjerët vunë në linjë kredibilitetin e tyre duke kërkuar nga shqipëtarët që të bashkëpunojnë me policinë. Zyrtarët ndërkombëtar i treguan ICG-së privatisht se ata besojnë se BDI në të vërtetë ishte e njohtuar paraprakisht për disa aspekte të këtyre aksioneve, por zyrtarët më të lartë maqedonas thuan privatisht se zyrtarët e lartë shqipëtar mbetën të painformuar ose të informuar pamjaftueshëm.[9] Zyrtarët e NATO dhe OSBE fillimisht mbështetën policinë por disa diplomatë më vonë reviduan pikëvështrimet e tyre duke e quajtur këtë aksion si "të paorganizuar", "keq të udhëhequr" dhe aksion të pasuksesshëm -- Jakupi nuk u kap, dhe tensionet u shtuan.[10] Hidhërimi i BDI solli kundër reagim nga ana e Ministrit Hari Kostovit, që kërkoi nga tre zyrtarët e lartë shqipëtar në ministrinë e tij të organizojnë vetë kapjen e Jakupit, edhepse më vonë ai krijoi një "komision të përbashkët".[11]

Në të njejtën kohë, simultanisht, dy ngatërresa rreth shkollimit zgjuan mosbesimin midis komunitetit shqipëtar dhe maqedonas. Në Shkup dhe në qytetin e dytë të vendit, Manastir, prindërit dhe nxënësit ishin të future në proteste të ndyra kundër prezencës së shqipëtarëve në shkollat e tyre dhe mësimit në gjuhën shqipe. Ngatëresat rreth shkollave dhe epizodi në Brezë kanë shkundur shumë fortë besimin e shqipëtarëve ne betimin e maqedonasve në Marrëveshjen e Ohrit. Marrë në përgjithsi, vargu i incidenteve të sigurisë zbulon një rrjedhi të qëndrueshme dhe të rrezikshme të tensioneve dhe dhunës që ka potencial që shumë lehtë të dalë nga kontrolli. Siç tha një dëshmitar vendi nga përleshjet e majit në Tetovë Në vështrimet e tij, kur disa shqipëtarë të rinj vdiqën nga dora e një maqedonasi të armatosur, "kjo do të prodhonte një derdhje të vazhdueshme të gjakut".[12] Kostovi tha se ishte pothuajse i gatshëm të dërgojë forcat speciale që të çlirojnë policing e rrethuar nga shqipëtarët në 12

[7] Jakupi andhe Breza thonë se janë pjesë e Ushtrisë Kombëtare Shqipëtare (AKSh), që nban përgjegjësinë për disa (jo të gjitha) aksione të dhunës në Kosovë dhe në Serbinë jugore në gusht të vitit 2003. Udhëheqësi i Frontit të Bashkuar Kombëtar Shqipëtar, që thotë se është krahu politik i AKSh-së, quan Bajramin dhe and Jakupin "elemente kriminele, jopatriotike", dhe jo si pjesë e organizatës së tyre. (ICG intervistë, Brisel, shtator 2003). Në bazë të punës sonë në teren në Serbinë jugore dhe në Maqedoni, ICG beson se nëse "Armata Kombëtare Shqipëtare" egziston, ajo nuk është e madhe dhe nuk kanë komandë qëndrore të pastër.

[8] Emri i plotë i partisë është Bashkimi Demokratik për Integrim.

[9] ICG intervistë me zyrtarë të OSBE, me 9 shtator 2003, dhe në komunikimet e veçanta me zyrtarë të lartë nga Maqedonia, gjithashtu në shtator, rivali i BDI-së, PDSh e udhëhequr nga Arben Xhaferi, ashpër kritikoi aksionet policore, duke shtuar edhe më shumë tensionin mbi BDI-në dhe duke thënë se Ali Ahmeti dhe BDI janë "marionetat" e Cërvenkovskit. Partia opozitare "e reformuar" para pak kohe, VMRO-DPMNE, kërkonte një "debatim emergjent" në Parlament që të përcaktojë çmimin maksimal politik që rezulton nga lejimi i Crvenkovskit dhe SDSM që të degjenerojë situata.

[10] ICG është e vetëdijshme për thash e thënet nga maqedonasit dhe shqipëtarët për rolin e mundshëm të serbëve në inicimin apo rritjen e tensioneve të paradokohshme në Vaksincë dhe Brezë. Kjo shkonte nga akuzat e drejtëpërdrejta për bashkëpunim mes elementeve të shërbimit sekret të Beogradit dhe të rebelëve "Çakalla" dhe "Breza", deri tek dispozitat për informata të rrejshme të kundërzbulimit të Maqedonisë që zmadhojnë grupet radikale shqipëtare në Rajonet dhe për kërcënimet që ata paraqesin. Implikimi është që Beogradi, apo disa elemente atje, besojnë se Serbia apo disa elemente atje, besojnë se pozita e Serbisë në KosoKosov ndihmohet nga konfliktet mes shqipëtarëve dhe maqedonasve. ICG intervista me burime maqedonase dhe shqipëtare. Shiko gjithashtu reportet në revistën Forum, në 12 shtator 2003, nga reporteri maqedonas Teofil Blazhevski lidhur me këtë ç lidhur me këtë çështje.

[11] Për një raport më të detalizuar për ndodhitë në aksioni policor në Brezë shiko Maqedonia: "Gjuetia në njerëz nga ana e policisë provokon tensioned etnike", Ana Petrusheva, IWPR BCR Nr 458, 5 shtator 2003.

[12] ICG intervistë me komentatorin Jordan Mirkovski në Tetovo, 17 maj 2003. Mirkovski, për dallim nga kolegët e tij në Tetovë, beson forte në koegzistencën multietnike.

qershor në Haraçinë.[13] Në të vërtetë, shumica e incidenteve patën potencial për ndodhi edhe më të këqia.

Ky raport hulumton pesë fushat qëndrore të përpjekjeve të Maqedonisë për një stabilitet afatgjatë: politika, ekonomia, decentralizimi, korrupcioni dhe marrëdhëniet ndër etnike.

[13] ICG intervistë me Ministrin Hari Kostov, 19 qershor 2003.

## II. POLITIKA DHE KUFIJTË E KAPACITETEVE SHTETËRORE

Ministri i Punëve të Mbrendshme ka bërë tentime të mëdha, por siç tregojnë edhe ndodhitë e fundit të gushtit/ fillimit shtatorit, sfidat me të cilat do të ballafaqohet ai edhe më tutje qëndrojnë. Siç e bëjnë të qartë edhe incidentet e vazhdueshme të sigurisë, egziston një lojë e gabueshme midis kërcënimeve të shkaktuara nga ekstremistët dhe kriminelët dhe mundësive të shtetit për përgjigje efektive. Dallimi mes kriminelëve dhe elementeve ekstreme në mënyrë të shpejtë është ngërshetuar. Pamundësia në përgjithsi që të dështohet kriminaliteti qëndron njëra nga qëllimet më të shpejta të qeverisë përderisa trumpetat e "rutinës" të dhunës nuk kanë dërguar porosinë ekstremistëve që ambiciet e tyre mund të mbahen të gjalla me harxhime të kufizuara.

Kryeshefi i Gjeneral Shtabit, Gjeneral Koloneli Metodi Stamboliski, ishte edhe më i ngatërruar se diplomatët pas dhunës së muajit maj në Tetovë: "Përkundër sigurisë së përmirësuar në ish rajonet e krizës, situate edhe më tutje është e ndijshme dhe secili duhet të punojë që të përmirësojë atë".[14] Është e qartë se jo vetëm ekstremistët shqipëtarë, por gjithashtu edhe një varg i madh i nacionalistëve maqedonas, serbë, grekë dhe bullgarë, që kanë interes në destabilizimin. Sfidat për identitetin e Maqedonisë kanë evoluar në kohën e fundit nga Greqia, Bullgaria dhe Serbia.[15]

Përkundër dy viteve të trajnimit, mbikqyrjes së OSBE-së dhe këshillat e Komunitetit Europjan, veprimi i njësive multietnike dhe atyre të pastërta maqedonase është edhe më tutje e pamjaftueshme. Zyrtarët e lartë të OSBE-së pranojnë në dije se suksesi në ndërtimin e pranimit publik të policisë

[14] "Gjeneral Stamboliski: situata në Maqcedonia është edhe më tutje e ndijshme", MIA, 25 qershore 2003.

[15] Ironikisht, Shqipëria nga të gjithë pesë fqinjtë e Maqedonisë, ka treguar mbështetjen më të madhe për sovranitetin dhe sigurinë, përfshirë këtu edhe thyerjen e disa ekstremistëve të njohur për "Shqipërinë e Madhe". Si kundërthënëse me këtë, kisha Orthodokse Serbe përsëri ka futur në sfidë Kishën Orthodokse të Maqedonisë, ndoshta edhe me ndihmën e Greqisë. Greqia reagoi ashpër në lëvizjet e paradokoshme të Shteyeve të Bashkuara të Amerikës kah pranimi i emrit të Maqedonisë. Edhe Bullgaria është munduar që të hyjë në ditëlindjen e Kryengritjes së Ilindenit kundër turqve Otoman, një ndodhi që shikohet nga maqedonasit si shenjë e qëndresës në tentimet e tyre për pavarësi, ndarje nga Bullgaria dhe aktivitetet anti-otomane.

kanë tejkaluar rrugën e veprimit.[16] Si ata ashtu edhe zyrtarët e organizatave që ndihmojnë në mënyrë të hapur pranojnë që patrullat multietnike me profil etnik të lartë po mundohen me vështirësi që të mundësojnë në mënyrë efektive implementimin (egzekutimin) e ligjit në ish rajonet e krizës. Përderisa marrëveshja e paqës së Ohrit mundësonte që të regrutohen një numër i madh i banorëve shqipëtarë dhe kërkonte rritjen e pranimit të policisë nëpër fshatrat ku kishte konflikte në vitin 2001, tani qëllimi është që këta njësi të bëhen efektive.

OSBE-ja meriton lëvdata për ndihmën dhënë Maqedonisë që të plotësojë kuotat ambicioze të parashtruara për regrutimin e shqipëtarëve sipas marrëveshjes së Ohrit.[17] Pasiqë mori këtë detyrë nga Departamenti i Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në fillim të vitit 2002, OSBE-ja ka arritur të diplomojë mbi 1.000 kadetë nga Akademia Policore në Idrizovë, dhe zyrtarët mendojnë që qëllimet e Ohrit do të arrihen deri në afatin e fundit në gusht të vitit 2004.[18] Këta numra të diplomimeve impresive kanë pasur ndikim tek njerëzit. Në Tetovë, qendra e betejave më të vështira në vitin 2001, shefi i policisë ka raportuar për përmirësime thelbësore gjatë vitit të kaluar: më së një e katërta e 300 policëve të rregullt janë shqipëtarë, që është 8% më shumë se para konfliktit.[19]

Gjithsesi, regrutët e ri të paeksperiencuar në disa raste kanë treguar moseksperiencën e tyre. Kostovi i ka treguar ICG që ai nuk është i kënaqur nga veprimtaria e policëve shqipëtarë, që moskompetenca, friga dhe kohë pas kohe edhe bashkëpunimi me elementet kriminale kanë ndërprerë aksionet, dhe se ai ka "kërkuar përmirësime".[20] Zyrtarët e OSBE-së ju bashkangjiten këtyre brengave. Një zyrtar me eksperiencë e fajëson "trajnimin e vobegët" për veprimet e pabarabarta të patrollave multietnike,[21] edhepse Drejtori i Njësisë për zhvillimin të policisë pranë OSBE-së, Bart D'Hooge, në mënyrë të qartë mohon thëniet e tilla.[22]

Monitorët europjan kanë kundërthënie për atë që OSBE-ja ka theksuar trajnimin, promovimin e pranimin të shqipëtarëve e jo dorracakët, këshillat operative të cilat do të kishin zmadhuar shkallën e arrestimeve.[23] Përderisa qasja në komunitetin e tyre ofron disa benificione të padiskutueshme, është e njëlloj e dukshme që policia duhet kohë pas kohe të përdorë forcë, e jo së fundi në ish rajonet e konfliktit.

Planifikimi dhe taktika e operacioneve të policisë vetëm maqedonase dhe dominuese maqedonase është gjithashtu një brengë. Në një numër të incidenteve, komunikimi i dobët, implementimi jo efikas dhe dështimi që të ndjekin procedurat policore të rëndomta krijoi konfrontime të mundhsme eksploduese përderisa lejoheshin të dyshimtit kryesor që të largohen. Si pothuajse të gjitha aktivitetet e qeverisë së Maqedonisë, aktivitetet policore janë shumë të centralizuara. Policia vendore ka qenë e penguar nga operacionet malore që të arrestojë disa të dyshimtë që shetisin lirisht nëpër rrugët. Zyrtarët e sigurisë ndërkombëtare gjithashtu citojnë dobësitë serioze në kapacitetet e grumbullimit dhe ndarjes të zbulimit dhe kundrazbulimit të Ministrisë së Punëve të Mbrendshme. Zyrtarë të lartë

---

[16] ICG intervistë me Drejtorin e Njësisë për zvhillimin e policisë së OSBE-së, Bart D'Hoge, 17 korrik 2003. Një tjetër zyrtar me eksperiencë i OSBE-së e karakterizoi veprimtarinë e policisë si "në përgjithsi jo eficiente". ICG inntervistë me një zyrtar tjetër të lartë të OSBE-së, 20 qershor 2003.

[17] Neni 5.2 nga Aneksi C kërkon që 50 oficerë të rij të policisë të trajnohen nga komunitetet të pakicave deri më korrik të vitit 2002 dhe 500 të tjerë deri në korrik të vitit 2003 me qëëllim që policia të reflektpjë përbërjen dhe shpërndarjen e popullatës së Maqedonisë në vitin 2004. Gjithsesi, edhe këta rritje të numrit paraqesin edhe më tutje prezencë të vogël të shqipëtarëve në Ministrinë e Punëve të Mbrendshme. Nga afërsisht 10.000 të punësuarve në këtë ministry, vetëm 810 janë shqipëtarë (7.5%), pa numëruar dy klasët që janë tani në akademinë policore.

[18] Sipas Raportit vjetor të zhvillimit të njësisë policore të OSBE-së (f. 80), programi "ICITAP" i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës është përgjegjës për trajnimin e 106 kadetëve të ushtruar, ndërsa OSBE-ja që atëherë ka trajnuar edhe 427 të tjerë.

[19] ICG intervistë më shefin e policisë së Tetovës Zemir Qamili, 16 janar 2003.

[20] ICG intervistë, Ministri Hari Kostov, 19 qershor 2003.

[21] ICG intervistë,Shkup, qershor 2003.

[22] D'Hooge thekson se 36 nga 200 nxënësit në klasën më të fundit ishin të shkarkuar dhe që të gjithë kadetët pas një kohe do të kthehen nga tereni me qëllim që të kalojnë provimin shtetëror shumë të rreptë. ICG intervistë, 17 korrik 2003.

[23] Paragrafi 5.3 nga marrëveshja e Ohrit mundëson "shpërndarjen sa më të shpejtë të monitorëve ndërkombëtar dhe këshilltarëve policor në lëmitë sensitive, nën përgaditje përkatëse me autoritetet relevante". Paragrafi i njejtë identifikon OSBE-në, së bashku me Komunitetin Europjan dhe Shtete e Bashkuara të Amerikës si udhëheqës të trajnimit policor. Me fjalë të tjera, marrëveshja e Ohrit krijoi një rol të qartë operacional dhe në teren për OSBE-në, veçantrisht në lëmitë sensitive, subjekt të marrëveshjes së autoriteteve. Përkundrejt NATO-s që interpretonte një mandate të ngushtë në territory të gjërë, duke e lejuar që të luajë rol kritik në teren, OSBE-ja në vazhdueshmëri ka pasur një politikë të gjërë me madat të këshillimit të ngushtë. Sipas një zyrtari të eksperiencuar të OSBE-së, frustracionet me këtë politikë, të cilat kanë ngulfatur iniciativat dhe shpesh herë kanë lëmë policinë jokompetente me pajisjet e tyre, ka shkaktuar disa zyrtarë të OSBE-së të largohen. ICG intervistë, qershor 2003.

të Njësisë për zhvillim të policisë së OSBE-së gjithashtu mendojnë se përdorimi i forcës edhe më tutje është problem egzistues nën udhëheqësinë e "grushtit të hekurtë" të Drejtorit të Sektorit Publik, Branko Bojçevskit.

Ministria e Punëve të Mbrendshme ka nevojë për një kontrollë strategjike nga lartë-poshtë si ajo e Ministrisë së Mbrojtjes, që u bë me insistimin e NATO-s, që e bëjnë Mbretëria e Bashkuara dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me rezultate impresive fillestare që kanë ndihmuar të krijohen një "momentum" për reformat me dhimbje, përfshirë këtu edhe shkarrkimin e disa zyrtarëve të lartë dhe të zvogëlimit thelbësor të dezenuar për të krijuar një forcë më të vogël, por më profesionale. Komuniteti Europjan kishtë ndërmend të bëjë një një vlerësim të tërthortë për nevojat e Ministrisë së Mbrendshme dhe për kapacitetet si pjesë e formulimit të strategjisë për reforma, por për shkak të "shetitjeve" të mbrendshme, ekipet e tyre policore krijonin raporte rivalësh, që sipas fjalëve të një zyrtari të Komunitetit Europjan, "nuk mundësoi ndikim në ministrinë apo në komunitetin ndërkombëtar". Kjo çështje tani tani po diskutohet në Brisel si parashikim për largimin e pritur të misionit ushtarak (Konkordia) në fund të vitit 2003.

## A. DYSHIMET E PËRBASHKËTA DHE MINISTRIA E PUNËVE TË MBRENDSHME

Edhepse ka regrutuar një numër të rëndësishëm të banorëve shqipëtarë në vetë policinë, njerëzit nga mbrenda thonë se mosbesimi ndaj shqipëtarëve në Ministrinë e Mbrendshme edhe më tutje është problem që vazhdon. Drejtori i shërbimit publik Branko Bojchevski dhe Drejtori i Sigurisë shtetërore Zoran Verushevski sipas raporteve nuk ka vepruar njëlloj si Kostovi që të afrohet kah shqipëtarët, dhe duke shtuar tensionin etnik ka shkaktuar zvoglimin e efektivitetit të operacioneve policore.[24]

Verushevski shfaq dyshime të mëdha tek shqipëtarët lidhur me sigurinë e shtetit ose të aparatit të policisë sekrete.[25] Policia sekrete në mënyrë tradicionale ka qenë bastion i ndjenjës kundër shqipëtare.[26] Ish zëvendësi i Kostovit, Fatmir Dehari, pandërprerë është ankuar për rezistencën për sjelljen e shqipëtarëve të rij në sektorin e sigurimit shtetëror që kish mosbesim të thellë në ta.[27] Gjithashtu mendohet se Drejtori i Sigurimit Shtetëror Verushevski dështoi të informojë zyrtarët e partisë BDI lidhur me operacionet e mëdha të policisë në afërsi të Strugës (pas bombës para gjyqit), në Sopot (në arestimin e të dyshimtit për incidentin me minën kur u vranë dy ushtarë të NATO-s), dhe më së vonti në Brezë (në operacionin e dështuar për të zënë Jakupin).[28] Fatmir Dehari në mënyrë të rregullt ishte i injoruar edhepse ai në disa raste demonstroi besnikërinë e tij ndaj qeverisë duke i qetësuar shqipëtarët e hidhëruar. Kostovi ka qenë dy herë i detyruar që të pranojë dështimin që të informojë partinë e BDI-së dhe të përfshijë shqipëtarët në operacionet e tyre.[29] Gabimet e tilla kanë shkaktuar

[24] Për shembull, vrasjet e hakmarrjeve të një shqipëtari dhe një maqedonasi të në Tetovë në tetor të vitit 2002 ndoshi kur atje nuk pati asnjë polic shqipëtar në njësinë në punë në atë rajon. Si kundërthënie e kësaj, kur policia është e përzier, atëherë mundësia e tyre për të përballuar rastet e nxehta është shumë më e theksuar. Gjatë përleshjeve të 16 majit të vitit 2003 në Tetovë, të rijtë shqipëtarë të hidhëruar ju afruan një veture policore. Pasiqë panë një grup të përzier prej shtatë policëve mbrenda, ata u tërhoqën dhe u ndërpre incidenti. ICG intervistë me zëvendës Ministrin e Punëve të Mbrendshme Fatmir Dehari, 21 maj 2003.

[25] DBK me iniciale maqedonase, është një trashigimi nga ish Jugosllavia ku qendra e saj dominuese në Beograd ishte UDBA, biroja e mbrendshme e sigurimit shtetëror.

[26] Shqiptarët privatisht dhe publikisht akuzojnë pasardhësin maqedonas DBK-në për përzierje me krimin e organizuar të shqipëtarëve në Maqedoninë Perëndimore. ICG u takua me një gjykatës hulumtues etnik shqipëtar që bërë pot ë njejtat dyshime. Fyerje e rëndomtë midis shqipëtarëve është që të quajnë tjetrin "spion" ose "ish-spion" të UDB-së. Një politikant i njohur dhe respektuar shqipëtar në Maqedoni ka qenë shumë shpesh i akuzuar për këtë.

[27] Dehari i tha ICG se ai i ka dhënë Drejtorit të Sigurimit shtetëror 60 emra të reja (që të punësojë shqipëtarë në Sigurimin shtetëror për të cilat BDI meNdon se janë thjesht të zgjedhura), dhe 80% të tyre kishin pastërti sigurimi. Gjithsesi, Verushevski vazhdonte të zvariste këmbët për pranimin e shqipëtarëve. ICG intervistë Fatmir Dehari, 21 maj 2003.

[28] Operacioni afër Strugës (pas bombardimit në gjyqin e atjeshëm), Sopot (the arrestimi i një të dyshimti për incidentin me minën që vrau dy ushtarë të NATO-s), dhe, më në fund, Breza (operacioni i dështuar për të zënë Jakupin). Sipas OSBE-së, këta operacione janë bërë nën udhëheqjen e DBK-së së Verushevskit, e jo ndër Bironë për sigurinë Publike të Bojçevskit. OSBE gjithashtu ka shfaqur brengat e saja ICG-së ndaj asaj që Verushevski ka penguar disa hulumtime të mbrendshme përfshirë operacionet policore.

[29] Kostovi mbronte Verushevskin para to ICG, duke thënë se ai ka "menduar" se do t'ju tregohet, dhe se shqipëtarët do të ishin kyqur në operacionin e Sopotit. ICG intervistë Hari Kostov, 19 qershor 2003. Kostovi gjithashtu në mënyrë vigjilente ka mbrojtur atë kundra akuzave se ai ka "problem" me shqipëtarët. Ai gjithashtu mbronte konfliktin e qartë të intereseve në posedimin e kompanisë private të sigurimit si

keqkutime thelbësore dhe u shfrytëzuan nga ekstremistet edhe në ato raste kur sjellja e policisë ishte gjithsesi shumë gjegjëse. Për arsye të palidhura me këta, Verushevski ishte shkarkuar nga posti Drejtor i Sigurimit shtetëror në 20 tetor të vitit 2003, prandaj pasardhësi i tij tani ka rast për një fillim të freskët.

Drejtori i of Sigurimit Publik Branko Bojçevski gjithashtu nuk ka dëshiruar shumë të punojë me zëvendësit shqipëtarë. Sipas zyrtarëve të lartë të OSBE-së, ministria nuk kish urdhëruar patrullave multietnike me orar të plotë deri në fund të qershorit të vitit 2003, më së shumti për shkak të ndikimit të tij.[30] Zyrtarë të lartë të Maqedonisë përshkruajnë qasje e "shkollës së tij të vjetër" si "kundërshtim të plotë" të modelit të politikës së OSBE-së për komunitetet.[31] Sa më tepër, sektori publik i sigurimit, i përbërë nga 95 përqind të personelit të ministrisë, imponohej rreptësisht nga kierakija në Shkup, që në mënyrë të prerë ka kufizuar iniciativën vendore dhe kohën e reagimit, duke lënë disa kryetarë të komunave dhe shefa të policisë që të ankohen se janë të nguruar jashta operacioneve.

Edhe vetë Ministri Kostovi ka qenë refuzues që të bëjë disa hulumtime thelbësore të mbrendshme për disa keqtrajtime të policisë, përfshirë këtu edhe mundësinë e përdorimit të forcës së panevojshme që solli deri tek vdekja e një të riu shqipëtar në Tetovë në nëntor të vitit 2002 dhe vrasjeve të dyshimta nga policia të shtatë aziayëve në mars të vitit 2002 të cilët në atë kohë Ministri i Punëve të Mbrendshme, Lube Boshkovski i etiketoi si "ekstremistë islamik".[32]

edhe për atë që akuzohej lidhur me atë që ai ka më shumë se një apartament shtetëror.

[30] ICG intervistë me zyrtar të lartë të OSBE-së, 14 qershor 2003.

[31] Qëllimi kryesor i Politikës për qasje të re është të ndërtojë besimin me s qytetarëve dhe në të njejtën kohë të mundësojë ambient jetësor të sigurtë për policinë. Pikat kryesore të politikës së komunitetetit përfshijnë: zmadhimin e decentralizimit në komandimet; formimin e Grupeve të Këshilltarëve qytetarë për të diskutuar çështjet e bashkëpunimit; nxjerrjes nga përdorimi të stilit të vjetër të kamuflazhit të uniformave; zëvendësimi i policëve rezervë me polici profesioniste; fazat e aktivteteve të rregullta policore, përmirësimin e mekanizmit të ankimeve; të identifikohen stacionet policore që duhet të ndërtohen; krijimi i një strategjie për mediat; dhe përmirësimi i lirisë së lëvizjes me largimin e pikave të kontrollit policor.

[32] Në përvjetorin e vrasjeve tnë vitin 2003, drejtori i projektit ICG dhe Drejtori i Institutit Shoqëria e Hapur dhanë një deklaratë të përbashkët duke kërkuar nga qeveria e re që të bëjë një hulumtim të plotë. Kostovi premtoi që të bëjë këtë dhe që rezultatet do të shpallen në prill të vitit 2003.

## B. SHQIPËTARËT DHE AUTORITETET SHTETËRORE

Shqipëtarët ndajnë përgjegjsinë për mungesën e besimit të plotë midis qytetarëve dhe policisë. Ka putur kohë kur fshatarët protestonin kundër operacioneve edhepse Ministria e Mbrendshme plotësisht ka informuar partinë BDI. Akuzat për brutalitetin policor lidhur me arrestimin për minën e Sopotit duken sikur kanë qenë në tërësi të pavend.

Shumë maqedonas shikojnë këta proteste të popullatës shqipëtare si manifestime të rezistencës më të gjërë ndaj autoriteteve shtetërore. Një zyrtar i lartë nga BDI-a lirisht pranoi që shqipëtarët tradicionalisht kanë "kundërvyer autoritetet qëndrore".[33] Një zyrtar i lartë finansiar ndërkombëtar, theksoi pagesën e vogël të pagimit të tatimeve në rajonet shqipëtare, fenomen jo i mirë për decentralizimin, që disa kryetarë të komunave edhe vetë shpesh herë shprehin brengat e tyre. Gazeta ditore shqipëtare Fakti ka bërë një vlerësim se gjysma e qytetarëve të Tetovës (përfshirë këtu edhe maqedonasit) nuk paguajnë llogaritë e tyre të rrymës elektrike.[34]

Pranimi më i gjërë nga shqipëtarët lidhur me autoritetet shtetërore është pika qëndrore për ruajtjen e paqës, që është pjesë e asaj që është e nenvizuar nga marrëveshje e pashkruar shoqërore që thëret maqedonasit të ndajnë më shumë privilegje shtetërore si mjet shkëmbimi për pranimin e integritetit dhe autoriteteve shtetërore nga ana e shqipëtarëve. Gjithsesi, BDI e Ali Ahmetit ka qenë besnike në marrëveshjen shoqërore, duke dhënë dritën e gjelbërt policinë që të merret me kriminelët dhe ekstremistët në të njejtën kohë duke kërkuar nga shqipëtarët që të bashkëpunojnë. Kjo qasje mundet gjithashtu ti kushtojë atij popullaritet në anketat dhe në autoritetin në teren.

Ajo që Ahmeti duhet të përpiqet që të fitojë për policinë dhe autoritetet shtetërore është edhe një tregues tjetër që është edhe më tutje herët që të shpallet Maqedonia si sukses. Institucionet shtetërore, përfshitrë këtu por jo të kufizuar vetëm tek policia, thjesht nuk kanë vepruar në atë mënyrë që të shkaktojnë besim në mesin e shqipëtarëve. Përderisa

Departamenti shtetëror gjithashtu në raportin e tij vjetor për të drejtat e njeriut ka cituar disa raste të dhunimit serioz të të drejtave të njeriut. Gjithsesi, asnjë progress deri tani nuk është raportuar.

[33] ICG intervistë me zyrtar të lartë të BDI-së, 21 qershor 2003.

[34] "Në Tetovë 47 përqind e popullatës paguajnë llogarinë elektrike", theksoi Fakti në 15 qershor 2003.

ata nuk e bëjnë këtë, do të jetë vështirë të bëhen këta ndryshime të nevojshme na modelin e sjelljes së shqipëtarëve, përfshirë këtu edhe pagesën e tatimeve. Edhe me përmirësimet dramatike në kapacitetin shtetëror dhe veprimet e tyre, mund të kalojnë vite që të arrihen standardet minimale të respektit dhe për pjesëmarje në shtet.

## C. LUENJTË ULURISIN PËRSËRI

Për shqipëtarët, simboli më i qartë i shtypjes policore janë njësitë e shpërndara speciale policore "Luenjtë". Përkundrejt përcaktimit të tij të qartë që të pastrojë trashigiminë e paraardhësit të tij, Lube Boshkovski, Ministri i Punëve të Mbrendshme, Kostov pati mjaft vështirësi me shuajtjen e luenjve. Në janar të vitit 2003, duke theksuar se ata sigurisht do të humbin vendin e punës, Luenjtë më forcë bllokuan udhëkryqin kryesor për kalim nga Kosova. Kostovi u përgjegj duke dërguar kundërshtarët e tyre nga njësia speciale "Tigrat", në vendin e ndodhisë. Pas një gjendje të tendosur dy ditëshe, ai dhe Kryeministri u dakorduan me përfaqsuesit e luenjve në një plan reforme më pesë pika duke premtuar punësim. Burimet thonë se Kostovi kundërshtoi ashpër këtë, por kjo u verifikua nga qeveria në 25 janar.[35]

Më këtë luenjtë arritën një shkallë të çmimit. Nga 630 luenjve që duhej të ripunësohen (430 në Ministrinë e Mbrendshme dhe 200 në armatë), një numër i madh u pranuan pa procesin e premtuar të kontrollit.[36] Një numër i kriminelëve të njohur shpejt u ktyen në uniformë, përfhsirë këtu edhe luanin që rrahu gazetarin Zoran Bozhinovski pas zgjedhjeve dhe luenjtë që gjuajtën në paraqitjen e Ministrit të Finansave Petar Goshev. Kjo ka tronditur besimin e popullatës shqipëtare. Edhepse Kostovi kundërshtoi marrëveshjen, shumica e shqipëtarëve përkujtojnë se ai u betua që do të japë dorrëheqje nëse nuk arrin të plotësojë obligimet e tij.

Marrëveshja gjithashtu kërkonte që të bëhen tentime për një baraspeshim më të madh në ministrinë në tërësi -- ku shqipëtarët janë vetëm 7.5 përqind, dhe asnjë nuk është zyrtarisht i integruar në njësitë speciale policore, që edhe më tutje qëndron si çështje kritike për ekstremistët dhe kriminelët fortë të armatosur dhe të organizuar. Ish UÇK komandantë (madje edhe disa lojal ndaj Ali Ahmetit) edhe më tutje theksojnë se njësitet special vetëm me maqedonas edhe më tutje janë të jomirëseardhura në fshatrat shqipëtare. Debakli me luenjtë përsëri ka nxitë nevojën edhe reformën edhe integrimin e policisë speciale. Kostovi ka paraqitur një plan, që duhet të mbështetet nga ndihma prej Mbretërisë së Bashkuar, por që edhe më tutje nuk është inicuar. Kjo do të zëvendësonte luenjtë dhe tigrat më një njësi për shpërndarje emergjente (rapide) prej 450 pjesëmarësve të fortë me tre degë: reagimi i shpejtë, rendi publik dhe mbështetja.

Për fat të keq, plani nuk përfshin në vete emergjencën e regrutimit të shqipëtarëve. Këshilltarët britanez kanë sygjeruar që ministria të lehtësojë listën e kritereve të nevojshme që kërkohen për njësitë speciale dhe duket sikur shumë pak e kënaqur që të mund të sigurojë që nuk egzistojnë "barierra" (shtylla) kundër shqipëtarëve.[37] Kjo do të thoshtë nënçmim edhe të urgjencës simbolike dhe praktike për të pranuar shqipëtarë të kualifikuar në forcat speciale policore edhe përkundrejt asaj që shumica e shqipëtarëve e urrejnë si bastion i shtypjeve.

## D. DERA E POLITIKËS DHE EUFOR/KONKORDIA

Vështirësitë e pandërprera me të cilat ballafaqohet policia e Republikës së Maqedonisë, dështimi i Komunitetit Europjan që të zhvillojë një strategji të politikës afatgjate dhe mosdashjes (ngurrimit) të OSBE-së që t'ju adresohet çështjeve operacionale të politikës në mënyrë edhe më robuse kombinon riparaqitjen e rëndësisë për ndihmën ndërkombëtare për sigurinë. Misioni i sigurisë që po ushtrohet (realizohet) nga Komuniteti Europjan, Konkordia, ka qenë deri më tani një ndjekje e suksesshme e misionit original të NATO-s. Ekstremistët në masë të madhe

[35] Plani parashikon që Luenjtë të jenë objekt të kësaj marrëveshjeje, me prioritet për ata që u bashkamgjitën derin në dhjetor të vitit 2001; do të kishte një transformim të papërcaktuar të bataljonit të dytë të luenjve; anëtarët e njësisë me kontratë për punësim të rregullt do të transferoheshin në Ministrinë e Punëve të Mbrendshme, sipas nevojave të ministrisë dhe kualifikimeve individuale, ndërsa ata pa marrëveshje për punësim por që plotësojnë kushtet ligjore për punësim, do të fillojnë punësim të plotë menjëherë ose në polici ose në armatë; një komision i përbashkët për mbikqyrje do të formohet; emrit e imagjinuar do të largohen nga lista; dhe qeveria menjëherë do të ndërrmarë hapat adekuate. Kërkesa që luenjve t'ju jepet amnesty për krimet e shkatuara gjatë konfliktit të vitit 2001 ishte refuzuar.

[36] Mbrojtësit e luenjve arsuetonin ripunësimin e tyre me krahasimet me UÇK-në, anëtarët e të cilëve fituan amnesty të plotë për veprimet gjatë luftës. Një zyrtar i lartë maqedonas i theksoi ICG se shumica e luenjve të ripunësuar janë nga njësia me më shumë kriminel, Bataljoni i Dytë. Udhëheqësit e këtij bataljoni vendosën se kush do të mbesë i punësuar. Shumica më pak problematik nga Bataljoni i Parë u lanë anash që nga protesta. Kostovi insistonte që asnjë nga ish luenjtë të mos punësohet.

janë munduar të mos përleshen (ballafaqohen) me ta, dhe gjithashtu mund të themi se ata kanë qenë mirë të pritura nga shqipëtarët që janë pro-NATO të orientuar, madje edhe të entuziazmuar.[38] Sidoqoftë tensioni lidhur me Irakun, kërcënimet për të bërë aranzhmane për bashkëpunim me punët e NATO-s, si edhe më e freskët, debatimet lidhur me Gjyqin Ndërkombëtar të Krimeve, të gjitha kanë lëshuar një hije në marrëdhëniet midis forcave të Komunitetit ndërkombëtar, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe NATO-s.[39]

Zyrtarët e Komunitetit Europjan edhe të NATO-s pranojnë që informatat nuk janë të ndara mes veti në mënyrë efektive. Disa zyrtarë të lartë të EUFOR-it shikojnë eleboratet, raporte të dyfishta për tabelat e organizimit në varg si të rënda (të pavolitshme) dhe të panevojshme. Zyrtarët e NATO-s thonë që Komuniteti Europjan nuk i respekton këto, dhe në vend të saj bën raporte në bazë të linjës nacionale, dhe me këtë e ve në pyetje edhe vetë veprimtarinë e Komunitetit Europjan. Sa më tepër, këta dy organizata në mënyrë active po luftojnë për ndikimin e tyre në sferën e sigurimit. Komuniteti Europjan hidhërohet në rolin e vazhdueshëm të NATO-s në reformat e përgjithshme të nbrojtjes dhe në procesin e udhëheqjes me kufijtë, por edhe më tutje nuk janë në pozitë që të ofrojnë ndonjë alternativë më të mirë. NATO nuk ka më ndonjë dituri të mirë për atë se çka po ndodh në teren. Në vend që këta të dy organizata të kompletojnë njëra tjetrën, këta dy institucione ju kanë dhënë ministrave të Maqedonisë informata kundërthënëse.

Komuniteti Europjan shikon udhëheqjen më kufijtë si një detyrë të trashëguar qytetare të cilën duhet të udhëheqin ata, përderisa NATO-ja insiston që ata janë më mirë të vendosur (pajisur) për të bërë këtë. Rivaliteti doli në pah kur zyrtarët e NATO-s akuzuan Komunitetin Europjan për sabotimin e konferencës që ata e patën inicuar për Sigurinë dhe udhëheqjen me kufijtë në Ohër prej 22 deri në 23 maj të vitit 2003. Përderisa shumë zyrtarë insistojnë që "Standardet europjane" kërkojnë ndërimin e sigurisë mga armata në një shërbim të ri të policisë, së pau njëri nga ish NATO komandantët beson se kjo është e gabueshme. Me çështjen (statusin) edhe më tutje të pazgjedhur të Kosovës dhe të kërcënimit të infiltrimit të ekstremistëve të armatosur dhe më pas të largimit të tyre nga rajoni që edhe më tutje mbetet realitet, ai edhe më tutje e diskuton faktin që misini në kufirin verior të Maqedonisë edhe më tutje mbetet ushtarak.[40]

Grindjet ndërkombëtare dhe tejkonfidenca e Maqedonisë kanë mjegulluar debatimin rreth asaj së çfarë lloji i misionitë të sigurisë duhet të ndjekë Konkordinë pasi përfundimit të saj të planifikuar në 15 dhjetor.[41] Në 29 shtator, Komuniteti europjan aprovoi shpërndarjen e misionit policor të Komunitetit Europjan ("Proxima"), prej jo më vonë se 15 dhjetor. Plani për këtë filloi në 01 tetor, nën udhëheqjen e Bart D'Hooge, që tanimë veç ëhtë në vend si drejtor i Njësisë për zhvillimin e policisë të OSBE-së. Nuk është e qartë, gjithsesi, a thua që vetë qeveria e Maqedonisë dhe komuniteti ndërkombëtar plotësishtë e kuptojnë nevojën ë sigurimit në Maqedoni. Edhe vetë Kostovi, që njihet si ministër që është në favour të ndihmës ndërkombëtare për sigurinë, tha para do kohe se atij i nevojiten vetëm "vëzhgues" (mbikqyrës), e jo ndihmë në formë të policisë.[42]

Në këtë drejtim, është shumë e rëndësishme të nënvizojmë tre kontributet më të mëdha të NATO-s, dhe në një shkallë të caktuar edhe të pasardhësit të tij, misionit ushtarak të Komunitetit Europjan:

- Ekipe për lidhje, shumë fleksibile për adaptim, me mundësi të qarta operative për zgjedhjen e problemeve;

[38] "Operacioni Konkordia" i UE-së ka detyra të ngjashme si operacioni paraardhës i NATO-s që kryesisht të shfaqë prani të qartë në rajonet potencialisht jostabile derisa të ndërtohet mirëbesimi, të sigurojë evakuim emergjent për vëzhguesit ndërkombëtarë, të mbajë lidhje me aktorë të shumtë ndërkombëtarë dhe vendor, të këshillojë dhe të bëjë koordinimin rreth sigurisë së kufirit sëbashku me vendin nikoqir. NATO-ja edhe më tej i ka tre role: rolin këshilldhënës për reformat e mbrojtjes në kontekst të anëtarësimit në NATO; të ndihmojë në menaxhimin e sigurisë së kufirit, me tendencë që detyra për kontrollin e kufirit të bartet prej armatës te një kontingjent i policisë kufitare dhe, si mbështetje logjistike për KFOR-in. Pres konferenca e NATO-s 8 maj 2003.

[39] Në Maqedoni, NATO-ja vazhdon ta mbajë shtabin e prapavijës për KFOR, misionin këshilldhënës për siguri dhe misionin Civil për lidhje të cilin e udhëheq i dërguari i posaçëm i Sekretarit Gjeneral.

[40] Intervista e GNK-së me një ish-zyrtar të lartë ushtarak në Maqedoni. Zyrtari theksoi se ishte i papërshtatshëm vednimi që misioni për kufirin Kosovar të konsiderohet si mision i zakonshëm i "policisë kufitare" pasiqë shumica e aktiviteteve përfshijnë jo vetëm patrullim por edhe vendosje të pritave dhe kryerje të operacioneve tjera që për nga natyra më tepër janë ushtarake.

[41] Më 21 korrik 2003, ministrat e jashtëm të UE-së u pajtuan ta vazhdojnë misionin "Konkrodia" deri më 15 dhjetor. Në shtator një shtabi multinacional të EUFOR-it e morri udhëheqjen e misionit nga shtabi françez.

[42] Intervista e GNK-së 19 korrik 2003.

- Sigurim të dukshëm për të ndërprerë incidentet e izoluara që të erruptojnë në konflikte me përmasa më të mëdha; dhe,
- Përkujtues i prekshëm (konkret) për betimin ndërkombëtar ndaj marrëveshjes paqësore të Ohrit.

Rëndësia e ketyrë kontributeve për banorët shqipëtarë në përgjithsi, dhe në veçanti për Ali Ahmetin, nuk mundet asesi të tejvlerësohet. Që nga ditet e hershme të misionit të NATO-s, udhëheqësi i BDI-së Ali Ahmeti, ka bërë shunë të qartë se ai e konsideron komunitetin ndërkombëtar, e jo zyrtarët e Maqedonisë, si garantues të vërtetë të marrëveshjes paqësore të Ohrit. Përgjigja e tij ndaj kriticizmit të marrëveshjes së Ohrit nga ana e udhëheqësve të tjerë shqipëtar ishte, "Nëse ne proklamojmë që marrëveshja paqësore e Ohrit është tanimë e vdekur, atëherë ne do të duhej të proklamonim (shpallnim) Shtete e Bashkuara të Amerikës, Komunitetin Europjan si edhe NATO-n të vdekur".[43] Edhe më tutje i dëshpëruar nga largimi i forcave të NATO-s, një nga zyrtarët e lartë të BDI-së, ca kohë më parë theksoi se ata në përgjithsi janë indifferent në faktin që Konkordia do të largohet. Gjithsesi, ata janë fortë të bindur në atë që policia pasardhëse e Komunitetit Europjan do të jetë shume e aftë, aktive dhe të angazhuar.

## E. ELEMENTET E MISIONIT TË SUKSESSHËM TË SIGURISË

Për interes më të mirë të të gjithëve, Komuniteti Europjan dhe NATO-ja duhet që të bashkëpunojnë që të përgadisim një vlerësim të sigurisë së përgjithshme që do të reflektojë gjykime të sakta të kohës së caktuar në lidhje me egzistimin e rrezikut të mundshëm. Për këtë janë të nevojshme pesë hapa të ndryshme. Së pari, ata duhet që të përballojnë optimizmin e pamasë. Ndërprerja e hershme e patrullave në rrugën problematike Tetovë -- Jazhincë deri më tani është vërtetuar si gabim të cilit duhej ti kthehen prapa.[44] Duke e pasur parasysh marrëdhëniet jo të lehta ndër etnike, secili mundet shumë lehtë të parashikojë nevojën e vazhdueshme të prezencës për ndërtimin e konfidencës në vendin tonë pas dhjetorit. Eksplodimi i bombës fatale në fshatin Sopot në mars të vitit 2003 (që sipas të gjitha gjasave kishte për qëllim forcat e sigurimit të Maqedonisë) si edhe ngatërresat kundër armatës në prill të vitit 2003 në fshatin Tanush, ku edhe në fillim krisi konflikti i parë në vitin 2001, si edhe skandalit që ndodhi ne operacionin në Brezë janë përkujtues së mosbesimit të thellë.

Së dyti, misioni Konkordia duhet të kërkojë çdo lloj të mundësisë për të ndarë dhe për të transferuar të përgjegjësisë. Patrullat e përbashkëta të forcave të sigurimit të Maqedonisë duhet të llogarisin në sygjerimet që Maqedonia po bëhet "e varur në aspektin e sigurisë" dhe që duhet të ndihmojnë në ndërtimin e besimit të shqipëtarëve. Ekstraktimi i ushtrimevë të përbashkëta do të kishin qenë një mënyrë tjetër për ndërtimin e besinmit të nevojshëm që armata në tërësi të ndërmarë të tërë misionin e sigurisë.

Së treti, Maqedonia duhet që të bëjë pozitën e saj të pranishme në prezencën ndërkombëtare të pavarur dhe për atë se si kjo mund të ndikojë ndaj gjasave për anëtarësim në Komunitetin Europjan ose në NATO. Gjatë kohës së konflikti të vitit 2001, shumë maqedonas u penduan për largimin shumë të hershëm të forcave të sigurisë të Kombeve të Pashkuara (UNPREDEP-it). Ata duhet të kenë parasysh që konflikti mundet që të jetë plasaritja më e madhe për shpresat e tyre për anëtarësi. Qëllimi kryesor i kartës (marrëveshjes) së Adriatikut, të nënshkruar midis Shteteve të Bashkuara, Kroacisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë në 2 maj të vitit 2003, sin ë të vërtetë edhe marrëveshjes të nëntorit të vitit 2002 të samitit të Pragës, ishte që Kroacia, Shqipëria dhe Maqedonia, munden të shpresojnë në pjesmarrje në zgjerimin e ardhshëm të NATO-s. Komuniteti Europjan dhe NATO-ja duhet të bëjnë të qartë që gjasat e Maqedonisë nuk do të jenë të ndikuara nga prezenca e misioneve paqëruajtëse. Tentimet e Shteteve të Bashkuara që të regrutojnë Maqedoninë në koalicionin ushtarak kundër Irakut kanë keqësuar argumentin që Maqedonia është "konsumator i sigurisë", e jo "kontribues i sigurisë" që meriton vëmendjen e NATO-s. Shqipëtarët dhe një numër i madh i maqedonasve besojnë që bashkimi me forcat e NATO-s do të ndihmojë në stabilizimin e vendit por dy të tretat e këtyre anketave të kohës së fundit besojnë që Maqedonia ose "kurrë" ose "jo së shpejti" nuk do të arrijë këtë.[45]

---

[43] "Marrëveshja e Ohrit e Ahmetit kundër ndarjes së Maqedonisë së Xhaferit" citat në *Dnevnik Shkup,* 27 maj 2003.

[44] Kur në janar 2003, tensionet u rritën atëherë misioni "Harmonia Aleate" i udhëhequr prej NATO-s me të shpejtë i rikthei patrullat e veta për ta qetësuar komunitetin vendor. Patrullime të tilla bëheshin në mënyrë rUtinore edhe prej misionit paraardhës të NATO-s Dhelpra e Kuqremtë.

[45] Sondazh në *Dnevnik Shkup* 22 mars 2003; citat në *Dnevnik dhe Utrinski Vesnik* rreth një ankete të realizuar

Së katërti, NATO, Komuniteti Europjan dhe Maqedonia duhet të zhvillojnë një mission policor që do të ruajë potencialin që të lidhet me ndihmën ushtarake. Siç spjegoi edhe një ish komandant i forcave të NATO-s, efektiviteti i ekipeve të tij për lidhje që kishin armatim të lehtë varej në të shumtën nga mundësia për të thirur në ndihmë fuqinë e armatosur. Nëse gjendja e sigurisë vazhdon edhe më tutje të përmirësohet, ekipet për lidhje të Konkordisë duhet që të zëvendësohen nga një Mision Monitorimi nga Komuniteti Europjan (EUMM) që është i përforcuar, i zgjeruar dhe qartë i dukshëm krah për krahu me misionin për ndihmë policore të Komunitetit Europjan.[46] Kredibiliteti (besueshmëria) e Misionit të Monitorimit të Komunitetit Europjan (EUMM) do të rritet shumë nëse ata edhe formalisht do të ishin inkorporuar në strukturën e EUFOR-it (Forcave Europjane). Që të dyja, Misioni për Monitorim i Komunitetit Europjan (EUMM) dhe policia e Komunitetit Europjan duhet që të kenë të drejtën të kërkojnë ekstraksion, nëse kjo është e nevojshme, nga mjetet disponuese të NATO-s të bazuar qoftë në Maqedoni apo në Kosovë. Nëse NATO-ja dhe Komuniteti Europjan ndërprejnë mosmarrëveshjet e veta, zgjidhja ideale do të ishte që të futet në përdorim të sipërt Shtabi kryesor i forcave të NATO-s për Kosovë (njësitë mbështetëse të KFOR-it në Maqedoni) si një forcë e përbashkët për mbështetje e Komunitetit Europjan dhe NATO-s. Nëse Misioni Monitorues i Komuniteti Europjan (EUMM) dhe zyrtarët e Maqedonisë do të besonin se tensioned janë duke u zmadhuar dhe që shpërndarja e armatës do të shkaktonte keqësimin e gjendjes momentale, atëherë do të ftoheshin që forcat ushtarake që janë si mbështetje e KFOR-it në Maqedoni të ndihmojnë nën flamurin (sqetullat) e Komunitetit Europjan. Kjo do ti mundësonte Maqedonisë që të ruajë sigurinë të forcave reserve pa mbajtur ndonjë mission afatgjatë të forcave paqëruajtëse në trollin e saj.

Së pesti, Kostovi dhe ndihmësit e tij do të kishin benificuar nga ajo që në sqetullat e tyre të kishin një zyrtar policor të lartë që do të kishtë mundësinë që të kërkonte mbështetjen politike nga komuniteti ndërkombëtar në Shkup dhe në Brisel në të njejtën mënyrë që e bën edhe gjenerali britanez i brigadës në ministrinë e mbrojtjes. Një zyrtar policor me një gradë adekuate nga ndonjë nga shtetet e Komunitetit Europjan do të mundej që të koordinojë edhe pasqyrën të gjithëmbarshme dhe të ndihmojë në çështjet operative.

Deklarata për misionin policor "Proxima" është një fillim shumë i mirë. Ajo identifikon prioritetet siç janë mbështetja e konsolidimit të shtetit juridik, përfshirë këtu edhe luftën kundër krimit të organizuar; implementimin e reformave të gjithëmbarshme të ministrisë së punëve të mbrendshme, përfhsirë edhe policinë; tranzicion operativ përpara, si edhe krijimin e një policie kufitare, si pjesë përbërëse e tentimeve më të gjëra të Komunitetit Europjan për të promovuar udhëheqjen e integruar të kufijve; ndërtimin e besimit të banorëve vendor ndaj policisë; dhe zmadhimin e bashkëpunimit policor me shtetet fqinje.[47] Gjithsesi, duhet domosdo të gjenden burimet e nevojshme dhe vullneti politik që të mund të arrihen këta qëllime.

rishtazi prej Institutit për Hulumtime sociologjike, politike dhe juridike. Sondazhi i IRI-t tregoi se 71 përqind të qytetarëve e mbështesin anëtarësimin në NATO.

[46] Misioni Vëzhgues i Unionit Evopian (EUMM) është pasaardhës i Misionit Vëzhgues të Komisionit Evropian. Mision ky i përbërë prej vëzhguesve të paarmatosur prej 15 shteteve anëtarë të Unionit Evropian, Norvegjisë dhe Sllovakisë. Vepron në pesë shtete të Ballkanit Perëndimor dhe drejëpëdrejt i raporton Havier Solanës Përfaqësuesit të lartë të Unionit Evropian për politikë të përbashkët të jashtme dhe siguri. Zinxhiri i ndarë i komunikimit për EUMM-në (si edhe për paraardhësin e saj) donte të thotë se nuk ishte gjithnjë mirë i integruar, edhe përskaj aktiviteteve tjera të UE-së në terren.

[47] Neni 3 i propozim konkluzioneve të Këshillit për Akcion të Përbashkët rreth një Misioni të Unionit Policor Evropian (EUPOL) në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 29 shtator 2003

# III. MOSKËNAQËSITË EKONOMIKE

Përderisa mjerrimet ekonomike janë pjesë e ambientit jetësor në shumë shtete në periudhën e tranzicionit, në Maqedoni ata shumë shpesh bartin implikime të drejtëpërdrejta në sigurinë. Papunësimi i pandërprerë tanimë pothuajse paraqet një premtim të paplotësuar të marrëveshje paqësore së Ohrit për shumë shqipëtarë. Siç theksoi edhe Mersel Billali nga partia e vogël shqipëtare Partia për Prosperitet Demokratik, "Sektori ekonomik dhe ai social është prioriteti ynë i vërtetë. Është shumë e qartë se qytetarët e Maqedonisë po bëhen edhe më të vobegët në mënyrë shumë të shpejtë (rapide).[48]

Në këta dymbëdhjetë vjet të pavarësisë së saj Maqedonia ka humbur një të katërtën e të ardhurave të saja kombëtare.[49] Përqindja zyrtare e papunësimit ishte 32 përqind në vitin 2003 (numrat e vërteta do ti jenë disi pak më të mira për shkak të punësimit të paparaqitur në sektorin jozyrtar).[50] Përmirësimi ekonomik ka mbetur i pakuptueshëm edhe në fillim të vitit 2001, kur Prodhimi i Përgjitshëm Kombëtar pati një rënie prej 4.1 përqind. Zhvillimi në vitin 2002, më së shumti në sektorin e shërbimeve, ishte 0.3 përqind të mjerueshme.

Në fillim të shkurtit të vitit 2002, qeveria u dakordua me Fondin Ndërkombëtar Monetar (FNM) për një aranzhman të ri (Stand-Up Aranzhman) në vlerë prej 27 milionë dollarë amerikan që me vete tërhoqi edhe disa mijëra dollarë që u ndanë në blloqe të ndryshme në formë të fondeve për donacione.[51] Atëherë u imponuan edhe kushte shumë të vrazhda, përfshirë këtu edhe shkatërrimet apo privatizimet e ndërrmarjeve që për kohë të gjatë kishin humbje si edhe maksimumin e punësimit në sektorin shtetëror (administratën shtetërore) (me një përjashtim të veçantë për policinë), dhe kërkonte që qeveria të përmirësojë balansimin e saj vjetor për 135 milionë dollarë amerikan ose nëpërmjet të prerejes së buxhetit ose nëpërmjet të të ardhura të reja. Koalicioni socialdemokratik dhe liberalo demokratik zgjodhi të ardhurat e reja duke rritur tatimin e vlerës së shtuar (TVSh) në një varg të madh të prodhimeve prej 5 përqind në 18 përqind.[52] Fondi Ndërkombëtar Monetar (FNM) gjithashtu imponoi edhe kufizim për deficitin buxhetor prej një përqindje strikte të ashpër prej 2 përqind të Bruto Prodhimit Kombëtar, duke shpresuar që përgjegjsia fiskale do të ndihmojë në lehtësimin e politikës monetare dhe se do të zvoglojë apo zhdukë përqindjet e mëdha të interesit në Maqedoni.

Që të presësh për medikamentet e forta për punë nuk është shumë lehtë. Fondi Ndërkombëtar Monetar priste që Maqedonia të ketë së paku 1 përqind të rritjes nga ata tre përqind të parashikuara për rritjen e Bruto të Ardhura për vitin 2003, por një raport kundërthënës nga një ekonomist i respektuar ndërkombëtar konkludon se rritja e të Bruto të Ardhurave Kombëtare do të jetë më e vogël se 1 përqind.[53] Duke u bazuar në mbikqyrjet anegdotale (të rastit), një investitor me eksperiencë beson që ekonomia edhe më tutje është në stagnim të sipërt, me disa zvoglime të harxhimeve dëshpëruese bër furnizim të qeverisë.[54]

Disciplina rigoroze fiskale po jep efektet e dëshiruara në politikën monetare -- kamatat (intereset) e Bankës Qëndrore janë zvogëluar prej 16 përqind në vetëm 7 përqind -- por në të vërtetë intereset për hua dhënie janë edhe më tutje me kokëfortësi të larta për të gjithë përveç për huamarrësit e mirë. Bankat edhe më tutje ju largohen dhënies së huazimeve në rajonet e mëparshme të krizës, duke qenë të bindur së huamarrësit shqipëtarë janë rrezik i keq kreditor dhe që policia dhe gjyqet do të jenë nuk do të shfaqin dëshirë që të grumbullojnë borxhet me përdorimin e forcës. Egziston edhe mosdëshirë për huazimin në përgjithsi në rajonet e mëparshme të krizës; madje edhe vetë banorët maqedonas në pjesën perëndimore të Maqedonisë kanë vështirësi në marrjen e krediteve (huazimeve).

[48] "Destabilizimi i mundshëm i Maqedonisë për shkak të problemeve ekonomike dhe sociale", Radio Evropa e Lirë shërbimi në gjuhën maqedonase, 7 maj 2003.

[49] Në rajon vetën Serbia dhe Mali i Zi shfaqën rënie më të mëdha, të ardhurat e tyre janë përgjysmuar prej kohës së shkatrimit të Jugosllavisë. Shih "Brënda 12 vjetëve, Maqedonia humbi një çerek të të ardhurave shtetërore", *Vest*, 8 maj 2003 citat i *Tajms* Londër.

[50] Madje, rritja e papunësisë mesiguri nuk është ilizion. Të dhënat e sondazhit të UNDP-së i pasqyrojnë frikat sa i përket papunsisë dhe sigurisë për punë" duke treguar se këta probleme jo vetëm që janë të sprovuar si shumë serioz, por ato gjithashtu perceptohen të jenë bërë edhe më akute se gjatë kohës së sondazhit të realizuar në shtator 2001. Hulumtimi i UNDP-së, op.cit. faqe 24.

[51] Bordi i Drejtorëve të FNM-së e miratoi stend-baj marrëveshjen më 30 prill 2003.

[52] Shkalla e përgjithshme e TVSH-së u zvogëlua për një pikë, prej 19 përqind në 18 përqind. Rritja e tatimit sjelli kritika të kondsiderueshme ndaj ministrit të Financave Petar Goshev.

[53] Intervistë e GNK-së me përfaqësusesin e FNM-së për vednin, 21 korrik 2003.

[54] Intervistë e GNK-së me menaxher investues, 17 korrik 2003.

Duke pasur parasysh që të dyja, edhe vështirësitë për sigurimin e krediteve (huazimeve) edhe pasigurinë në përgjithsi, shumë afaristë maqedonas largohen nga rajonet problematike të Maqedonisë Perëndimore.[55] Një ndërmarje (kompani) greke me aksione të tyre në Maqedoninë Qëndrore hodhi poshtë mundësinë që të blejë një fabrikë në afërsi të Tetovës për shkak të brengave lidhur me sigurinë, duke preferuar që të ndërtojë një fabrikë poltësisht të re në Greqi me kosto (harxhime) disa herë më të mëdha.[56] Përderisa investimet e banorëve shqipëtarë vazhdojnë edhe më tutje në Tetovë dhe në rajonet tjera, është ndoshta e pamundur që të ndryshojnë rritjen e nevojshme të punësimit për absorbimin e numrit të shpejtë të zgjerimit të krahut punëtor të ri shqipëtar, përfshirë këtu edhe ish luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Është gjithashu u mundshmë Që "minoritarët" maqedonas të mbesin të paaftë që të gjejnë punësime në rajonet ku dominojnë shqipëtarët. Shumica e të papunësuarve detyrohen që të kërkojnë punë jashta shtetit ose të mbesin qëndrojnë pa punë; shumica e maqedonasve do të mbesin të papunësuar dhe ndoshta do të largohen nga Maqedonia Perëndimore. Maqedonia Lindore e depresuar gjithashtu është duke dërguar një numër mjaft të madh të qëndrueshëm të të rinjve jashta vendit.[57]

Në bazë të emergjencës së kërkuAr nga Fondi Ndërkombëtar Monetar, qeveria ka ndër mend të zvoglojë numrin e të punësuarve në administratën shtetërore për 4 përqind, duke pushuar nga puna 4.000 punëtorë.[58] Egzistojnë frigësime, gjithsesi, se "shtërngimi i mëtutjeshëm i rrypit" mund të shkaktojë greva edhe shqetësime. Pothuajse dy të tretat e pjesmarrësve në anketimin e bërë nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) thonë se ata do të kishin marrë pjesë në greva dhe demostrata në lidhje me papunësinë dhe me rrogat mujore; pothuajse gjysma e tyre prisnin dhunë të shkaktuar nga situate ekonomike.[59] Disa nga mbikqyrësit besojnë se udhëheqësi ambicioz i sindikatave Vanço Muratovski do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në vitin 2004.[60] Kryetari i bashkësisë më të fortë nën ombrellën e sindikatave ka shfaqur brengat e tij se Muratovski mundet të kërkojë që punëtorët të ngrehen në greva me qëllim të avansimit të rednit ditor të politikës.[61] Mundësia për zgjerimin edhe në rajonet etnike është shumë e qartë. Në 16 korrik të vitit 2003, 600 punëtorë të pushuar nga puna të ndërmarjes hstetërore energjetike u përleshën me policinë para Parlamentit të Republikës së Maqedonisë.[62] Ata ishin të hidhëruar nga një pjesë e deputetëve shqipëtarë në Parlament për atë që këta përjashtime nga puna janë positive sepse me këtë shqipëtarët do të rrisnin përqindjen e të punësuarve si fuqi punuese në këtë ndërmarje.

Muratovski dhe politikanët e partive opozitare kuptuan që qeveria e Cërvenkovskit është e ndjeshme në aspektin ekonomik. Kritikat më të shpeshta që po ndodhin janë se koalicioni qeveritar nuk ka një program të fortë ekonomik dhe se është shumë i ngadalshëm në adoptimin e reformave. Qeveria e vjetër e VMRO-DPMNE-së, edhe përkundër të gjitha thënieve për korruptimin e tyre, në një mënyrë ndërmori disa masa të rëndësishme[63] por mbikqyrësit tani shikojnë shumë pak dinamizëm në qeverinë e udhëhequr nga SDSM-ja, veçantërisht me lënien pas dore të bujqësisë (agrikulturës). Shumica e fermerëve, me një qasje shumë të vogël kah tregjet e jashtme, pranojnë shumë çmime të ulëta -- bostanët e shitur para ca kohe kishin çmim më të ulët se një cent (një të qindën) për kilogram në disa rajone. Ministria e ekonomisë dhe e bujqësisë me të madhe kanë dështuar në zhvillimin e një programi për të ndihmuar fermerët e vegjël që të munden të përballojnë standardet teknologjike dhe administrative për eksportimin e prodhimeve.

Qeveria edhe më tutje vazhdon të jetë e stërhjekur midis disa qëllime kompetitive:

- Nevoja për të mundur deficitin dhe punësimet në administratën shtetërore dhe eliminimin e ndërmarjeve joprofitabile shtetërore;[64] përderisa

[55] Intervistë e GNK-së me një menaxher investues në firma të Maqedonisë perendimore, 17 korrik 2003.
[56] Intervistë e GNK-së me redaktorin e magazinit *Kapital* Ljupço Zikov, 11 korrik 2003
[57] Një Ambasadë perëndimore i tha ICG se kërkesat për vizat janë pothuajse janë dyfishuar secilin vit pas konfliktit, me një rritje të mprehtë midis të rinjve nga Maqedonia.
[58] ICG intervistst me Sekretarin Shtetëror të Ministrisë së Financave Kargov, 15 Maj 2003.
[59] UNDP Sondazh, f. 26.
[60] Intervistë e GNK-së me redaktorin e magazinit *Kapital* Ljupço Zikov, 11 korrik 2003.
[61] ICG intervistë, Shkup, 21 Qershor 2003.
[62] "Punëtorët e larguar nga EEM (Elektroekonomia e Maqedonisë) u përleshën me policinë", *Dnevnik- Shkup,* 17 korrik 2003.
[63] Ish ministri i financave Nikolla Gruevski, kryetari i ri VMRO DPMNE, është lëvdëruar për reformat e rendësishme që kyçnin edhe futje në funskion të TVSH-së dhe kartelën shtetërore për pagesa dhe menaxhment të suksesshëm me ministrinë.
[64] Deficiti më së shumti është i trashëguar. Në vigjile të zgjedhjeve, qeveria e VMRO DPMNE-së shpalli rritje prej 10 përqind të rrogave në sekotrin publik dhe një plan për

- stimulohet ekonomia dhe ngritja e përgjithshme e punësimit -- në veçanti punësimin në sektorin publik të banorëve shqipëtarë ashtu siç kërkohet në marrëveshjen paqësore të Ohrit.[65]

Banka Botërore është duke punuar në një strategji për të ndihmuar. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka filluar një iniciativë me disa nga afaristët më të suksesshëm të Republikës së Maqedonisë, përfshirë këtu edhe Svetozar Janevskin nga Birraria e Shkupit. Grupi ka zhvilluar një plan me të cilin kërkojnë investitorë të jashtëm dhe, duke e përqëndruar vemendjen e zyrtarëve më të lartë qeveritar për betimet e propozuara, që të tejkalojnë barrierat administrative për investimet.[66] Sinjalet më të mëdha drejtuar investitorëve do të ishin inkurajuese për anëtarësimin në Komunitetin Europjan, por lidhur me këtë shumë pak shpresa dolën nga Samiti i Komunitetit Europjan që u mbajt në qershor të vitit 2003 në Selanik. Në bazë burimeve nga Qeveria e Maqedonisë, zyrtarët e lartë të Komunitetit Europjan kanë diskurajuar Shkupin për të aplikuar në këtë kohë, si edhe mos hyrja edhe më tutje në fuqi e Paktit për Stabilitet, e nënshkruar në prill të vitit 2001, për shkak të mosratifikimit nga tre shtetet anëtare të Komunitetit Europjan: Italia, Finlanda dhe Belgjika.

Por, edhe nëse Maqedonia mbaron reformat e mëdha, siguria edhe më tutje mbetet si brenga më e rëndësishme. Siç tha edhe vetë Kryeministri Branko Cërvenkovski tha, "Ne nuk mundemi të presim përmirësime të rëndësishme në lëminë e ekonomisë përderisa ne nuk e stabilizojmë sigurinë në shtetin tonë".[67]

## A. Identiteti dhe Vështirësitë për Punë

Ministri i Finansave Petar Goshev shumë më shpesh ka përjetuar fajësime për vështirësitë ekonomike në krahasim me Kryeministrin Branko Cërvenkovskin dhe me MInistrin e Ekonomisë Ilija Filipovskin. Një porosi e cila rrodhi nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës theksonte "dyshimet rreth asaj që a thua Ministri i Finansave është në nivel të detyrave që ka ai" për implementimin e Stand-by Aranzhmanit.[68] Por, kur ai mbështetej në udhëzimet e dhëna nga Fondi Ndërkombëtar Monetar, banorët etnik shqipëtarë e kanë akuzuar atë për blokim qëllimkeq të punësimeve të cilat u takojnë atyre në bazë të Marrëveshjes paqësore të Ohrit.

Si anëtar i fraksionit që është relativisht më i vështirë në partinë Liberale Demokratike dhe si i njohur për qëndrimet e tij të ashpra në aspektin e çështjeve etnike, Petar Goshevi është personifikim për shumë banorë maqedonas për rezistimin ndaj marrëveshjes paqësore të Phrit. Nënkryetari i partisë Bashkimi Demokratik për Integrim, Agron Buxhaku tha, "Goshevi është duke blokuar gjithçka", përfshirë këtu edhe punësimin e shqipëtarëve në zyrat rajonale të qeverisë.[69] Gjatë kohës së negociatave lidhur me punësimet, thuhet se Goshevi ka qenë kundër dorrëzimit të cilit do sektor të ministrisë së tij në duart e ndonjë shqipëtari. Ai denuncon (mohon) se ai ka qenë pengesë për punësimin e shqipëtarëve, dhe në fakt thotë se rreth 900 shqipëtarë të ri janë punësuar.[70] Në të vërtetë, Fondi Ndërkombëtar dhe Qeveria u dakorduan që të vendosin një maksimum të rrogave dhe të imponojnë një rregull në rrjetin e ri të punësimit, përveç për punësimet të cilat rrjedhin nga Marrëveshja e Ohrit në polici dhe në lëminjtë e tjera.[71] Të gjitha punësimet e reja qeveritare kërkojnë pëlqimin nga ana e ministrisë së financave.

Duke pasur parasysh rëndësinë e punësimeve, takimet e drejtëpërdrejta midis Petar Goshevit dhe Ali Ahmetit kanë kaluar kohën që moti. Dispozitat për

---

kthim të parave të deponentëve në skandalin piramidal TAT në vitin 1997. Këto pako e fryen deficitin derin në rreth 6 përqind të BPV-së (GDP). Maqedonia gjithashtu u ngarkua me pagesën e pensioneve, me 8.2 të BPV (GDP), më e lartë se shteteve më të pasura siç janë Hungaria dhe Kroacia BPV (GDP) e të cilave është më se tre herë më e madhe. "iRJM: Status raporti i decentralizimit" no 24305, Zvogëlimi i varfërisë dhe Njësia e Menaxhmentit Ekonomik, Njësia për Evropë dhe Azinë Qëndrore, Banka Botërore, 15 shtator 2003, raporti është në disponim në www.worldbank.org.

[65] Konferenca e donatorëve, me 12 mars 2002, premtoi përafërsisht $25 milion dollarë amerikan për t'i mbuluar shpenzimet e lidhura me Ohrin, si për shembull punësimi i përkthyesve shqiptar në gjykata dhe parlament.

[66] Intervista e GNK-së me Svetozar Janevski, Drejtor Gjeneral i Birrarisë Shkup, 28 korrik 2003.

[67] Intervistë e Radio Evropa e Lirë me kryeminstrin Cërvenkovski, citat në *Dnevnik-Shkup* 21 korrik 2003.

[68] "Batler: Dyshimi rreth asaj nëse ministri i Financave është aftë për marrëveshjen me FMN është brengosës", *Kapital*, 20 shkurt 2003.

[69] Intervistë e GNK-së, 21 korrik 2003.

[70] Intervistë e GNK-së, 11 korrik 2003 . Goshev gjithashtu pohoi se ripunësimi i Luenjve keq i ka goditur financat dhe numrin e pozitave për shqiptarët në administratën shtetërore.

[71] Intervistë e GNK-së me Sekretarin shtetëror në ministrinë e Financave Kargov më 15 maj 2003. Ai tha se qeveria duhet ta zvogëlojë numrin e nëpunësve shtetërorë për 4 për qind, duke nxjerrë nga puna rreth 4000 punëtorë për shkak të presionit nga FMN-ja.

"përfaqsim reciprok" të shqipëtarëve në administratën qeveritare (si edhe të minoriteteve të tjera) edhe më tutje mbetet një nga elementet më të ndjeshme të Marrëveshjes paqësore të Ohrit.[72] Duke e pasur parasysh mbështettjen e banorëve maqedonas në punësimet në administratën shtetërore, tentimet për punë shumë shpesh duke si një shumë e barabartë me zero nga garrimi.[73] Banorët shqipëtarë kanë 11 përqing të punësimeve në pozita të ndryshme të punësimit në administratën shtetërore, dhe shumica e tyre janë në nivele shumë të ulëta.[74] Të pyetur për atë që të emërojë elementet më të rëndësishme të marrëveshjes paqësore të Ohrit (përveç decentralizimit), kryetarët shqipëtarë të komunave të pyetur nga ICG, më së shpeshti përmendin punësimin në sektorin publik.[75]

Zëvendësi i Kryeministrit që është i tejngarkuar me punë, Musa Xhaferi nga BDI-ja, është ngarkuar me kënaqjen e pritjeve të punësimeve të banorëve shqipëtarë pa ofenduar as Petar Goshevin e as Fondin Ndërkombëtar Monetar. Me qëllim që të evitojë konfrontimin ekeqardhjes së maqedonasve të pushuar nga puna në favor të punësimeve të reja të shqipëtarëve, zyrtarët ndërkombëtarë kanë tentuar që të zvoglojnë pritjet e shqipëtarëve. Këshilltarët tani ndahen midis "përfaqsimit proporcional (kuotat e rrepta) dhe qëllimit të marrëveshjes së Ohrit për "përfaqsim të barabartë" (procesi i punësimit korrekt) dhe sygjerojnë një punësim më lehtë të pranueshëm dhe më pak të dhimbshme të ndërrimit të fuqisë punuese shtetërore. Gjithsesi, vetëm 1.400 maqedonas dalin në pension secilin vjet.[76]

Duke gjetur pozita për shqipëtarët në pozitate e reja të punës që rrjedhin nga marrëveshja e Ohrit gjithashtu janë shfrytëzuar që të zbusin tensionet. Në 14 prill të vitit 2003, qeveria aprovi pesë hapat, përfshirë këtu edhe punësimin e përkthyesve për mbledhjet parlamentare, qeveritare dhe në Gjyqin Suprem si edhe në agjensitë tjera qeveritare dhe krijimin e më shumë posteve dygjuhësore.[77] Gjithashtu është e dakorduar që të vendoset një program për trajnimin që rë ndihmojë kandidatët shqipëtarë të plotësojnë kërkesat. Xhaferi dhe zyrtarët e tjerë të BDI-së janë të përgaditur gjithmonë të pranojnë që niveli i arsimit midis shqipëtarë -- jo vetëm obstrulcionet nga maqedonasit -- paraqesin një pengesë shumë të madhe. Ajo që mund të jetë mjë model për tu drejtuar deficitit arsimor, 600 ish ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe shqipëtarët kanë nevojë për arsimim plotësues në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë duke filluar në muajt e fund të vitit 2003. Qëllimi për përfaqsimin e barabartë është edhe më tutje shumë modest: vetëm 2 përqind rritje në vitin 2003 që do të vendoste përfaqsimin e shqipëtarëve dike midis 13 dhe 14 përqind. Kjo domethëne që të gjinden 2.400 pozita, rreth 1.600 në Ministrinë e Punëve të Mbrendshme dhe në mbrojtje dhe 700 të tjera në ministrinë e arsimit dhe në ministrine e shëndetsisë.

Armata është një lëmi e tejmbikqyrur për përfaqsimin e barabartë. NATO po kërkon nga qeveria që të ulë numrin e armatës së Maqedonisë prej në 60.000 ushtarë (përfshirë këtu edhe 45.000 rezervistët ushtarak) -- në një numër prej 6.500 ushtarëve.[78] Momentalisht shqipëtarët përbëjnë vetëm 4.5 përqind të numrit të përgjithshëm. Për më shumë se 50.000 shkarkime nga puna, në të cilën në numër shumë më të madh do të përfshihen maqedonasit, zyrtarët vlersojnë se do të jenë të nevojshme rreth 40 milion dollarë amerikan për këta paqetime të ashpra Ministri i Mbrojtjes Vllado Buçkovski është betuar se do të zmadhojë numrin e përqindjes së shqipëtarëve në armatë,dhe deri më tani janë bëre edhe disa arritje paraprake për këtë, veçantërisht me regrutimet të femrave. Gjithsesi, armata nuk do të arrijë 14

[72] Paragrafi 4,2 i Ogrit imponon masa "të sigurojë përfaqësim të drejtë të komuniteteve në të gjithë trupat qëndror dhe vendor në të gjitha nivelet e punësimit, njëkohësisht duke respektuar rregullat sa i përket kompetencës dhe integritetit që e drejton administrata publike. Autoritetet do të ndërmarrin veprime për përmirësimin e disbalansit të pranishëm në përbërjen e administratës publike, veçanërisht duke rekrutuar anëtarë të komuniteteve që janë të përfaqësuar më pak.

[73] Sipas ministrit Goshev, buxheti ka kosto të lartë të fiksuar: 36 përqind për rrogat e të punësuarve shtetërorë dhe 27 përqind për pensionet. Diku rreth 128.000 punojnë në sekotrin publik, një numër jashtëzakonisht i madh për një vend të vogël. "Administrata publike në Maqedoni", *Forum,* 4 korrik 2003.

[74] Në vitin 2000, vendet në sektorin publik, për sa i përket përkatësisë etnike, ishin shpërndarë si vijon: 84.9 përqind maqedonas, 10.2 përqind shqiptar, 1.8 përqind turq, 1.6 përqind serbë dhe 0.9 përqind romë e vllehë dhe 1.1 përqind me përkatësi të panjohur etnike. Shih "Në polici dhe armatë ka 1600 punonjës administrativ shqiptar", *Utrinski Vesnik,*26 mars 2003.

[75] Intervista e GNK-së me prefektët shqiptarë, janar-shkurt 2003.

[76] Burime të UE-së thonë se do të nevojiten 2000 vende pune në vit për ta arritur madje edhe përqindjen e redukuar prej 14 përqind të punësimit të shqiptarëve.

[77] Shih "Projekt për realizim të programit për sa i përket përfaqësimit të drejtë", dokument i qeverisë i miratuar më 14 prill 2003.

[78] Intervistë e GNK-së me zyrtar të sigurisë të NATO-s, 30 prill 2003.

përqindshin e pjesëmarrjes së shqipëtarëve që ishte qëllimi i parashtruar për vitin 2003. Zyrtarët, duke u munduar që të plotësojnë kushtet e reduktimit të armatës, trajtojnë çështjen e përfaqsimit të shqipëtarëve si një çështje të varur.

Tradicionalisht shumë punëtorë në gadishullin Ballkanik -- veçantërisht gjatë ditëve t ëish Jugosllavisë -- lehtësonin mungesën e fuqisë punëtore në shtetet e Europës Perëndimore. KOmuniteti Europjan bashkëkohor është shimë i dyshimtë që përsëri të hapë çështjen shumë delicate të punëtorëve të huaj, veçantërisht tani pasi që në të pranohen tetë shtetet të ish shteteve socialiste (përfshirë këtu edhe një republikë nga ish Jugosllavia). Gjithsesi, regjimi i vrazhdë për të marrë viza udhëtimi që aplikohet për qytetarët e Maqedonisë dhe mosndihma e shteteve fqinje që nuk bëjnë asgjë të ndihmojnë ekonominë e vetë Komunitetit Europjan duke ndihmuar trafikimin e njerëzve dhe duke dënuar (malltretuar) njerëzit e ndershme. Relaksimi i regjimit të vizave udhëtuese mundet që të jetë një mënyrë e mirë që Komuniteti Europjan të dërgojë porosi për qytetarët e Maqedonisë, si edhe të Ballkanit Perëndimor në përgjithsi, që edhe ata i konsideron për europjanë.

# IV. KORUPCION DHE KRIMI I ORGANIZUAR

Vrasja (atentati) i Kryeministrit të Serbisë Zoran Gjingjiq dërgoi një tërhjekje të vëmendjes të nxehtë lidhur me vargun e korrupcioneve zyrtare si edhe me kriminalitetin e organizuar. Në deklaratën e tij pas kësaj ndodhie, Kryeministri Branko Crvenkovski tërhoqi vëmendjen "rreziku nga nënbota kriminele dhe ajo politike nuk duhet të nënvlerësohet, për shkak të faktit të pamohueshëm se në këtë rajon si edhe në secilin shtet në veçanti definitivisht egzistojnë forca të cilat arrijnë rezultatet më të mira nga gjendja momentale e kaosit dhe jostabilitetit".[79] Përderisa situate në Shkup nuk është e njejtë me atë në Beograd, pyetje shumë të ndjeshme janë ngritur lidhur me efektivitetin e luftës kundër korrupcionit dhe kriminalitetit të organizuar. Disa njerëz kanë sygjeruar se egzistojnë lidhje të drejtëpërdrejta midis klanit famëkeq të Zemunit dhe Luenjve. Zëvendës Kryeministri i Serbisë Nebojsha Çoviq në mënyrë të qartë tregoi se njerëz të afërt me klanin famëkeq të Zemunit kanë ushtruar luenjtë, edhe nuk mendon se ka individë nga mafia e Serbisë që operojnë mbrenda në Maqedoni.[80] Brenga të tjera janë ngritur për shkak të investimeve greke në Maqedoni, prej të cilës Maqedonia është shumë e varur, duke qenë në vijën frontale për kapitalin rus që ka një prejardhje të dyshimtë. Zyrtarët gjithashtu janë të brengosur për faktin që hyrja e parashikuar e Qipros në Komunitetin Europjan do të shtynte shumë finansierë të diskutueshëm nga ky ishull të kalojnë në Maqedoni.

## A. FUSHATA E ANTI KORRUPCIONIT: SHKATËRRIM APO LOJË POLITIKE?

Maqedonia filloi sulmin ndaj korrupcionit dhe krimit të organizuar mjaft kohë para vrasjes së Zoran Gjingjiqit. Kryeministri Branko Cërvenkovski, që në fillim të mandatit të tij insistonte që kjo të jetë një shtyllë e administratës së tij. Në një anketë (sondazh) të bërë për këtë, 82 përqind të të anketuarve e mbështetën fushatën.[81] Edhe maqedonasit edhe shqipëtarët e kategorizojnë korrupcionin si një nga problemet

[79] "Cërvenkovski: Rreziku nga nëntoka kriminelo-politike nuk duhet nënçmuar: citat në *Dnevnik-Shkup* 21 mars 2003.
[80] "Xovix thekson lidhjet midis "Klanit të Zemunit" dhe Maqedonisë, *Makfax*, 14 Prill 2003.
[81] Sondazh nga Instituti për Demokraci, Solidaritet dhe Shoqëria Civile, Janar 2003.

më të mëdha. Në anketën e kryer nga Programi për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), vetëm papunësia ka prioritet më të madh se kjo çështje.

Ministri i Punëve të Mbrendshme Hari Kostov në mënyrë shumë agresive ka ndjekur të dyshuarit nga qeveria e mëparshme, 23 prej të cilëve, në bazë të informative dhënë nga OSBE-ja, janë arrestuar, përfshirë këtu e sekretarin gjeneral të partisë që deri vonë ishte në qeveri, Vojo Mihajlovskin si edhe ish Ministrin e Ekonomisë Besnik Fetai. Gjithsesi, shkatërrimi deri më tani ka pasur shumë pak sukses (progress) në gjyq. Katër nga personalitetet më të larta janë lëshuar nga burgimi, përfshirë këtu edhe Vojo Mihaljovskin. Dënimi i vetëm që u bën më vonë edhe u anulua. Zyrtarët e VMRO-DPMNE-së pandërprerë kanë akuzuar që qeveria është duke kryer një hakmarrje politike me prosekutime të selektuara. Gjithsesi, disa nga këta thash e thëna që gjatë kohës së procesit kanë qenë të malltretuar kanë qenë të thelbësuara, sipas informata nga Departamenti për shtetin juridik të OSBE-së.[82]

VMRO gjithashtu ka akuzuar qeverinë se ajo nuk po bën hulumtime policore edhe ndai miqve të tyre për gabimet e tyre të mundshme me ashpërsi të njejtë, gjë që Cërvenkovski dhe Kostovi theksonin se janë të gatshëm të bëjnë. Një rast sprove për trajtimin e barabartë mund të jetë me emërtimin e Slagjana Tasevës (e emëruar nga vetë Cërvenkovski) në qershor tq vitit 2003 për atë që Komisioni Shtetëror kundër Korrupcionit të cilën ajo e udhëheq ka inicuar procedurën me të cilën kërkohet anulimi i vendimit nga viti 1995 për privatizimin e firmës më të madhe për shpedicion kompanisë "Fershped" Sh. A. Shkup, pronarët e të cilës llogariten se janë njerëz shumë të afërt me partinë SDSM. Ajo tha se ajo do të ngrejë procedurë gjyqësore nëse Prosekutori Publik, avokati popullor (Ombudsmani) dhe gjyqet dështojnë të ndjekin tërë rastin e dhënë. Kompania në gjyq arriti që të mundë një tentim të mëparshëm nga qeveria e mëparshme që ta anulojë privatizimin një kohë të shkurtër para se të largohen nga pushteti në vitin 2002. Media në të shumtën e rasteve ka injoruar këtë skandal ose e ka trajtuar atë pa respektin e duhur, ndoshta edhe për shkak të faktit që Fershpedi ka një interese të madh për pronësi ndaj gazetës *Vest.*

Trajtimi i mediave lidhur me çështjen e Komisionit kundër korrupcionit ka ngritur shumë lartë brengat për frigësimin e mundshëm nga ana e qeverisë. Një rast tjtër shumë i rëndësishëm ngërthen në vete vendimin e shkurtit të vitit 2003 për të blerë karburant për një vlerë prej rreth 30 milion dollarë amerikan në prag të luftës kundër Irakut. Qeveria lejoi marrëveshjen për blerjrn e karburantit pa shpallur tender, duke e arsyetuar këtë se kjo është bërë në mënyrë legale dhe se për këtë nuk ka pasur furnizues tjetër të mundshëm.[83] Një burim tjetër kundërshtues me këtë, duke cituar bashkëpunëtorët e industrisë së karburanteve, theksuan se blerja e sasisë së tillë të madhe të karburantit në kushtet normale do të sepej më një lirim të çmimit prej së paku 3 përqind -- në këtë rast diku rreth një million dollarë amerikan. Egzistojnë brenga se ndoshta ky lirim në çmim mund të jetë future nëpër xhepat e dikujt dhe se çmimi edhe më tutje ka mbetur në mënyrë artificiale shumë i lartë edhe pse ky karburant u fut në përdorim në treg kah periudha e përfundimit të armiqësisë me Irakun.[84] Komisioni kundër korrupcionit është duke e shqyrtuar edhe këtë çështje.

Dështimi që të ndiqet edhe më tutje në mënyrë më të ashpër dhe korrekte korrupcioni mundet që të shkaktojë pasoja shumë serioze për besimin e publikut dhe do të kishte reduktuar mundësinë për një zhvillim më të madh ekonomik. Kryeministri ka bërë me dije se vonesat në rastet e korrupcionit "vrasin shpresat e qytetarëve se ne mundemi të dalim në krye me këtë të keqe shum të madhe", përderisa në të njejtën kohë e grryen edhe konfidencën e tyre ngaj gjykatave.[85] Gjithsesi, ai gjithashtu, edhe më tutje ka theksuar dhe prosekutorët janë duke e kryer detyrën e tyre, edhe përkundër ankesave nga Kryetarja e Komisionit kundër korrupcionit se Ministria e Punëve të mbrendshme ka qenë më e mirë në hapjen e këtyre proceseve se sa në në arritjen e përfundimeve të

[82] ICG intervistë, 10 Mars 2003.

[83] Shih "Ministri i Ekonomisë, Ilija Filipovski: Blerja e naftës pa tender është e ligjshme", AIM, 5 shkurt 2003.

[84] Intervista të GNK-së me figura të larta opozitare, qershor dhe korrik 2003. Drejtori i kompanisë që e morri kontratën mohoi se ka pasur zbritje ose manipulim me çmimin e naftës dhe tha Se firma e tij ka humbur të holla në këtë marrëveshje. Intervistë e GNK-së 4 korrik 2003. Ilija Filipovski nuk iu përgjegj kërkesës së GNK-së, të dërguar me faks, për intervistë rreth kësaj çështjeje..

[85] Intervistë e Radio Evropa e Lirë me kryeministrin Cërvenkovski, e cituar në *Dnevnik-Shkup,* 21 korrik 2003.

kënaqshme.[86] Ai gjithashtu në mënyrë kategorike ka mohuar spekulimet për marrëveshjen për "mos sulmim" që është arritur midis tij dhe ish Kryeministrit Lubço Georgievskit që do të kishte mundur të kufizonte hulumtimet dhe prosekutimet e mundshme për disa zyrtarë të lartë të VMRO-DPMNE-së.

## B. NEVOJA PËR PAVARËSI MË TË MADHE TË GJYQEVE

Kah fundi i prillit të vitit 2003, qeveria përgaditi një material prej 30 fletësh për "Strategjinë për të luftuar korrupcionin". Në 17 qershor po të këtij viti, Komisioni kundër korrupcionit përaditit një plan aksioni më të gjithëmbarshëm me rekomandime të detajizuara në gjashtë lëmi të ndryshme: politikë; administrata publike dhe shtetërore; sistemi ligjor; sistemi kriminel dhe organet kundër korrupcionit; sistemin ekonomik dhe financiar; sektorin qytetar, mediat dhe organizata ndërkombëtare.[87] Taseva quajti reformat e gjykatave si reforma me prioritet më të madh, veçantërisht ndërtimin e pavarësisë së gjykatqve duke përfunduar me emërtimin e gjykatësve nga ana e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë dhe zëvendësimin Komisionit Republikan të gjykatave që ishte shumë i politizuar me një Këshil Republikan të Drejtësisë.

Propozimet e Komisionit për një këshill të pavarur shtetëror që do të kërkonte ndryshimin e tetëmbëdhjetë neneve të Kushtetutës. Duke pasur parasysh interesin natyror të qeverisë në ruajtjen e ifluencës (ndikimit) politike mbi gjykatat dhe mosinteresimin që të rihapë çështjen e Kushtetutës pas përfundimit të procesit të marrëveshjes së Ohrit, është pothuajse shumë e paarritshme që një Komision i tillë i vogël, që është i tejngarkuar më punë, të arrijë të lëvizë përpara këtë çështje pa angazhimin e komunitetit ndërkombëtar. Gjithsesi, asnjë nga agjensitë ndërkombëtare nuk ka marrë deri tani rolin për të udhëhequr këtë çështje. Me burimet egzistuese dhe me eksperiencën për qeverisje (udhëheqje) dhe korrupcion, Banka Botërore është shumë mirë e përgaditur për këtë punë. OSBE-ja, me personelin e tij relativisht të madh dhe shumë lartë të përgaditur për shtetin juridik, tanimë është duke ndjekur punën e gjykatave. Së bashku, këta dy organizata munden që të sigurojnë një fillim të konsiderueshëm për këtë. Gjithsesi, OSBE-ja nuk ka qenë e interesuar që të ngrejë këtë çështje, duke shikuar rolin e saj primar lidhur me çështjet rreth sigurisë.[88]

Si për ironi, NATO-ja -- një organizatë politico-ushtarake -- ka qenë më e përbetuar në mesin e organizatave (aktorëve) ndërkombëtare lidhur me këta çështje. Takimet të udhëheqsve më të lartë në selinë e tyre kryesor ne Bruksel, ka dërguar kritikat më të ashpra ndaj udhëheqsve të Republikës së Maqedonisë për dështimin e tyre që të merren me çështjen e korrupcionit. Para pak kohe, Komisioni Europjan gjithashtu ka treguar një interesim pak më të madh.

Edhe në tutje nuk egziston asnjë lloj konsenzusi midis donatorëve dhe shoqërisë qytetare të Maqedonisë, gjithsesi, lidhur me problemet shumë serioze që kanë të bëjnë me sistemin juridik. Shumica e fondeve të dhëna ka për qëllim ndërtimin e kapaciteteve të ndërtesave, pagesave mujore dhe trajnimeve, e jo në veçanti pavarësinë e gjykatave.[89] Drejtori i Institucionit Shoqata e Hapur në Maqedoni, Vlladimir Millçin, beson që theksimi i pagave të ulëta mujore është një burim i madh i korrupcionit në të njejtën kohë e nënvlerëson madhësinë e ndikimit politik në sistemin juridik. Ai thekson se gjykatësit e Gjyqit Suprem të Republikës së Maqedonisë janë ndër profesionistët më shumë të paguar por Kryetari i Gjyqit Suprem, Simeon Geleski, ka theksuar se gjykatësit në mënyrë të pandërprerë po ballafaqohen me presione, kërcënime ndaj jetës dhe veprimtarisë së tyre.

Rasti i trafikantit famëkeq të femrave, Dilaver Bojku, është shembulli kryesor për problemet e natyrës së lidhur me këtë. Ai u dënua vetëm me gjashtë muaj burgim, e më pas edhe arriti që të ikë nga burgu ku ai ishte nën mbikqyrje të

[86] Intervista e GNK-së, 21 korrik 2003.

[87] Plani kërkon që të ndërrohen ose të miratohen mbi 40 ligje; ndër ligjet më të reja janë ato që i përkasin financimit të partive politike.

[88] Intervistë e GNK-së. OSBE-ja konsideron se është me ndihmesë financimi i strategjisë për anti-korrupcion duke mbikqyrë gjykimet dhe duke trajnuar vëzhguesit vendor të gjykimeve.

[89] SHBA-të kanë rezevuar rreth $15 milion dollarë ndërsa Agjencioni Evropian për Rikonstruim rreth €7 milion Euro për reformë të sistemit gjyqësor. OSBE-ja ka një program për t'ju ndihmuar prokurorëve ta rritin numrin e rasteve të zgjidhura.

pamjaftueshme. Gjykatat kanë qenë të paaftë që në mënyrë preventine të pengojnë bashkëpunëtorët e Dilaver Bojkut që të frigësojnë dëshmitarët madje edhe vetë mbikqyrësit e OSBE-së. Në një rast tjetër të trafikimit me femra, dy të dyshueshë u çliruan nga akuzat edhepsë egzistonin dëshmi të mjaftueshme që të lidhin ata me vresjen e trefishtë gjatë një tentimi për kidnapimin e prostituteve nga një "shtëpi publike" në fshatin e Dobri Dollit.

## V. DECENTRALIZIMI DHE KUFIJTË KOMUNAL

Decentralizimi i qeverisjes ishte një nga elementet kryeosre të Marrëveshjes paqësore të Ohrit, por deri tani progresi ka qenë shumë i ngadalshëm. Kthimi i pushtetit ndaj komunave për shumë çështje të cilat ata parapraksht posedonin në vitin 1991 do të ishtë përfitim edhe për maqedonasit edhe për shqipëtarët.[90] Decentralizimi mund të bëjë që pushteti lokal të jetë më përgjegjës për veprat e tyre dhe më efektiv -- jo vetëm të transferojë më shumë të drejta për shqipëtarët, por gjithashtu për ndërtimin e shtetit qytetar në të cilin të gjithë komunitetet do të kenë pjesmarrje të njejtë në reformat.

Nga takimet e shpeshta të ICG-së më një numër të madh të kryetarëve të komunave si edhe me Shoqatën e Njësive të ushtetit Lokal (ZELS) që është një shoqatë multietnike, jo partiake, si edhe në diskutimet me ekspertët ndërkombëtarë për çështjen e decentralizimit, është shumë e qartë që kryetarët e komunave dhe të gjitha linjat politike dhe etnike me padurim presin që përsëri të fitojnë sa më shpejt autorizimet më të gjëra. Mbështetja locale është shumë e madhe veçantërisht kur decentralizimi është paraqitur si një nga elementet thelbësore të reformave qeveritare, e më së shpeshti kjo ndodh në kontekstin e marrëveshjes paqësore të Ohrit. Friga e shumë banorëve maqedonas frigësohen që decentralizimi mundet të shpie kah "federalizimi" duket sikur kah lëshuar pë në një mënyrë.[91] Në të vërtetë, karta e pastërt (card blanche) që do t'ju jepet komunave për të bashkëpunuar në sektore të caktuara, madje edhe

[90] Maqedonia ka qenë shumë më e decentralizuar para pavarsisë. Për shembull para vitit 1991, 34 komunat e atëhershme kishin përgjegjësi ta drejtojnë arsimin. Prej vitit 1991 Ministria e Arsimit drejtpësëdrejti ka drejtuar me shkollat e tërë vendit, madje edhe i ka emëruar drejtorët. Kah fund i viteve 90, nën trysninë e Këshillit Evropian, rrjedha u ndërrua përsëri dhe një ligj i ri për decentralizim gadit ishte përgaditur kur plasi konflikti në vitin 2001.

[91] Një sondazh, i Gallup Internacional, i paraqitur prej Brima agjencion vendor, e krahasoi qasjen ndaj decentralizimit në vitin 2001 dhe vitin 2002. Një numër i konsiderueshëm i maqedonasve kanë shfaqur frikë nga decentralizimi-"si një hap drejt federalizimit (nga ana e shqiptarëve)". Sidoqoftë, kjo u zvogëlua prej 64 në 48 përqind një vit më vonë. "Analizat e studimit të rezultateve të anketimit të opinionit publik", Brima, Projekt për Reformë të Qeverisjes locale.

përtej kufijve ndërkombëtar, duket sikur nuk brengos as shqipëtarët e as maqedonasit.

ZELS dhe OSBE-ja besojnë që decentralizimi i autoritetit njësive vendore do të mundet të lehtësojë (relaksojë) marrëdheniet etnike. Për shembull, fakti komunat e shqipëtarëve që deri tani kanë qenë të kontrolluara që tani munden të japin lejet për ndërtime, tanimë domethënë që qytetarët nuk do të munden te fajësojnë qeverinë për shërbimet e varfëra të cilat bëhen nga birokracia e centralizuar e dominuar kryesisht nga maqedonasit. Çështje e nxehta për mospajtimet e ndryshme, si ata të llojit të problemeve lidhur me shkollimin në Shemshovë, Kumanovë, Manastir dhe Shkup munden që të lehtësohen nëse komunat kontrollojnë edukimin, ashtu siç është e parashikuar me marrëveshjen paqësore të Ohrit.

Çështjet tjera që shkaktojnë kundërthënie, siç janë perceptimet se shqipëtarët nuk paguajnë në mënyrë korrekte pjesën e tyre të tatimeve, gjithashtu mund të ndryshohen atëherë kur komuna do të ketë mundësi të luajë rol më të rëndësishëm në jetën e qytetarëve. Momentalisht, komunat furnizojnë vetëm disa shërbime siç janë refuzimi për grumbullimin e tyre, pastrimin e rrugëve dhe të mirëmbajtjes së rrugëve. Siç u theksua edhe më lartë, disa nga kryarët e komunave të dominuara nga shqipëtarët parashikojnë masa vërte të vështira për stereotipet e tatimeve, por ata të gjithë janë të bindur që qytetarët shqipëtarë do të fillojnë të paguajnë pjesën e tyre të tatimeve me përmirësim e shërbimeve dhe kontrollit lokal.

## A. QASJE E CENTRALIZUAR NDAJ DECENTRALIZIMIT

Njerëzit të cilët përgaditën marrëveshjen kornizë të Ohrit, qartë kuptojnë rëndësinë kruciale të decentralizimit. Përveç gjashtëmbëdhjetë amandamenteve kushtetutare, Ligji për Pushtetin vendor ishte kërkesa e vetme paraprake për mbajtjen e konferencës së donatorëve. Procesi i decentralizimit kërkon dy ligje shtesë me këtë: atë për finansimin e pushtetit local si edhe për kufijtë komunal, dhe ky i dyti të bëjë ndarje të sakta të numrit të komunave, me vizatime (përshkrime) të reja drastike të kufijve komunal.[92] Një ligj i mëtutjeshëm, për qytetin e Shkupit, do të kishte reorganizuar tërë kryeqitetin, që tanimë përmban pothuajse një të tretën e numrit të përgjithshëm të banorëve në Republikën e Maqedonisë.[93]

Ligji për pushtetin vendor, që u adoptua në janar të vitit 2002, pas një përleshje se kush do të ketë qasje më të mirë ndaj Fondit shëndetësor shumë profitabil, zgjeroi mundësitë komunale në teori por gjithashtu jep shumë pak derjtime për implementimin e tij. Një sëri e funksioneve të kryera nga ana e qeverisë qëndrore janë të parashikuara (nënvizuara) për trnasferim local -- por pa ndonjë mekanizëm ose rend dite (dinamikë). Deri në moimentin kur është shkruar ky raport, asnjë nga këta funksione nuk është transferuar edhe më tutje. Në sektorin kryesor të shëndetsisë, disa përgjegjsi të caktuara dhe fonde në fakt janë kthyer përsëri në përgjegjsi të Fondit shëndetsor të centralizuar> Propozim ligjet për finansat dhe për kufijtë komunal tanimë për një kohë të gjatë kanë kaluar afatet e fundit të plotësimit të parashikuar më marrëveshjen paqësore të Ohrit.[94]

Personat zyrtarë e arsyetojnë rrjedhinë e ngadalshme të decentralizimit, duke thënë se është një process shumë i ndërlikuar dhe që kërkon një kohë shumë më të gjatë për tu implementuar. Predikimet e tyre kanë qenë më shumë për të kënaqur egon e tyre, duke e lënë këtë çështje larg ndonjë emergjencës dhe duke injoruar faktin pse decentralizimi është i nevojshëm, që në fakt është që t'ju japë të gjithë qytetarëve pronësi më të madhe të qeverisë së tyre dhe të vendimeve të cilat

[92] Shih më poshtë.

[93] Çështja kyçe është vallë Shkupi dhe komunat që e përbëjnë Shkupin do të kenë status të barabatë, ose qyteti do të ketë disa kompetenca më të gjëra, si në shumicën e qendrave urbane të Evropës. Ministri për Qeverisje Vendore parasheh se propozim ligji do të prezentohet në pjesën e parë të vitit 2004, por që asgjë nuk do të ndërrohet në terren deri në vitin 2005. Mozaiku i gjeografisë etnike të Shkupit, përfshirë edhe komunën e vetme me shumicë rome në Evropë e bën këtë çështje veçanërisht të ndieshme.

[94] Aneksi B Marrëveshjes së Ohrit përcakton se Ligji për Finacimin e qeverisjes vendore duhet miratuar kah fundi i mandatit parlamentar, kah mesi i vitit 2002, dhe Ligji për Ndarjen territoriale të Komunave kah fund i vitit 2002 duke i marrë parasysh rezultatet e regjistrimit (që gjithashtu janë vonuar). Në takimin të nënshkruesve të Ohrit, më 26 dhjetor, të gjitha afatet e decentralizmit ishin tejkaluar: qëllimi për harmonizim të ligjeve (i nevojshëm për transfer të kompetencave) u shty deri në fund të vitit 2003, si dhe u bë shtyrje e plotë e transferit të kompetencave deri pas zgjedhjeve vendore kah fundi i 2004.

kanë ndikim të madh në jetën e tyre të përditshme. Pasijat e një qasje të tillë dilettante nuk paraqiten sikur janë të njohura për udhëheqësit qeveritar ose për liderët e partive. Vetëm komuniteti (kori) diplomatik tregon brengat e vetë, por edhe ata, gjithashtu, duket sikur edhe me padashje e kanë pranuar këtë rrjedhi të ngadalshme (glaciale).

Edhe Fondi Ndërkombëtar Monetar nuk ka luajtur ndonjë rol produktiv lidhur me këtë çështje, dhe përshkrimet (sqariemt) e tyre për rritjen e të ardhura vendore ka qenë në të shumtën e rasteve si të posalindura.[95] Një pilot project shumë modest për transferimin e grumbullimit të tatimeve për gati se të haruarin tatim të pronësisë në vetëm katër komuna gjithashtu është shtyer (vonuar).[96] Në përgjithsi, drejtori egzekutiv i shoqatës së njësive të pushtetit vendor ZELS ankohet, "asgjë nuik është bërë".[97] Problemi nuk qëndron vetëm tek rezistenca e maqedonasve; Ali Ahmeti ndaj kësaj ka një qëndrim shumë nonshallant.[98] Njëlloj si edhe kundër pala e tyre maqedonase, udhëheqësi i BDI-së duket sikur është jashta hapit bër bashkëpunim me kryetarët e komunave,[99] të cilët kritikojnë mungesën e progresit dhe centralizimin shumë të madh të caktimit të takimeve.[100] Nën presionin e faktit për rrjedhi të ngadalshme të këtij procesi, Ministri i Pushtetit Lokal, Aleksandar Geshtakovski, parashikonte që procesi për decentralizim do të zgjasë "dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vitë për të përfunduar".[101] Ata ky qeveria është marrë me çështjen e decentralizimit, ajo është munduar që të ruajë një kontrollë të rëndësishme. Propozimi Ligji për finansimin vendor nga ministria e finansave në mënyrë të vështirë thekson blloqet e kredive nga qeveria si fonde primare për fondet e komunave -- një qasje që është e qartë që do të mbajë procesin edhe të politizuar edhe të centralizuar.[102]

Përderisa është e qartë që të sjellen legjislacionet për lëshimin e të drejtave të decentralizuara, kjo nuk domethënë që ata duhet të sakrifikohen menjëherë, por me hapa praktike të afrojnë qeverinë më afër popullatës. Gjithsesi, zyrtari kryesor për decentralizimin, Geshtakovski, bën shumë të qartë që në të vërtetë të gjitha çështjet e finansimit dhe të kufijve komunal do të nevojiten të zgjedhen para se të kryhet ndonjë transferim thelbësor i përgjegjsive.[103] Me fjalë të tjera, një komponentë kritike e marrëveshjes paqësore të Ohrit qëndron edhe më tutje si rob ndaj tentimeve për të dezenuar planet optimale për ndarjen e të ardhurave dhe arritjen e marrëveshjes përfundimtare për kufijtë komunal -- pa marrë parasysh se sa do të zgjasë ky proces. [104]

Qeveria mundet të transformojë (dorrëzojë) pushtetin që kërkon vetëm pak para për transferim duke zgjedhur komunat duke vazhduar edhe më tutje të punojë në ndërlikueshmërinë e tërë procesit të decentralizimit. Në intervistat me kryetarët e komunave, u shpreh dëshirë e fortë për të bashkëpunuar lidhur me projektet siç janë vaditja e bimëve të ndryshme. Bashkëpunimi i komunavë është lirisht i lejuar me Ligjin për Pushtetin Lokal, dhe me ndihmë aktive të komunitetit ndërkombëtar kjo do të kishtë mundur që të redukton tensioned dhe të stimulojë aktivitetin e metutjeshëm vendor.[105] Me fjalë të shkurta, qasja e qeverisë ndaj decentralizimit edhe më tutje mbetet shumë e centralizuar.

Lëmia e cila në mënyrë më emergjente ka nevojë për procesin e decentralizimit është edukimi

[95] FMN duket sikur frikohet nga ndikimi i decentralizimit mbi kontrollin qëndror të buxhetit; mendimi se shumë komuna do ta rritin borxhin është skenari më i keq për Fondin dhe e nxit kujdesin e tij.

[96] Bisedë telefonike e GNK-së me prefektin e Velesit, Ace Kocevski, 14 korrik 2003.

[97] Intervistë e GNK-së, 14 korrik 2003.

[98] Intervistë me Ali Ahmetin, korrik 2003.

[99] Shumica e prefektëve të zgjedhur në vitin 2000 janë të partisë rivale shqiptare PDSH.

[100] Intervista të GNK-së me prefektët shqiptarë dhe maqedonas të zhvilluara prej janari deri në mars 2003.

[101] Intervistat e GNK-së me Geshtakovskin, 23 korrik 2003 dhe 9 janar 2003.

[102] Shih Gazetën Zyrtare, 23 dhjetor 2002 finacimi shtesë është shpërndarë për 42 komuna në një mënyrë tepër të politizuar.

[103] Intervista të GNK-së, 23 korrik 2003 dhe 9 janar 2003.

[104] Përfaqësuesi i posaçëm i UE-së Bruns dhe Ambasadori i SHBA-ve Batler i kanë shkruajtur Kryeministrit Cërvenkovski, në nëntor 2002, për ta nxitur që qeveria e tij e posakrijuar jo vetëm t'i miratojë ligjet e nevojshme për transfer të kompetencave te qeveria vendore, por gjithashtu "paralelisht" të bëjë transferin e forcave që kyçin pak ose aspak kompetenca fiskale ashtuqë i tërë procesi të mos kushtëzohet me çështjet më të vështira. Informata ishte në disponim të GNK-së.

[105] Neni 14 i Ligjit për Vetëqeverisje Vendore është titulluar "Bashkëpunimi ndërkomunal" në paragrafin e parë (1) parashihet se "gjatë përmbushjes së kompetencave të tyre komunat mund të bashkëpunojnë mes vedi".

(arsimimi). Zyrtarët të cilët ishin të përfshirë në procesin e ndërmjetësimit në çështjet diskutabile të shkollave në Shemshevë dhe Kumanovë besojnë që detyra e tyre do të kishtë qenë shumë më e lehtë sikur arsimimi të kishte qenë i decentralizuar.[106] Dykuptimshëritë të ligjeve kanë hapur një diskutim të ashpër lidhur me faktin që a thua kryetarët e komunave ose këshillat vendore të shkollave duhet të kenë autoritetin përfundimtar për emërimin e drejtorëve të shkollave.[107] Duke falemnderuar ndihmës prej misioneve të mbështetura financiarisht nga USAID-i, u arrit një kompromis që ju lejon kryetarëve të komunave të caktojnë personin nga një listë e kandidatëve të cilën do t'ju dorrëzojë këshilli shkollor.[108] Gjithsesi, ky ndryshim Jetik nuk do të hyjë në fuqi deri në vitin 2005.

Disa nga ndryshimet shumë të rëndësishme në sferën e arsimimit kërkojnë shumë pak finansim ose përshtatje të tjera të dhimbshme. Prej këtu, edhe kundërthëniet lidhur me emrin e shkollës në Shemshevë do të kishin qenë plotësisht detyrë e vendit që të vendosë për këtë pa asnjë lloj harxhimi. E njejta gjë do të ishte edhe me rastin e Vrapçishtit lidhur me drejtorin e shkollës. Problemi lidhur me numrin e madh të nxënësve në Kumanovë përfshin në vetë kapacitetet shkollore, që domethënë edhe finansimin e tyre, por gjë kjo që do të ishtë kryer me përgjegjsinë e vet komunës, dhe që mund të identifikohet me emergjencën e më përparshme dhe të udhëheqte më mirë përgjigjet se sa në mënyrën që ndodhi nga ministria qëndrore dhe me ndërmjetsuesit ndërkombëtar.

Lejet për ndërtime ilustrojnë në të vërtetët sistemin aktual të rrugës më të shkurtër. Një qytetar duhet që të shkojë në njërën nga 34 zyrat rajonale të qeverisë qëndrore. Kjo gjë len kryetarët e komunave joefektiv në ofrimin e ndihmave që kërkohen nga qytetarët -- veçantërisht nga shqipëtarët -- nëse kërkesat e tyre plotësohen shumë ngadalë ose janë të refuzuara. Geshtakovski bëri me dije për këtë problem duke thënë se edhe vetë komunat kanë mungesë të kapaciteteve për planifikimet urbane. Disa nga kryetarët e komunave me të cilët diskutuam, në mënyrë të prerë nuk e pranuan këtë gjë; disa prej tyre than që edhe nga "dita e nesërme" ata do të kishin mundur të pranojnë këtë përgjegjsi. Komunat e vogla që nuk kanë arkitekt apo inzhenjer do të ishin dakorduara që Tek ta të punonin edhe ekspertët prej komunave më të mëdha, tha kryetari i komunës Saraj, Imer Selmani.[109] Komunat e vogla në përgjithsi kanë mungesë të kapaciteteve (mundësive) që në mënyrë korrekte të udhëheqin me shënimet lidhur me pronësinë të cilat ruhen në zyrat rajonale. Gjithsesi, secil kryetar komune me të cilët u takua ICG-ja -- shqipëtar apo maqedonas, nga komunat e mëdha apo të vogla -- betohej me vulnetin dhe dëshirën e tij që të lejojnë komunat më të mëdha të mbajnë këta shënime. Në bazë të informative dhënë nga ZELS-i, ministri për transport dhe komunikim -- jo një "maqedonas që na pengon" por një ministër i emëruar nga BDI-ja, Milaim Ajdini, deri më tani nuk ka bërë asgjë për përmirësimin e procesit të dhënies së lejeve për ndërtim. Në verzionin më të fundit të propozim ligjit, edhe më tutje aprovimin përfundimtar do të mbante qeveria.[110]

ZELS gjithashtu mundohet të paraqesë si çështje të fortë edhe transferimin e të drejtës për grumbullimin e tatimeve, që tanimë madje është e regjistruar sit ë ardhurë vendore dhe për këtë arsye nuk janë të sulmuara ashpër nga Zyrat Publike për të Ardhurat, gjë që mund të lehtësojë finansimin dhe zvogëlojë harxhimet lidhur me planifimikimet në komunat e tyre.[111] Pas prolongimit (zgjatjes së kohës) të diskutimeve, ministria e financave u dakordua në korrik të vitit 2003 që të transferojë grumbullimin e të ardhurave në katër pilot komuna[112] Gjithsesi, kryetari

[106] Intervista të GNK-së me eksperta të kyçur në të dy rastet, 4 mars dhe 25 prill 2003.

[107] Intervistë e GNK-së me ekspert ndërkombëtar, 24 prill 2003.

[108] Intervistë telefonike me Uiliam Althaus, ushëheqës i DAI-LGRP (Alternativat zhvillimore Inc: Projekti për Reforma të Qeverisjes Vendore), 14 korrik 2003.

[109] Intervistë e GNK-së, 24 janar 2003. Selmani është gjithashtu nënkryetar i Bashkësisë së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (BNjVV).

[110] Intervistë e GNK-së me kryetarin e BNjVV-së Goran Angelov dhe Drejtorin Ekzekutiv Dushica Perishiq, 14 korrik 2003. Ata thonë se ShNjVV deri më tani ka pasur vetëm një takim me Ajdinin.

[111] Parashikimi është se komunat vednore do të mund ta rrisnin mbledhjen e këtyre të ardhurave trefish. Në të vërtetë, tre taksa për pronën janë përcaktuar për komunat: tatimi periodik në prona të tundshme dhe të patundshme, tatimi për shitjen e pronës dhe tatimi për trashigimi të pronave të patundshme. I pari është më i rendësishmi.

[112] Interivstë e GNK-së me Sekretarin shtetëror në Ministrinë e Financave , 15 maj 2003. Intervistë me kryetarin e BNjVV Intervistë e GNK-së me kryetarin e BNjVV-së Goran Angelov dhe Drejtorin Ekzekutiv Dushica Perishiq, 14 korrik 2003.

i komunës së Velesit, Ace Kocevski, një nga anëtarët kryesor të ZELS-it, nuk prêt që pilot projektet të fillojnë me punënë e tyre me pilot projected deri nga fundi i vitit 2003 ose fillim të vitit 2004.[113] Me 23 mars të vitit 2003, ZELS-i nënshkruajti marrëveshje me qeverinë për aplikimin e kriteriumit jopartiak për shpërndarjen e të ardhurave shtesë shtetërore -- 70 përqind për komunat e varfëra dhe 30 përqing prej komunave të pasura.[114]

Fondi Ndërkombëtar Monetar, që ka shkuar edhe më larg mandatit të tij për zgjedhjet fiskale, gjithashtu mban mbi vete disa përgjegjsi për vonimin e procesit të decentralizimit duke insistuar jo vetëm që komunat të jenë të shkarkuara nga konsolidimi i borxheve por edhe nga ajo që Maqedonia të konsolidojë komunat në njësi më të qarta ekonomike. Partitë në përgjithsi kanë pranuar edhe kushtet e mëtutjeshme për faktin që Ligji për kufijtë komunal të ketë prioritet mbi Ligji e finansimit të pushtetit vendor.[115]

Projekti DAI -- Projekti për reformat e pushtetit vendor (LGRP ), që finansohet nga USAID-I, ka demonstruar që është e mundshme për të huajt të jenë katalizatorë përderisa akterët vendor edhe më tutje të pranojnë "pronësinë" mbi procesin. LGRP ka dhënë ZELS-it ndihmën teknike dhe trimërinë (kurajon). Bashkëpunimi i deritanishëm ka sjellur një numër të madh të projekteve të propozuara nga ZELS-i, dhe LGRP ka inkurajuar shumë kryetarë të komunave që në komunat e tyre të mbajnë takome (mbledhje) për të diskutuar problemet me qytetarët. Këta tentime duhet edhe më tutje të zgjerohen. Në mënyrë të ngjajshme, edhe Grupi për Këshillimin e Qytetarëve, që sponsorohet nga OSBE-ja, ka organizuar takime midis qytetarëve dhe policisë për të diskutuar brengat dhe për të zgjedhur problemet. OSBE-ja gjithashtu thekson që zyrtarët vendor se shpesh herë shikojnë këta grupe si kërcënime ndaj tyre dhe nuk marrin pjesë të plotë në ta. Në të vërtetë, "një numër i madh i çështjeve drejtohen nga policia, çështje këta të cilat nuk janë në mënyrë të drejtëpërdrejtë nuk janë të lidhura me punën e tyre", por janë më shumë lidhur me pushtetin vendor.[116]

Ekspertët e LGRP-së dakordohen që edhe më shumë është e mundur të bëhet dhe që edhe ata e mbështesin Grupin për Këshillimin e Qytetarëve në pesë komuna, që ka për obligim të inkurajojë interaksioni e qytetarëve me kryetarët e komunave dhe më këshillat komunale. Ekspertët ndërkombëtarë gjithashtu munden që të sillen në mënyrë të frytshme si ndërmjetsues mes tyre dhe qeverisë qëndrore që të sigurojë që ata të përgjigjen në brengat e parashtruara të qytetarëve. Idealisht, interaksioni qytetar -- komunë -- qeveri qëndrore do të kishte mundur të kthejë decentralizimin në një process nga poshtë e deri më lartë.

Përshpejtimi i procesit të dcentralizimit madje edhe në mënyrë modeste kërkon udhëheqsi të përbashkët, veçantërisht nga dy figurat kryesore: Ambasadori i Komunitetit Europjan Aleksis Brouns dhe nga Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Lorens Batler. Ekspertët thonë që amerikanët janë më shumë të përbetuar ndaj këtij koncepti dhe kanë qenë pala kryesore për avancimin (përparimin) e këtij procesi. Gjithsesi, ata gjithashtu raportojnë për koordinimin e varfër midis akterëve të shumëfishtë. Në një konferencë të Kombeve të Bashkuara një zyrtar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara ankoehj për prezencën e 23 akterëve të ndryshëm që punojnë në decentralizimin, me një koordinim shumë të vogël. Udhëheqësia e Komunitetit Europjan ka qenë qartë e papranishme në këtë lëmi.

## B. LIGJI PËR KUFIJTË KOMUNAL

Ndihma ndërkombëare mundet gjithashtu të jetë e nevojshme për të udhëhequr me çështjet e mundshme gjatë ndarjes lidhur me Ligjin për Kufijtë Komunal. Një grup i kombinuar prej zyrtarëve dhe ekspertëve është duke biseduar për hartat që duhet të

[113] Intervistë telefonike me prefektin e Velesit Ace Kocevski, 14 korrik 2003.

[114] "Të holla për të gjitha komunat dhe qytetin e Shkupit", *Utrinski Vesnik,* 26 maRs 2003.

[115] "Përfundime" nga një takim të partive nënshkruese të marrëveshjes së Ohrit në prani të zyrtarëve të UE-së dhe SHBA-ve dhe kryetarit Trajkovski, 26 dhjetor 2002. Shih veçanërisht paragrafat 3 dhe 6. DAI-LGRP i financuar nda USAID ka ndihmuar në zhvillimin e ligjit për financim të qeverisjes vendor. Që në fillim të 2002, DAI-LGRP ofroi një propozim dhe tani është aktiv në diskutimet rreth asaj si duhet vazhduar. Këshilli i Evropës ka ndihmuar rreth ligjit për ndarjen territoriale të komunave

[116] Njësia e OSBE-së për Zhvillimin e Policisë, "Grupet këshillimore të qytetarëve", raporti shtator 2002 deri janar 2003. f 5-6.

reduktojnë numrin e komunave prej 123 në një numër midis 60 dhe 67 komunave.[117] Një raport që vjen prej Bankës Botërore, gjithsesi, vë në sfidë mençurinë tradicionale për atë që në konsolidim i tillë është i nevojshëm, duke theksuar që nuk ka ndonjë korelacion të drejtëpërdrejtë midis popullatës dhe efikasitetit të pushtetit vendor.[118] Në vend të kësaj, sa më shumë zvogëlohet numri i komunave, ata atëherë edhe më shumë bashkëpunojnë në mënyrë më intensive -- për shembull me ndarjen e shkollave të përbashkëta. Të vetëdijshëm për mundësitë e kutisë së Pandorës të lidhura me manipulimet zgjedhore, Banka kërkonte urgjentisht të diskutohet rreth kufijvë për tq kufizuar në mënyrë të rreptë çështjet teknike të madhësisë -- raste ku komunat janë thjeshtë shumë të vogla për të mundësuar edhe shërbimet më modeste.

Gjithsesi, është pothuajse e sigurtë që numri i komunave do të jetë së paku i përgjysmuar. Mundësia për kundërthëniet polarizuese që mund të provokojnë edhe më shumë diskutime për ndarjet etnike dhe për ndarje është shumë e qartë. Shpalljet paraprake të qeverisë provokuan një reagim të fortë nga opozita.[119] Edhe vetë kryetarët e komunave që i përkasin koalicionit që udheheq me qeverinë kanë përmbysur procesin. Disa zyrtarë maqedonas janë të brengosur se komunat e tyre urbane do të gjejnë veten në gjendje të varfërisë së madhe, për shkak të vendeve rurale shqipëtarë që nuk paguajnë (ose paguajnë shumë pak) tatimet e tyre. Kryetarët e komunave të vogla, shqipëtarë dhe maqedonas, janë gjithashtu me krahë të mbledhur lidhur me prospektin e konsolidimit. Ekspertët dhe zyrtarët e opozitës në mënyrë të njejtë brengosen që vendimi për kufijtë do të bëhet me "marrëveshje në një dhomë të zezë" midis partive të koalicionit qeveritar dhe do të jetë i paraqitur si diçka tanimë plotësisht e kryer.[120]

Ministri Geshtakovski ul brengat dhe duket sikur është në një mënyrë të veçantë i përbetuar që të evitojë eksplodimet ndër etnike, ai është i bindur që ekipi i tij me këshilltarë shumë etnik që përbëhet prej kryetarëve të komunave dhe akademikëve do të gjejë një gjuhë dhe interese të përbashkëta. Me ndihmën e Këshillit të Europës, ministria deri tani ka zhvilluar pesë kriteriume kryesore për komunat: madhësia (jo më e vogël se 5.000 banorë dhe me qendër jo më të vogël se 2.000 banorë), burimet ekonomike; pronësi gjegjëse komunale; infrastrukturë; dhe kushtet natyrore dhe gjeografike.[121] Geshtakovski gjithashtu ka theksuar që kriteriumi numër 6 edhe më tutje nuk është në dokumentet: veçantitë e ndryshme historike dhe kulturore -- si një mënyrë për të ruajtur disa komuna të ndahen etnikisht.[122]

Siç ishte e parashikuar, këta kriteriume nuk qenë preventivë për përleshjet midis BDI-së dhe SDSM-së në disa lëmi. Një zyrtar i lartë i BDI-së ka përshkruar përleshjet thelbësore të interesave:

> Ne dëshirojmë të maksimalizojmë numrin e komunave ku shqipëtarët do të përbëjnë më shumë se 20 përqind të popullatës (me këtë pra do të bënim gjuhën shqipe gjuhë zyrtare) dhe gjithashtu dëshirojmë që të sjellim në lidhje shqipëtarët me qendrat urbane; maqedonasit dëshirojnë të kundërtën -- të ruajnë kontrollin urban maqedonas, duke lënë shqipëtarët në rajonet rurale dhe minimizimin e numrit të komunave ku ka 20 përqind shqipëtarë.[123]

Ai gjithashtu tha që maqedonasit aplikojnë kriteriumet ashtu siç ju përgjigjen interesave të tyre etnike -- për shembull, konsolidimi i maqedonasve në perëndim duke ju bashkuar komunave të Vratnicës dhe të Jegunovcës, përderisa nuk ju jApin të njejtën mundësi shqipëtarëve në Komunën Dollneni ose kudi thetër.[124] Një raport tjetër thotë që BDI-ja dëshiron të bashkojë Shkupin dhe Haraçinën që të formojë një

[117] Sipas Ministrit për Vetëqeverisje vendore –Geshtakovski, intervistë e GNK-së 23 korrik 2003.
[118] "IRJ Maqedonia: Raporti për Statusin e Decentralizimit", Banka Botërore, op. cit.
[119] VMRO-DPMNE ka deklaruar se ndarja territoriale duhet të pret derisa të shpallen rezultatet e regjistrimit të populates, pikëvështrim i refuzuar nga Geshtakovski. Partia gjithashtu ka propozuar numrin e komunave në 30 komuna "urbane" dhe 50 "rurale. Diskutim i GNK-së me zyrtarë të lartë të VMRO-DPMNE.
[120] Intervistë me zyrtarin e VMRO-DPMNE-së Ljupço Ballkovski, 17 korrik 2003.
[121] Shih "Organizimi territorial e vetqeverisjes në Republikën e Maqedonisë" dokument që GNK-së ia ka dorëzuar ministria për vetqeverisje vendore më 23 korrik 2003.
[122] Intervistë e GNK-së, 23 korrik 2003. Shih gjithashtu "Geshtakovski: Ndarja territoriale nuk do të shkaktonte ndasi etnike dhe politike" cituar në *Dnevnik-Shkup,* 9 korrik 2003.
[123] Intervistë e GNK-së, 21 korrik 2003.
[124] Zyrtari i BDI-së shtoi se maqedonasit frikohen se shqiptarët do të arrijnë 50 përqind në nivel të komunave. Geshtakovski insistonte te GNK-ja, më 23 korrik 2003, se këto nuk janë çështje.

komunë të madhe shqipëtare në Shkup dhe gjithashtu të kontrollojë komunën Kale.

Ministri Geshtakovski rrëzon poshtë këtë kundërthënie, duke insistuar që çështjet janë lehtë për tu rregulluar. Shkupi, thotë ai, nuk do të jetë problem deri atëherë kur qyteti do të ruajë kontrollin financiar. Gjithsesi, ai mendon se egziston një shpërndarje rurale midis Strugës dhe Kërçovës që është e diskutueshme për etnicitetin e kryetarit të komunës. Me fjalë të tjera, edhe me karakterizimin më dëshirë më të madhe, propozim ligji hap çështje egzistenciale lidhur me natyrën e shtetit, përfshirë këtu edhe atë që a do të jetë Maqedonia një "shtet qytetar" apo thjeshtë një lojë me shumë të barabartë me zero lidhur me çështjet mbi kontrollin vendor dhe qasjen e burimeve nga dy grupet më të mëdhe etnike. Maqedonasit me të madhe janë duke u brengosur që konsolidimi i komunave të mëdha shqipëtare do ti lejojë minoritetin e tyre të jetë i ndjeshëm, akuzë kjo të cilën zyrtarët e BDI-së e mohojnë.

# VI. MARRËDHËNIET NDËR ETNIKE

Matja e stabilitetit është shumë më e ndërlkuar se sa numërimir i thjeshtë i incidenteve apo vlerësimi i implementimit të marrëveshjes së Ohrit. Egziston gjithashtu edhe një faktor tjetër më pak i dukshëm në marrëdhëniet midis dy komuniteteve të cilët përbëjnë pothuajse nëndë të dhjetat e popullatës. Mendimet ndryshojnë në një spektër shumë të gjërë. Në njërin fund (ekstremitet), Crvenkovski dhe Ahmeti janë modele të etiketës (dekorit), të një bashkëpunimi të ngurruar dhe të përgjithshëm; dhe në anën (ekstremitetin) tjetër, ish Kryeministri Lubço Georgievski dhe Kryetari i PDSH-së Arben Xhaferi edhe më tutje thonë se Ohri dhe marrëdhëniet multi etnike janë të nemura. Lubço Georgievski madje edhe propozoi që maqedonasit të ndërtojnë një murr si ai që është tani midis izraelitëve dhe palestinëzëve.[125] Shkrimtari shqipëtar dhe ekspert i dialogut Kim Mehmeti beson së komunikimi mes tyre është shkatërruar pothuajse në tërësi midis dy komuniteteve udhëheqëse që nga konflikti, përderisa maqedonasi musliman dhe gjithashtu ekspert i dialogut Ferid Muhic beson se marrëdhëniet ndër etnike në mënyrë të konsiderueshme janë relaksuar.[126] Disa gazetarë maqedonas edhe më tutje vazhdojnë të denoncojnë pandërprerje shqipëtarët; gazeta bartëse ditore shqipëtare, Fakti, pandërprerë vazhdon të botojë artikuj të cilat nxisin maqedonasit.

## A. PAS KONFLIKTIT

Nuk është për t'u çuditur që ekspertët nuk mund të pajtohen; sipas sondazheve të fundit, vetë qytetarët kanë pikëvështrime shumë të ndryshueshme madje edhe kundërthënese mes vedi. Sondazhet vetvetiu nuk pajtohen, ashtuqë hulumtimi i IRI-t në përgjithësi është më optimist se ANALIZA E HERSHME PARALAJMËRUESE. Sa i përket qëndrimit ndaj shqiptarëve, Maqedonasit në përgjithësi shfaqin shumë më tepër tolerancë dhe besim se sa Georgievski; vetëm 12 përqind e ndajnë besimin e tij se gjendja ideale është një shtet pa shqiptarë. Dhe përkundër Xhaferit, shumica e shqiptarëve, sa u përket prioriteteve të vendit, kanë pikëpamje të ngjashme me maqedonasit duke sugjerurar se jeta e përbashkët politike nuk është një mundësi aq a

[125] Georgievski ka deklaruar ky do të ishte drejtimi i maqedonasve poqese shqiptarët e refuzojnë ndarjen (*Dnevnik,* 18 prill 2003 ) Artikulli i tij koincidoi me një artikull të ngjashëm të Xhaferit në *Fakti*.
[126] Në bazë të bisedave me Mehmetin dhe Muhiqin.

largët.[127] Vëmendje të veçantë tërheq, sipas ekspertëve, është gatishmëria e të dy grupeve për të punuar në vende të njejta, arena më e rëndësishme për formimin e qasjeve shoqërore.[128]

Sidoqoftë, është po aq e qartë se pikëpamjet për Ohrin ngelin thekshëm të ndara. Më shumë se gjysma e maqedonasve nuk e mbështesin marrëveshjen, derisa shqiptarët e mbështesin jashtëzakonisht shumë. Më se tre të katërtat e maqedonasve konfirmuan se me siguri do të merrnin pjesë ose do të mbështetnin demonstratë kundër implementimit të saj.[129] Një numër i madhe qytetarësh të të dy grupeve citojnë disa dispozita që, poqese implementohen plotësisht (për maqedonasit) ose pamjaftueshëm (për shqiptarët), do të mund të arsyetonin konfrontim të armatosur.[130] Gjithashtu është shqetësues numri, që në mënyrë konzistente është i madh, i shqiptarëve (më shumë se një e treta) të cilët ose duan pavarësi të plotë ose autonomi në Maqedoni (përafërsisht njësoj me numrin e atyre të cilët besojnë se maqedonasit dhe shqiptarët duhet të jetojnë sëbashku).[131] Kjo sqaron përse Xhaferi dhe zëvendësi tij Menduh Thaçi pa turp kanë përkrahur "Shqipërinë etnike". Një sondazh i IRI-t në qershor të vitit 2003 tregonte se derisa PDSh-ja kishte shifra të vogla, shifrat e Xhaferit zmadhoheshin meqë ata të Ahmetit zvogëloheshin.[132]

Madje edhe hulumtimi më optimist tregon se dy herë më tepër njerëz ende besojnë se, vendi shkon në drejtim të gabuar, kundrejt atyre që besojnë se po vendi shkon në drejtim të vërtetë.[133] Një numër alarmues i dy të tretave të shqiptarëve dhe maqedonasve kanë deklaruar se presin shkallë të lartë dhune rreth çështjeve etnike dhe Ohrit.[134] Shkurt, qytetarët e rëndomtë as përsëafërmi nuk janë optimist për ardhmërinë siç janë liderët e tyre dhe komuniteti ndërkombëtar. Sikur prifti në filmin e Milço Mançevskit Para Shiut, i nominuar për Oskar, shumica e njerëzve kur e shiqojnë qiellin mbi Maqedoni, ende shohfin si mblidhen re ogurzeza të shtërngatës.

## B. SUKSESI ZHGËNJYES I KTHIMIT TË REFUGJATËVE

Sikurse sondazhet, zyrtarët për ndihma krijuan një fotografi të përzier. Maqedonia pati një nga kthimet më të shpejta multietnike të refugjatëve, që janë pa në Ballkan.[135] Megjithatë, zyrtarët e UNHCR-së e tërheqin vërejtjen se shkallën e lartë e kthimit e turbullon polarizimi i vazhdueshëm i komuniteteve. Derisa aktet serioze të dhunës janë të rralla, sipas UNHCR-së, maqedonasit ballafaqohen me "presion të lehtë por të përhershëm për t'i lëshuar" rajonet ku ata janë pakicë.[136] Zyrtarët kanë përgaditur një grafik, duke tërhequr (SAGGING) "lakesën e khimit" që e pasqyron dështimin e të kthyerve të reintegrohen edhe në aspektin social edhe në atë ekonomik. UNHCR-ja dhe OSBE-ja kanë cituar akte të vandalizmit, shqetësimit dhe abuzimit të drejtëpërdrejtë në disa

---

[127] Xhaferi do të bënte mirë ta merr parasysh analizën e bazuar në rezultatet e UNDP-së "Kështu, ngjashmëritë e (dy) komuniteteve për brengat dhe perceptimet sa i përket jetës publike. . . janë aq shumë . . . sugjeron se dallimet janë më të mëdha midis grupeve të ndryshme sociale dhe religjioze brënda secilit komunitet sesa ndërmjet dy komuniteteve". Hulumtimi i UNDP-së op.cit. faqe 48.

[128] Ibid., f. 51.

[129] Ibid., f. 47.

[130] Ibid., f. 46.

[131] Në hulumtimin e UNDP-së, 35.1 përqind të shqiptarëve kanë thënë se ose pavarsia e plotë ose autonomia është zgjidhje ideale, krahasuar me 38.2 përqind të shqiptarëve që kanë thenë se bashkëjetesa e dy nacionaliteteve është ideale. Hulumtim i UNDP-së op.cit f 42.

[132] sondazhi i IRI-t në qershor 2003 raportoi për një shkallë të mbështetjes, jo të levërdishme për Ali Ahmetin prej 6.63 (rënie) dhe shkallën prej 5.11 për Xhaferin (ritje). Numrat e përgjithëm të PDSh-në ngelën shumë poshtë edhe përskaj uljes së shkallës së BDI-së.

[133] 4o% "të drejtimit të gabuar" krahasuar me 20% "drejtimit të vërtetë" sipas një sondazhi të realizuar për Institutin Ndërkombëtar Republikan prej BRIMA, në prill 2003 (sondazh i IRI-t). Sidoqoftë, ky trend është pozitiv, meqë reflekton një rënie të numrit të pesimistëve prej 59% në qershor 2002. Sondazhi i IRI-t mund t'i vendosë të anketuarit më tepër kah çështjet ekonomike sesa kah konflikti ose korrupcioni. Në listën që e kanë pranuar për "problemin më serioz: me të cilin ballafaqohet Maqedonia sot, të anketuarit kishin mundësi të zgjedhin mes pesë zgjidhjeve të veçanta ashtuqë secila prej tyre drejtëpërdrejtë lidhet me ekonominë (papunsia, varfëria, problemet ekonomike, rrogat e ulëta dhe kriza ekonomike). Shih hulumtimin e IRI-t f. 4.

[134] Hulumtimim i UNDP-së op.cit f 11dhe 62.

[135] Maqedonia ka një shkallë kthimi 95%- virtualisht kjo është një mrekulli krahasuar me gjendjen në Kosovë, Bosnje-Hercegovinë dhe Kroaci. Prej diku gjithsejt 160,000 refugjatëve dhe personave të çvendosur, vetëm 6,300 ende s'janë kthyer nëpër shtëpitë e tyre- numri i shqiptarëve dhe i maqedonasve të zhvendosur është i njejtë dhe arrin gjithsejt 4,600 dhe afërsisht 1,700 refugjatë shqiptarë (Inervista e GNK-së me Goran Momirovski, zëdhënës i UNHCR-së 20 qershor 2003). Rreth 1600 janë ende të ngunjuar në qendrat kolektive dhe e përbëjnë rezistencën kryesore kundër kthimit(sidomos në Haraçinë afër Shkupit dhe Mateç të Kumanovës). Gjithashtu qindra refugjatë romë nga Kosova kanë filluar protestat në kufirin Grek, duke kërkuar të hyjnë në Greqi ose vende të treta.

[136] Takime të ndara të GNK-së me zyrtarë të OSBE-së, 20 qershor 2003.

fshatra përgjatë rrugës Tetovë- Jazhincë (në kufirin me Kosovën). Një rast që është paraqitur gjërësisht, i konfirmuar nga OSBE-ja, staCioni i benzinës pronë e një maqedonasi të njohur është dëmtuar vazhdimisht.[137] Në fshatin Opajë rajoni i Kumanovës, 46 shtëpi të rindërtuara janë plaçkitur, sipas raporteve kjo është konfirmuar nga UNHCR-ja.

Shqiptarët në përgjithësi s'kanë qenë të gatshëm t'i identifikojnë kryerësit e krimeve ose të bisedojnë rreth problemit në mbledhjet e Grupeve Këshillimore të qytetarëve dhe policisë, mbledhje këto të promovuara dhe inicuara nga OSBE-ja. Disa zyrtarë përshkruajnë embrionin e një ndjenje, të pas-konfliktit, të dominimit dhe privilegjit nga ana e shumë shqiptarëve. " Brënda dy vitesh këtu nuk do të jetojë asnjë maqedonas" iu tha në besim vëzhguesve shqiptar i rrethit të Tetovës. Disa shqiptarë hapatazi pranojnë rënie në marrëdhëniet dhe kërcënimin nga ana e kriminelëve dhe ekstremistëve. Një prefekt tha se ai nuk do t'i dorëzonte armët e tija, në programin e qeverisë të mbështetur nga UNDP-ja për mbledhjen e armëve, e as që priste që maqedonasit ta bëjnë një gjë të tillë.[138]

Prefektët shqiptarë gjithashtu vërtetojnë diçka që zyrtarët e organizatave humanitare kanë dyshuar një kohë të gjatë: shitja e pronave nga pakicat në të dyja anët vazhdon me shpjetësi. Sidomos i hidhur është konfirmimi i prefektit të Zajasit se fenomeni i shitblerjes së shtëpive është duke u përshpejtuar edhe në mesin e maqedonasve edhe në mesin e shqiptarëve në rajonin e Kërçovës -- e deri në jug qysh prej fillimit të luftës në vitin 2001.[139] Kjo sugjeron se ndjenja e dobësisë te pakicat është përhapur jashtë kufijve të ish-rajoneve të krizës. Qytetarët e përkujtojnë ndarjen e ngadalshme etnike të Shkupit, e simbolizuar me mosgatishmërinë e maqedonasve të provojnë ta kalojnë natën në pjesën veriore të lumit Vardar në Çarshinë e Vjetër, më parë një qendër e gjallë multietnike.

Shqiptarët e rinj duke u kapur për të drejtat e përdorimit të gjuhës sipas marrëveshjes së Ohrit, shfaqin jogatishmëri më të madhe të mësojnë dhe të flasin maqedonisht. Maqedonasit e rinj gjithashtu shfaqin një tendencë drejt shovenizmit. Në shenjë solidariteti me maqedonasit e kyçur në një kontest shkollor në Shemshovë, të rinjtë u grumbulluan në demonstrata anti-shqiptare që përfunduan me rrahje etnike në Shkup.

## C. KONTESTET SHKOLLORE

Në fillim të tetorit 2002, shqiptarët në Shemshovë, fshat në veri-lindje të Tetovës, i anashkaluan procedurat dhe njëanshëm e ndërruan emrin e shkollës që kishte emrin e një heroi maqedonas me emrin e një heroi shqiptar, vendas, bustin e të cilit ata e vendosën në hyrje të shkollës. Prindërit maqedonas e panë këtë si një gjest armiqësor dhe i tërhoqën fëmijët e tyre. Në Kumanovë, sa rriteshin tensionet gjatë konfliktit të pranverës së vitit 2001, një arsimtar shqiptar qe rrahur, dhe shqiptarët i tërhoqën fëmijët nga shkolla e mesme. Një bombë e fuqishme eksplodoi në afërsi të hyrjes së shkollës së mesme, më 25 dhjetor 2002, me çrast vrau një kalimtar dhe plagosi të tjerë, ndërsa për pak shpëtuan nga vdekja shumë nxënës maqedonas.[140]

Në të dy rastet, edhe përskaj ndërmjetësimit tepër të kujdesshëm OSBE-ja, ku u kyçën madje edhe zyrtarë të lartë, nuk ia doli të sjellë mirëkuptim.[141] Në Shemshovë, një ofertë e SHBA-ve dhe UE-së për ndërtimin e një salle të re të fiskulturës nuk ia doli t'i zgjidhë dallimet dhe maqedonasit nuk u kthyen në shkollë. Në Kumanovë në maj 2003 maqedonasit penguan 180 shqiptarë, të shoqëruar nga policia dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë, ta përcjellin mësimin në një shkollë të përzier. Si përgjigje, katër ditë më vonë, më tepër se 1000 shqiptarë e bllokuan rrugën kryesore për në qytet. Ndërmjetësimi i mëtejshëm, i nivelit të lartë, ka shpier drejt një përpjekjeje për mirëkuptim, të cilën një zyrtar e quan më tepër i "marrëveshje për

[137] Intervistë e GNK-së me zyrtar të OSBE-së, 20 qershor 2003.

[138] Program është shtyrë dy herë dhe tani propozohet të mos fillojë deri në Nëntor 2003. Shqiptarët thonë se factor vendimtar është nëse NATO pajtohet të kyçet në mbledhjen e armëve, madje edhe nëse kyçja është vetëm simbolike.

[139] Intervistë e GNK-së me prefektin e Zajasit Rufat Huseini, Janar 2003.

[140] Nxënësit shqiptarë pastaj janë grumbulluar dhe kanë punuar në ndërrime në një shkollë fillore kumkanë dalë akuza bizar për "helmim". Vëzhguesit besojnë se akuzat mund të jenë të ndërlidhura me ventilacionin e dobët në kuzhinë ose thejshtë histeri e masës. Sidoqoftë, ankesat ishin mjaft serioze për tu konsideruar si motiv i mundshëm për bombën e dhejtorit 2002.

[141] Grupet e kundërshtuara në secilin grup etnik me kokëfortësi kundërshtuan ndërmjetësimin. Shqiptarët do ta përfundojnë vitin në "Univesitetin e punëtorëve" (diçka si kolegj për të rinj) me qëllim të përfundimit të një marrëveshjeje bashkarisht të përdoret shkolla e mesme në vitin 2004, e përcjellur me marrëveshje për dy shkollat tjera të mesme të qytetit. Mundësisht një "qendër shkollore multikulturore", me financim ndërkombëtar do të mund të ndërtohej për të përmbushur kapacitetet shumë të nevojshme edhe për shqiptarët edhe për maqedonasit.

ndasi më të madhe" se sa zgjidhje të vërtetë.[142] Këto dy konteste, nusprodukt i drejtëpërdrejtë i konfliktit 2001, janë teste të rëndësishme për Maqedoninë në periudhën pas marrëveshjes së Ohrit. Si vërtetim i asaj sa e rëndë u bë çështja, ministri i Arsimit Aziz Pollozhani, hoqi dorë nga përkrahja e respektimit të përbashkët të simboleve kombëtare dhe e hudhi idenë që shkollat në vend të emrave të kenë numra.

Rishtazi, kontestet e hidhura rreth shkollimit janë shfaqur në Shkup dhe në qytetin e dytë për nga madhësia Manastiri. Më 11 shtator, prindërit maqedonas i tërhoqën fëmijët e tyre nga një shkollë e mesme në kryeqytet për të protestuar kundër vendimit të Pollozhanit t'i transferojë shtatë klasa me nxënës shqiptarë. Ditën e ardhshme, nxënësit dhe prindërit maqedonas filluan bojkotin në një shkollë të mesme në Manastir për ta kundërshtuar vendimin e Pollozhanit për shkollimin e shqiptarëve. Ministri u akuzua për tentim "të importit" të shqiptarëve në Manastirin kryesisht maqedonas.[143] Porositë shoviniste se shqiptarët nuk janë të mirëseardhur në Manastir u paraqitën në kohën kur tensionet ishin në ritje, pas incidenteve me gjuajtje të gurëve. Në Shkup, vetëm kordoni i policisë parandaloi konfrontimin ndërmjet nxënësve shqiptarë, të cilët tentonin të hyjnë në shkollë, dhe nxënësve maqedonas të cilët protestonin kundër Pollozhanit. Rruga pa krye e Shkupit është përqëndruar në një rajon shumë të përzier, Çair.[144] I tronditur nga rekacioni, Ministri i Brëndshëm Kostov, shprehi "turpin" e tij për mohimin e të drejtës së shqiptarëve të mësojnë në gjuhën e tyre amtare. Sidoqoftë, qeveria përkohësisht e ka suspenduar vendimin e Pollozhanit, dhe ai qe kritikuar ashpër nga disa drejtime për gjoja drejtim të keq të tërë çështjes.

## D. TENSIONET NDËRMJETS SHQIPTARËVE DHE TURQVE

Sipas një barometri tjetër sa i përket marrëdhënieve ndëretnike në periudhën pas Ohrit, prindërit turq gjithnjë e më tepër janë në kundërshtim me shqiptarët rreth shkollimit në gjuhën tyre, mundësisë për t'i zgjedhur drejtorët e shkollave dhe rreth presionit që e kanë ndier që edhe ata edhe fëmijët e tyre të indetifikohen si shqiptarë.[145] Në raportin e një zyrtari ndërkombëtar me eksperiencë thuhet se turqit etnik janë të shtrënguar " të mendojnë se një ditë rajoni i Tetovës do të jetë rajon i pastër etnik shqiptar, me kulturë etnike shqiptare dhe ndikim politik, prandaj do të kishte qenë më mirë ta përshtatin kulturën dhe identitetin për fëmijët e tyre". [146] Raporti përfundon me atë se ky presion çon drejt asimilimit me forcë të komunitetit turk.

Është ironi e demaskuar se Ohri, që e ul pozitën e ngritur të maqedonasve etnik dhe, në teori, do të duhej ta rritë pozitën e të gjithë qytetarëve, është i jopopullarizuar jo vetëm te serbet ortodoks dhe vllehët, por edhe te muslimanët dhe turqit gjithashtu. Muhiç, një musliman nga maqedonia dhe ekspert i dialogut, beson se "të gjitha komunitetet etnike jo-shqiptare kanë qëndrim negativ ndaj marrëveshjes së Ohrit" si favorizues të komunitetit shqiptar.[147] Nga ana e tyre, shqiptarët janë duke zgënjyer në ndarjen e arritjeve të tyre me pakicat tjera. Pas zgjedhjes së fundit të një turku, Zoran Sulejmanov, si gjykatës në Gjykatën Kushtetuese, nënkryetari i PPD-së, Abdylhadi Vejseli shfaqi pakënaqësi duke thënë se "shqiptarët nuk luftuan për të pa se postet e tyre shkojnë te të tjerët"[148] Shqiptarë të mirënjohur nga

[142] Intervista e GNK-së me zëvendës ministrin e brëndshëm Fatmir Dehari, 21 maj 2003.

[143] Bitola, në shqip i njohur si Manastir, ka vlerë të rendësishme simbolike për shqiptarët për rolin që ka në themelimin e alfabetit. Ishte vendi i trazirave në 2001, pas incidenteve me UÇK-në në pjesët tjera të Maqedonisë. Gjatë trazirave iu shkaktua dëm serioz pronave të maqedonasve musliman sa edhe të shqiptarëve të qytetit.

[144] Fati i Çairit do të jetë çështje veçanërisht e ndjeshme gjatë ndarjes së re territoriale të komunave dhe ligjit për Shkupin. Shumë maqedonas besojnë se ky kështë motivi për kohën e vendimit të ministrit Pollozhani, që ka mundur të sillet në korrik ose gusht kur nuk do të kishte tërhequr reakcione kaq të ashpra. Sikur në kontestin shkollor të Kumanovës, gara për resurset e pakta duket se e lëviz kontroversën e Çairit; shkolla e saj punon me kapacitet të plotë, dhe së paku një klasë maqedonase është detyruar të shkojë në vend tjetër.

[145] Teoretikisht, Ohri siguron të drejt për arsim të të gjithë qytetarëve, jo vetëm të shqiptarëve. Garanton mësimin fillor dhe të mësim në gjuhën amtare për të gjitha pakicat; dhe derisa shqiptarëve si një popullatë "mbi 20 perqind" u është dhënë privilegj iv eçantë për arsimim në nivel universitar në gjuhën tyre, të gjitha pakicat duan të përfitojnë nga "discriminimi pozitiv" (akcion afirmues) për të siguruar regjistrim pajtohet me përbërjen e tyre në popullatë. Marrëveshja e Ohrit, Pjesa e 6, "Arsimi dhe përdorimi i gjuhës", sidomos paragrafet 6.1-6.3 dhe paragrafi 4 i nenit 48. Kjo parasheh detyrimin se nxënësit e mësojnë edhe gjuhën maqedonase.

[146] Raport joformal i titlluar, "Çështjet arsimore për pakicat tjera jo shqiptare", i dërguar GNK-së.

[147] Ferid Muhiç, shkrimi në Shënime mbi Maqedoninë, e publikuar prej OJQ ÉSP International në 6 qershor 2003, f 39.

[148] Citat nga "Parlamenti zgjedh gjashtë nga nëntë gjykatësit kushtetues", Ditori për Shkupin, 8 maj 2003. Shif gjithashtu "Të gjithë turqit e bojkotojnë mësimin", Dnevnik, 1 prill 2003.

rajoni i Dibrës vazhdojnë të pohojnë se maqedonasit musliman vendas janë "në të vërtetë shqiptarë".[149]

Me shqiptarët që janë në kundërshtim edhe me pakicat e të njejtit religjion, nuk është për tu çuditur se implementimi i Ohrit me maqedonasit më së shpeshi duket si një luftë e kotë e dy grupeve dominante.Sipas një rregulli dyshimi rënues se maqedonasit dhe shqiptarët nuk do ta shmangin konfliktin i gryen themelet e zotimit të nevojshëm që marrëveshja të funskionojë. Me Georgievskin dhe Xhaferin të cilët pandërpre mbrojnë idenë e inkompatabilitetit të të dy komuniteteve më të mëdha, nuk është për tu habitur që mbështetja për Ohrin vazhdon të dobësohet.[150]

## E. BALLAFAQIMI ME TRASHIGIMINË E VITIT 2001

Derisa siguria dhe ekonomia janë faktorët më të rëndësishëm për stabilitet të konsoliduar, tre çështje tjera duhet gjithashtu të kapen; llogaria për një numër të vogël të personave të zhdukur gjatë konfliktit; zgjidhja e krimeve të luftës dhe restaurimi i objekteve religjioze të dëmtuara

Shkurtësia e konfliktit të vitit 2001 e kurseu Maqedoninë nga numri i madh i viktimave, gjë që ishte parë në konfliktet tjera. Derisa në Kosovë ka 4000 të zhdukur dhe në Bosnë 30000 në Maqedoni janë të zhdukur vetëm 20 persona (trembëdhejtë maqedonas, gjashtë shqiptarë dhe një bullgar). Ende, këto raste janë përkujtues për punën e papërfunduar dhe kanë ngjyrime politike. Daja i Ahmetit, deputeti i BDI-së, Fazli Veliu, e ka akuzuar ish ministrin e punëve të brëndshme Boshkovski se ai e din fatin e vëllaut të tij të zhdukur, Ruzhdi Veliu.[151] Në anën tjetër, në një hetim Suedez, të mbështetur nga UE-ja, që u publikua në 2002 është shpallur se Komandanti i ish-UÇK-së dhe zyrtar i PDSh-së Daut Rexhepi ("Komandant Leka") ka informacione për fatin e një maqedonasi të zhdukur nga Tetova. Familjet maqedonase janë njësoj të frustruara se ky dhe kontaktet tjera nuk janë çuar deri në fund.

Numri i kufizuar dhe rrethanat e ngjashme të rasteve (disa shqiptarë janë zhdukur në afërsi të pikave të njohura kontrolluese ose stacioneve të njohura policore) sugjeron se, për dallim prej Bosnës dhe Kosovës, zbulimi i asaj që ka ndodhur është i mundshëm. Në vazhdim të shpalljes nga hetimi Suedez, Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (ICMP) propozoi një proces nacional -- komision të përzier të Qeverisë dhe Parlamentit- duke u përqëndruar në vendndodhjen. Ky komision nuk është formuar ende, dhe familjet e viktimave ngelin me dyshim dhe të dëshpëruar.[152] Me dyshim edhe ndaj përpjekjeve të ndërkombëtareve, familjet maqedonase kanë kundërshtuar dhënien e provave të ADN-së që do të komfirmonte vallë katër trupat në Maqedoninë perëndimore janë trupat e familjarëve të tyre.[153]

Shqiptarët akuzojnë se, edhe përskaj amnistisë, anëtarët e ish-UÇKsë ende shqetësohen dhe burgosen, sidimos në kufi ku disa figura të profilit të lartë janë

[149] Intervistë e GNK-së në Dibër, 13 Janar 2003.

[150] Edhepse diplomatët ii kin kësaj teme politikisht të pasaktë, dallimi në përqindjen e shtimit ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve sipas Georgievskit dhe të tjerëve shifet si diçka që gjithnjë e më tepër sjell konfliktin e paevitueshëm ndërjet shqiptarëve dhe maqedonasve. Duke iu referuar kontrversave të regjistrimit të popullatës, zëvendës drejtori i entit statistikor Milaim Ademi në mnyrë indirekte e vërtetoi frikën e maqedonasve. Ai tha për të përditshmen nga Shqipëria *Shekulli* se shqiptarët nuk mund të jenë më pak se 22.7 përqind, numër ky i regjistrimit të vitit 1994, paiqë 38 përqind të foshnjeve në vend në vitin 2002 janë shqiptarë. "Argumentet e Ademit janë se shtimi i populates shqiptare është shumë më i madh se i nacionaliteteve tjera," në *Ditari i Shkupit*, 26 gusht, "Demografi: 38 përqind të foshnjeve janë shqiptarë".

[151] "Një gjë është e sigurt se ish ministry i brëndshëm Ljube Boskovski e din të vërtetën pët fain e vëllaut tim", shih "U gjet trupi i vëllaut të Veliut", *Dnevnik*, 19 korrik 2003.

[152] Një burim ndërkombëtar thotë se kryeparlamentari Nikola Popovski është pëengesa më e madhe për krijimin e një komisioni të përbashkët parlamentar-qeveritar. Në një conference më 18 korrik 2003, zyrtarët e KNPH kërkuan ligj për mbrojtjen e dëshmitarëve. Një familjar i viktimave deklaroi "Ne kemi pritur shumë më tepër nga kjo konferencë. Çështjet kyçe për mënyrën e kidnapimit të viktimave, vendi ku janë marrë ata dhe vallë janë ende të gjallë nuk u hapën". "Familjet e të kidnapuarve kërkojnë përgjigje nga Ahmeti dhe Boshkovski", cituar në *Ditari i Shkupit*, 21 korrik 2003.

[153] Një hulumtim, i financuar nga Gjermania, në komunën e Xhepçishtit afër Tetovës nuk tregoi asgjë. Sipas KNPH trupat e gjetur afët Treboshit, ku ish ministri i brëndshëm Boshkovski, edhe përskaj vërejtjeve të kominitetit ndërkombëtar, e dërgoi policinë në nëntor 2001 duke prodhuar konflikt me shqiptarët e armatosur me çrast u vranë tre police dhe dukshëm u rritën tensionet. OSBE-ja kishte refuzuar t'u lejojë vëzhguesve të saj të kërkojnë mbrojtjen e NATO-s për të siguruar lokacionin për ekshumimin më vonë. Arsyetimi ishte se misioni i OSBE-së e ka mandatin vetëm "dimensionin human" e jo mandat për "të drejtat e njeriut".

ndaluar.[154] Ministri i brëndshëm Kostov insiston se procedura është ndërperë, dhe departamenti i OSBE-së për çështjet ligjore thotë se burgosjet e tilla janë zvogëluar në gati një burgim në muaj.[155] Më shqetësues, sipas OSBE-së, është se ndërmjet 30 dhe 100 fletarreste për krime lufte ende janë në fuqi. Kjo don të thotë qindra shqiptarë, duke përfshi edhe fiGura të shquara, janë ende, teoretikisht, subjekt arrestimi dhe persekutimi. Gjykatat kanë shfaqur rezistencë të fuqishme ndaj përpjekjeve të qeverisë t'i detyrojë gjykatat t'i tërheqin rastet.

Mungesa e një mekanizmi të qartë për të vendosur se kush do të ballafaqohet me gjykim për krime lufte e shton pasigurinë në mesin e shqiptarëve sa i përket amnistisë dhe hidhërimin në mesin e maqedonasve. NATO gjoja ka garantuar udhëheqësinë e UÇK-së gjatë negociatave në Ohër se vetëm Tribunali i Hagës (ICTY) do t'i gjykojë të akuzuarit për krime lufte. Shqiptqrët insistojnë në faktin se kjo i ndalon gjykimet në gjykatat lokale, derisa maqedonasit, të mbështetur nga ekspertë për të drejtat e njeriut, janë ankuar dhe kundërshtuar se ICTY nuk vepron, dhe gjykatat lokale kanë të drejtë të veprojnë kështu.

Për ta ruajtur vendin prej kundërshtimeve përçarëse, Prokurorja e Tribunalit të Hagës (ICTY) Karla Del Ponte e morri jurisdikcionin mbi pesë raste mirë të njohura të krimeve të luftës "dhe të gjitha rastet e ardhshme". Sidoqoftë, në tetor të 2002 tribunali e refuzoi kërkesën e saj për raste tjera, duke e përkufizuar jurisdikcionin mbi pesë rastet.[156] Ky vendim të gjitha rastet e ardhshme të mundshme të krimeve të luftës nga kriza e vitit 2001 i hudh në harresë. Nëse ndonjë prokuror i Maqedonisë ose gjykatë e merr jurisdikcionin, në atë rast kundërshimi është i qartë. Shqiptarë të akuzuar tanimë janë çuar para gjykatave maqedonase. Njëri prej tyre, Krenar Osmani, u dënua por pas protestave të ashpra në fund u lirua.[157]

Zgjidhja logjike është që Tribunal i Hagës (ICTY) t'i shqyrtojë rastet dhe tu jep dritë të gjelbërt gjykatave maqedonase t'i gjykojnë rastet që tribunali i çmon si më pak serioze. Minstria e Drejtësisë është duke përgaditur një ligj për bashkëpunim me Tribunalin që përmban dispozitën për rishqyrtim procedural dhe ligjor në Hagë. Duke dashur t'i përmbledhë operacionet e veta, Tribunali me të madhe ka ikur nga marrja e kësaj detyre. Poqese nuk e ndërron qasjen dhe pranon disa përgjegjësi për shqyrtim të rasteve, Maqedonia do të mund të ballafaqohet me një kundërshtim të nxehtë sikur në rastin Osmani.

Ka mënyra tjera më të lehta se gjykimet e krimeve të luftës për ta mbyllur derën e të kaluarës. Një dyzinë objektesh religjioze qëndrojnë të rënuara, si rezultat i dhunës së turmave gjuajtjes së drejtëpërdrejtë të ushtrisë ose sabotimit. UNHCR beson se rindërtimi i tyre do të ndihmonte të ndalet teposhta e marrëdhënieve ndëretnike. Agjencioni Evropian për Rikonstruim ka bërë një hap të mirë duke filluar, më 8 korrik 2003, rekonstruimin e kishës Shën Atanisij në Leshkë (Leshok),[158] një fshat në rrethinën e Tetovës. Mirëpo nuk ka pasur pothuaj asnjë riparim në vendet tjera, psh Manastir dhe Prilep [159]

---

[154] Xhevad Ademi, ish nën kryeytar i Partisë Nacional Demokratike (shqiptare) ishte arrestuar në kufi me Shqipërinë dhe u sjell në Shkup.

[155] Zyrtarët e OSBE-sëbesojnë se, në përgjithësi, amnistia është aplikuar "mjaft kënaqshëm". Intervistë e GNK, 10 mars 2003. Shih gjithashtu intervistën në vijim të GNK-së me deparatametin e OSBE-së për çështje juridike, 14 korrik 2003.

[156] Shih dokumentin e TNKJ-së në Re: Republika e Maqedonisë – rasti No. IT-02-55-MISC.6, "Vendim rreth kërkesës së Prokurorit për respektim dhe propozim për Urdhër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" 4 tetor 2002, në http://www.un.org/icty/Supplement/supp37-e/misc.htm. GNK-ja ka kuptuar prej burimeve të TNKJ-së se rastet janë përmbledhur në dy: rasti i Lubotenit dhe i ashtuquajturi rast i udhëheqësisë së UÇK-së. Luboteni ishte vendi ku ndodhi ekzekutimi i pretenduar (i supozuar) i gjashtë shqiptarëve, një i vdekur nga rrahja dhe tre nga bombardimi më ose rreth 10 gushtit 2001. "Rasti i udhëheqësisë së UÇK-së" përmban barbarizmat e pretenduara (supozuara) të 28 prillit kundër forcave maqedonase të sigurisë, si edhe raste tjera përfshirë edhe torturën e pretenduar (supozuar) të pesë punëtorëve në rrugë afër Grupçinit më 7 gusht 2001.

[157] Lirimi i paradokohshëm i Krenar Osmanit ka zvogëluar pak hidhërimin lidhur me amnistinë. Zyrtarët deklarojnë se edhepse prokurorët dhe gjykatat nuk kishin bazë të qartë për ta aplikuar "përjashtimin nga krimet e luftës" ndaj tij, ka pasur prova të mjatueshme për ta dënuar atë për krime kundër shqiptarëve, e jo ndaj maqedonasve.

[158] Kisha kishte shpërthyer në rrethana të dyshimta pas nënshkrimit të marrëveshjes së Ohrit në gusht 2001. Rikonstruimi i kishës do të kushtojë €400,000.

[159] Dy pusi të UÇK-së (Vicç më 28 prill 2001 dhe në Karpallëk më 8 gusht 2001) nxitën dhunën e turmave në qytetet e viktimave, Manastir dhe Prilep. Në Manastir u shkatërruan dyqanet dhe shtëpitë prona edhe të shqiptarëve edhe maqedonasve musliman; në Prilep, turma e shkatërroi një xhami Turke, monument historik. Pusia e UÇK-së në Karpallëk rezultoi me dhjetë reservistë të vdekur sulmi më i shtrenjtë gjatë konfliktit. Kjo ndodhi në një moment shumë të rendësishëm të nagociatave të Ohrit, vetëm pak para se partitë ishin pajtuar rreth marrëveshjes në Ohër me çka u ndal konflikti.

## F. ROLI I DY LIDERËVE

Kontributi i vetëm i madh për mediat në Maqedoni nuk ka ardhur prej donatorëve, por prej dy liderëve kryesorë politik, kryeministrit Branko Cërvenkovski dhe lideri i BDI-së Ahmeti. Aty ku paraardhësit e tyre Georgievski, Xhaferi dhe Thaçi do të pajtoheshin privatisht e pastaj do të lëshonin thirrjet e tyre fanatike, Cërvenkovski dhe Ahmeti janë model i transparencës dhe dekorit. Sidoqoftë duke e zmadhuar dhe lavdëruar linjën e tyre për "progres" ata i kanë furnizuar mediumet në mënyrë konzistente me tone të shumë të moderuara. Në një mënyrë, Maqedonia është e bekuar me një situatë ideale politike në periudhën e pas-konfliktit; që të dy liderët e partive kryesore etnike janë mbështetës të marrëveshjes paqësore, e kanë refuzuar ndarjen në çdo hap dhe tani ballafaqohen vetëm me opozitë të dobët. Që të dy me vendosmëri kanë refuzuar të kyçen në thirrje të lira të nacionalizmit.

Diplomatët janë zbutur dukshëm ndaj Cërvenkovskit, i cili e ka ndërruar qëndrimin e tij radikal nati-NATO gjatë fushatës në Kosovë më 1999. Edhe kur ishte jo i popullarizuar, Cërvenkovski ishte një mbështetës i fuqishëm i marrëveshjes së Ohrit. Në Bruksel rishtazi në takimet me zyrtarët e UE-së dhe NATO-s, Cërvenkovski ka thënë se qeveria poqese nevojitet do ta zbatojë Ohrin "madje edhe pa mbështetjen e opozitës"[160] Për më tepër duke demonstruar dëshirën e tij për pajtim, ai në një fjalim të gjatë në kongresin e LSDM-së më 8 shkurt 2003 pranoi, se moskënaqësitë legjitime të shqiptarëve qëndronin prapa konfliktit të vitit 2001.[161] I njohur si njeri, në qeverinë e tij të parë, si përkrahës i rrugës së ashpër dhe alergjik kundër nacionalizmit shqiptar, pranimi public është i rendësishëm.[162] Në atë fjalim, Cërvenkovski shkoi më larg se çdo politikan maqedonas duke pranuar se maqedonasit vetë bartin një pjesë të përgjegjësisë për konfliktin.[163] Në atë fjalim, Cërvenkovski shkoi më larg se çdo politikan maqedonas duke pranuar se maqedonasit vetë bartin një pjesë të përgjegjësisë për konfliktin.

Edhepse shumëkush pëshpërit për lidhjet e supozuara të ish-komunistit, liderit të LSDM-së me Beogradin, Cërvenkovski ka marrë një qëndrim befasues të moderuar rreth pavarsisë së Kosovës, një çështje e ndieshme për shumicën e maqdonasve, duke thënë: "Refuzoj të besoj se e ardhmja e Maqedonisë varet nga e ardhmja e Kosovës… Është më me rendësi për tërë rajonin që Kosova të jetë një territor "normal" se sa të jetë… pjesë e Federatës Serbe".[164]

Ahmeti gjithashtu ka marrë qëndrime të ngjashme konstruktive. Në 22 maj 2002, pas një takimi me kryeministrin e Shqipërisë, Fatos Nano, ai në mënyrë efektive iu dha dritë të gjelbërt forcave maqedonase të sigurisë të merren me ekstremistët shqiptarë:"institucionet e shtetit duhet të reagojnë kundër grupeve ekstremiste që nuk duan paqe dhe stabilitet". Për ish udhëheqësin e grupit të kryengritësve që vetëm para dy vitesh vendoste kurtha kundër forcave të njejta, kjo ishte një kthesë befasuese.[165] Ahmeti gjithashtu shkoi nëpër fshatra për t'i zbutur fshatarët e hidhëruar pas disa operacioneve kontraverse të policisë, duke e nënshtruar veten akuzave se ai është "peng i Brankos". Edhe në takime private, ai është përmbajtur ta fajësojë, partnerin e koalicionit, për ritmin e ngadalshëm të zbatimit të Ohrit. Publikisht Ahmeti përsëri ka proklamuar se "vullneti politik dhe

---

[160] Deklaratë e Cërvenkovskit gjatë vizitës në Bruksel, 8 maj 2003.

[161] Në një fjalim më të gjatë më 8 shkurt në kongresin partiak të LSDM-së, Cërvenkovski e kundërshtoi pyetjen e koncesioneve ndaj shqiptarëve ku ai ka bërë një rebelim "Ky kongres ka rast të sheh se e vetmja zgjedhje për ne si komb dhe si shtet në vitin 2001 ishte lufta totale etnike me pasoja tragjike ose një kompromis multientik dhe ridefinim i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Edhepse ka 100 argumente për ta mbrojtur Kushtetutën e vitit 1991, është fakt se shqiptarët asnjëherë s'e kanë pranuar atë". Vërejtjet e tija sollën kritikë të ashpër nga ish kryeparlamentari Stojsan Andov, i cili tha se "Teza e tij se Kushtetuta ishte arsye për konfliktin në Maqedoni është shumë e rrezikshme". Andov: Cërvenkovski promovon një tezë të rrezikshme për Kushtetutën", *Vest*, 18 shkurt 2003.

[162] Gjatë mandatit të tij si kryeministër, Cërvenkovski publikisht e uroi policinë që gjuajti me armë në demonstrantët e Gostivarit në vitin 1996, duke vra tre shqiptarë mes tyre një plak; një demonstrant në Universitetin e Tetovës në vitin 1997 u vra nga policia.

[163] Kryetari Boris Trajkovski gjithashtu shprehu interpretim të moderuar për konfliktin në një fjalim në parlament duke i prezentuar amandamentet Kushtetuese, që dalin nga Ohri, në gusht 2001. Trajkovski aludoi se përgjegjësia për konfliktin nuk bie vetëm mbi UÇK, por edhe mbi shumë të tjerë.

[164] "Rreziku nga nëntoka kriminalo-politike nuk mund të nënçmohet: intervistë e Branko Cërvenkovskit", *Utrinski Vesnik*, 18 mars 2003. Cërvenkovski më pas it ha GNK-së "në të vërtetë do të ishte më mirë për Maqedoninë që Kosova të jetë e pavarur dhe të ketë shtet juridik, se të jetë pa ligj dhe të ngele pjesë e Federatës Serbe". Cërvenkovski i përgjigjej pyetjes "A do të ketë pasoja për Maqedoninë nga gjendja në Kosovë dhe vrasja e Gjingjiqit?"

[165] Roli në përgjithësi mbështetës, i Ahmetit, për policinë e kanë bërë të lëndueshëm dhe të hapur për kritika të forta nga rivalët si Xhezair Shaqiri, i cili i tha GNK-së se fshatarët janë duke mbledhur armatim duke thënë "ne s'do ta presim Ahmetin dhe policinë të na sulmojnë". Intervista e GNK-së, 16 qershor 2003.

bashkëpunimi i mirë ndërmjet partnerëve të koalicionit, ekziston".[166]

Derisa interakcioni ndërmjet Cërvenkovskit dhe Ahmetit ka pika të vështira që brënda kohës mund të bëhen të problematike, burime partiake që kanë qenë të pranishëm në disa takime midis dy liderëve thonë se këta të dy kanë krijuar raport të mrekullueshëm. Ata që në kierarki janë nën të dytë, në përgjithësi marrin pozicione të forta, por në fund të takimit disaherë disi padukshëm dy liderët partiak zakonisht arrijnë marrëveshje. Më 25 korrik 2003 në një udhëtim, të rrallë, në terren që kishte mbulesë të favorshme mediale ata shkuan në Dibër (një qytet me shumicë shqiptare afër kufirit me Shqipërinë) të vizitojnë një fabrikë me investim të huaj, dhe të takohen me zyrtarët vendorë.

### 1. Qasja prej fillimit e Cërvenkovskit

Nën sipërfaqe, megjithatë, liderët e BDI-së thonë se ka trende që do të mund, poqese nuk shqyrtohen, ta thyejnë harmoninë e shfaqur. Më e njohur është akuza e zyrtarëve të BDI-së se Cërvenkovski qëllimisht po punon në drejtim që Ahmeti të duket i dobët, ashtuqë të sigurojë dominim të plotë të LSDM-së mbi partnerin shqiptar. Rreth marrëveshjes për ballinën e pasaportës në gjuhën shqipe, Cërvenkovski shkuli disa lëshime prej Ahmetit, shumica e tyre poshtërime të pakuptimta. Për atë si janë paraqitur marrëdhëniet mes tyre, këshilltarët e Cërvenkovskit sajuan një foto të të dyve ku Amheti duket i vogël dhe larg nga nikoqiri i tij.

Ironia e qasjes së Cërvenkovskit drejt sjelljeve të tija me Ahmetin dhe rreth zbatimit të Ohrit është një pozëitë aq dominante që shumë pak liderë tjerë në Ballkan e gëzojnë. Dy të tretat e elektoratit shprehin besim në të që është dhjetpërqindësh solid më i lartë se rivali i tij.[167] Sipas një ankete të IRI-t, në prill të 2003, mbështetja për LSDM-në është më tepër se dyfish më e madhe se për VMRO-DPMNE-në rivale.[168] Jo vetëm rivali i tij i vetëm serioz, për një kohë të gjatë (Georgievski), që ka lëshuar skenën politike, por kryetari i shtetit është në hall të madh politik. Shifrat e Boris Trajkovskit ishin të vogla dhe me tendencë zvogëlimi pas negociatave fatkeqe me SHBA-të për dërgimin e usHtarëve të Maqedonisë në Irak dhe me skandalin e përgjimit të bisedave telefonike.[169] Cërvenkovski ballafaqohet nganjëherë me probleme nga frakcioni i vijës së fortë në partinë e tij, e udhëhequr nga spikeri i Parlamentit Nikolla Popovski dhe deputeti Tito Petkovski, por ai ia del me to me sukses.

Maqedonasit me të madhe po dalin në anën e Cërvenkovskit në pranimin e nevojës ta akomodojnë Ahmetin dhe ta mos e lënë atë të lëndueshëm para opozitës papërgjegjësi dhe ekstremistëve.[170] Kjo do të

---

[166] Intervista e Ahmetit për të përditshmen tiranase *Shekulli*, e cituar në *Ditari i Shkupit*, 21 qershor 2003.

[167] [41] Madje diçka rreth 17.5 për qind të shqiptarëve thonë se kanë besim te Cërvenkovski, derisa gjysma nuk shprehin aspak besim te ai. Në anën tjetër, 91 përqind e maqedonasve nuk shprehin besim te Ahmeti dhe vetëm një minimum prej 2.8 përqind shprehin pak besim. Hulumtimi i UNDP-së op. cit., ff. 58-59. Hulumtimi edhe më i ri i IRI-t gjithashtu e paraqet Cërvenkovskin me një avantazh të rehatshëm para rivalëve.

[168] Në mesin e votuesve të të gjitha etniciteteve; LSDM-ja ka marrë pothuaj çerekun e votave me 23 përqind derisa VMRO-DPMNE ka marrë 10 përqind. Pothuaj tre herë më tepër të anketuar kanë thënë se LSDM-ja i paraqet qëndrimet e tyre krahasuar me VMRO-DPMNE. Në sondazhet e janarit 2003, LSDM-ja kishte mbështetje prej 32.5 përqind, krhasuar me 5.2 përqind të VMRO-DPMNE. Anketa telefonike e Institutit për Demokraci, Solidaritet dhe Shoqëri Civile, në janar 2003. Ish nënkryetari i VMRO-DPMNE dhe Ministër i Bujqësisë Marjan Gjorçev sinqerisht pranoi gjendjen e keqe të partisë së tij: "Në këtë moment mund të them se… situata në partingë tone është në një nivel që do të mundësonte punë normale partiake. Kishte ngjarje turbulente që e destabilizuan partinë dhe ato me siguri do të ndikojnë në aktivitetet e mëtuttjeshme të partiesë". Intervistë me Marjan Gjorçev, VMRO-DPMNE VP", *Utrinski Vesnik*, 13 janar 2003.

[169] Trajkovski, sipas sondazhit të IRI-t, është mbështetur vetëm me 1 përqind. Në aNën tjetër Cërvenkovski është mbështetur me 12 përqind , i përcjellur vetëm nga Kiro Gligorov, kyretari i pare, i respektuar, i cili nuk është më kativ në politikë. Trajkovski siaps burimeve të afërta me kryetarin, vazhdimisht ka qenë kontaktuar nga Ambasada e SHBA-ve rreth çështjes thellë të jopopullarizuar për dërgim të trupave në Irak gjatë luftës atje por ai u përpjek të arrijë marrëveshje për kyçjen e SHBA-ve në kontestin me Greqinë për emrin e vendit. Bisedat rreth emrit dështuan, dhe ai qe kritikuar ashpër. Maqedonia dërgoi dy oficerë për lidhje në Komandën Qëndrore të SHB në Floridë. Në fund të prillit 2003, parlamenti me shumicë dërmuese votash vendosi të dërgojë trupat në Kuvajt si pjesë e koalicionit pas-luftës. Falja kundërthënëse e Trajkovskit, më 7 prill, për një bashkëpartiake, ish Drejtoreshën e Agjencionit për Zbulim, Dosta Dimovska, për rolin e saj në një aferë përgjimi të supozuar (pretenduar) e bëri atë edhe më të lëndueshëm dhe më të izoluar se kurdoherë. Afera e përgjimit u bë publike, prej atëherë liderit të opozitës Branko Cërvenkovski në fillim të vitit 2001. Gjoja, Cërvenkovski, gazetarë dhe diplomatë, përfshirë edhe ata të Ambasadës së SHBA-ve kanë qenë objekt i përgjimit.

[170] Shih "BDI nuk mundet të jetë vetëm dekor në qeveri", *Utrinski Vesnki*, 18-19 janar 2003. Disa vëzhgues ia mveshin kujdesit të kreymenistrit ambiciet e mundshme për kryetar në 2004.

kishte qenë herezi para një viti, por redaktorët e dy revistave dhe një gazete ditore ia tërhoqën vëmendjen qeverisë "t'i përfundojë obligimet që dalin nga Marrëveshja Kornizë (Ohri) më qëllim që mos të lihet hapsirë për (ekstremistët shqiptarë) opcionet ushtarake"[171]

## 2. Stili i butë i Ahmetit

Qëndrimet radikale të PDSh-së janë përkujtues se Ahmeti ballafaqohet me shumë më tepër kriticizëm të brëndshëm se Cërvenkovski.[172] Një njeri me pothuaj vetëpërmbajtje Gandiane, megjithatë, ai stoikisht e pranon kriticizmin e mbledhur ndaj tij nga PDSh-ja dhe gazeta e saj sarkastike, *Fakti*. "Ne nuk jemi këtu për të bërë shfaqje por për të arritur rezultate" është një prej fjalive të tija standarde. Ai ua ndalon zëvendësve të tij të premtojnë ose të paralajmërojnë iniciativa derisa të mos jetë "kryer marrëveshja". Ahmeti parapëlqen që më parë të tentojë të ngadhnjejë kundër shpifësve se sa thjeshtë të konfrontohet me ta ose t'i nxjerrë nga puna. Pas një sulmi verbal të koordinuar të Xhaferit dhe Thaçit në Ohër në prill 2003, Ahmeti edhe një herë zgjedhi pajtimin (një diskutim i pafrytshëm personal). Ai ka shfaqur butësi të ngjashme edhe kur është marr me Fadil Sulejmanin problematik, ish rektori i Universitetit të Tetovës dhe komandantët e rebeluar të ish-UÇK-së siç është Izahir Samiu (komandant Baci) nga Shemshova.[173]

Për dallim nga shumë politikaj të Ballkanit, Ahmeti nuk ngurron të përzihet me njerëzit e rëndomtë, duke kaluar orë të tëra, për shembull në Vicë duke i dëgjuar ofendimet gjatë një tentimi t'i zbutë tensionet. Sidoqoftë, si një menaxher ai lejon që diçka të dëshirohet. Ata që ai i ka emëruar në BDI duhet të bartin më shumë përgjegjësi për zbatimin e ngadalshëm të Ohrit. Shumica e tyre (përveç Ministrit të Arsimit Pollozhani dhe Drejtorit të Aeroportit Fatmir Besimi) kanë funskionuar dobët, ose pothuaj s'kanë funksionuar aspak. Siç u tha më lartë, Milaim Ajdini shfaq pak interes për të përmirësuar transportin e komunave madje edhe të drejtën për ndërtime; Ministri i Drjetësisë Ismail Dardhishta është përqeshur haptaz si joefikas ndërsa ai ka pranuar se ilegalisht e merr rrymën elektrike për shtëpinë e tij. Më i zellshmi, Zëvendës Kryeministri, Musa Xhaferi, është i stërngarkuar me çështje më të rendësishme. Dy prej zyrtarëve më të aftë të BDI-së -- Agron Buxhaku dhe Teuta Arifi -- janë në parlament, e jo në qeveri, ku talneti i tyre mund të përdëroret më së miri. Njerëzit brënda parlamentit thonë se anëtarët tjerë të grupit parlamentar të BDI-së janë "të padobishëm".

Cërvenkovski dhe Ahmeti e ndajnë përgjegjësinë për komunikimin e dobët, në përgjithësi, ndërmjet minstrave dhe zëvendësve të grupit tjetër etnik. Zyrtarët ndërkombëtarë thonë se disa zëvendës të BDI-së ngurojnë të kërkojnë prej ministrave të tyre. Në një rast tjetër, siç është ministria e ekonomisë, është ministri maqedonas ai që është gabim.

Eksepertët për zhvllimin e partive thonë se BDI-ja ka strukturë vetëm në letër. Ajo sillet kryesisht përreth Ahmetit, dhe drejtohet prej tij dhe një grupi të vogël. Ka një përçarje të fortë ndërmjet ish-komandantëve të UÇK-së dhe intelekualëve e politikanëve të cilët kanë zënë shumë Pozita kyçe. Ahmeti e ka vështirë ta kontrollojë ndarjen rajonale dhe frakcionet. Falë ndihmës intensive të Institutit Nacional Demokratik (NDI), ai megjithatë, është më i kapshëm për mediat, sidomos televizioni dhe partia e tij tani është duke e zhvilluar strukturën partiake në terren që i nevojitet aq shumë.

---

[171] "Fenomeni Xhaferi", *Aktuel*, 28 shkurt, f. 17. Shih "Forza në zbatimin e Marrëveshjes Kornizë" *Zum* revista, 28 shkurt, f 12. Dhe, "BDI nuk mundet të jetë vetëm dekor në qeveri", *Utrinski Vesnki*, 18-19 janar 2003. Të gjithë artikujt theksojnë se zbatimi i ngadalshëm i Ohrit i jep hapsirë humbësve politik, kriminelëve, dhe ekstremistëve për destablizim të vendit. E përditshmja me tirazh më të madh në vend, *Dnevnik,* e mban e qasjen e vijës së fortë që e thekson ndikimin negative të Ohrit dhe gjendjen e rendë të maqedonasve. Nënkryetari i BDI-së Agron Buxhaku, e citon interpretimin "patriotik" të disa krijuesve të opinionit për përjetësimin e përshtypjes se "Shqiptarët po fitojnë tepër shumë të drejta". "Treni për Evropë nuk guxon të niset pa ne", Agron Buxhaku, *Utrinski Vesnik*, 7 mars 2003.

[172] Ish prefekti i mirënjohur i Gostivarit Rufi Osmani, e shploi BDI-në në një intervistë për *Zëri*-n për atë se është passive dhe i lejon maqedonasit në mënyrë konzistente ta bllokojnë emërimin dhe punësimin, madje në nivele të ulëta, për jotransparencë partiake në procesin e emërimeve; mungesë e programit të qartë politik; kyçja e dobët në përgaditjen e buxhetit për vitin 2003 që nuk ka rezervuar fonde të mjaftueshme për zbatimin e Ohrit dhe pranimin e kompromiseve poshtëruese rreth çështjeve të simboleve. Revista Kosovare *Zëri java e* 28 prill 2003.

[173] Dështimi i Ahmetit ta mbështesë Ramiz Abdylin, kur ai ishte rektor i përkohshëm Universitetit të Tetovës, dhe administrata e tanishme e këtij institucioni kundër Sulejmanit dhe "Komandant Bacit" ka qenë një gabim i shtrenjtë. Dyshi Sulejmani-"Baci" u kritikua ashpër nga zyrtarët ndërkombëtarë për nxitjen e marrjes së një ndertese në Tetovë nga ana e studentëve në mënyrë agresive. Zyrtarët ndërkombëtarë me sa duket me vonesë kanë mësuar se nuk do të ketë përparim në Universitetin e Tetovës përderisa Sulejmani mban ndikimin e tij. Shih komentet e of OSBE-së në "Rrezikim i legalizimit të Universitetit të Tetovës", cituar në *Ditari i Shkopit*, 14 tetor 2003.

## G. KËRCËNIMI PREJ XHAFERIT AND THAÇIT

Më 18 dhe 19 prill 2003, liderët e dy partive më të mëdha opozitare, Arben Xhaferi dhe Menduh Thaçi të Partisë Demokratike Shqiptare (PDSh) dhe ish-Kryeministri Georgievski i partisë maqedonase VMRO-DMPNE e sulmuan drejtëprderjtë marrëveshjen e Ohrit. Ata e shpallën marrëveshjen "të vdekur" dhe përkrahën ndarjen e vendit.[174] PDSh gjithashtu shpalli bojkot të pjesëmarrjes në parlament.[175]

Ishte e qartë se këto aktrime ishin të kalkuluara për të shpëtuar krenarinë e "humbësve" politik, sepse secili prej tyre qe mposhtur prej rivalëve të tyre, paten rezultate të dobëta në zgjedhjet e vitit 2002, të njollosur me akuza për korrupcion dhe shpallën dorëheqjet e tyre prej posteve partiake (edhepse vetëm Georgievski është larguar formalisht).[176] Vrulli i retorikës dhe sfidimi i drejtëpërdrejtë i një marrëveshjeje paqësore e arritur me ndërmjetësim ndërkombëtar është pothuaj i pashembullt në rajon. Sidoqoftë, reakcioni ndërkombëtar ishte i butë (vakët). Derisa liderët maqedonas e kundërshtuan ashpër, në një deklaratë të përbashkët të UE-së, SHBA-ve, NATO-s dhe OSBE-së thjeshtë vetëm u shtua një vërejtje lakonike për "skenaret alternative që e komplikojnë rrugën për në Bruksel".[177]

Zyrtarët ndërkombëtarë vazhdojnë të sillen rreth Xhaferit. Një muaji para sulmit të tij mbi marrëveshjen e Ohrit, Ambasadori i SHBA-ve Batler, në mënyrë efektive e çliroi PDSh-në nga përgjegjësia për përzierje me Armatën Kombëtare Shqiptare kriminele.[178] Pas deklaratës "Ohri është i vdekur", i dërguari i posaçëm i Unionit Evropian Bruns e ka ndjekur Xhaferin për t'u takuar me të dhe shërbeu si apologjet a tij, duke a bartur publikisht përgënjeshtrimin e tij për përgjegjësinë e PDSh-së.[179] Atëherë u citua edhe Batler të ketë thënë "ne nuk dyshojmë në mbështetjen e PDSh-së për procesin e zbatimit të marrëveshjes së Ohrit".[180]

Duke u ballafaquar me reagimin e dobët diplomatik Xhaferi dhe Thaçi kanë vazhduar patrembur ta promovojnë porosinë e tyre për ndarje. Në një intervistë për gazetën e Tiranës *Korrieri*, Xhaferi kategorikisht ka deklaruar se "zgjidhja e vetme për ta

---

[174] Arben Xhaferi prej atëherë ka tentuar, jobindshëm, ta largojë asocimin personal me deklaratën se "Ohri është i vdekur". Artikulli i tij në *Fakti* përmban shumë mendime të ngjashme, duke përfshi edhe shprehjen e qartë se shtetet multietnike nuk mund të funkcionojnë. Për më tepër, kjo është hera e dytë që PDSh dhe VMRO DPMNE janë tërhequr nga procesi i zbatimit të Ohrit.

[175] PDSH-ja gjithashtu ka kërkuar që Maqedonia të bëhet "protektorat". Derisa Xhaferi më vonë pohonte se ai asnjëherë s'ka thënë se Ohri ishte "i vdekur", entuziazmi i PDSH-së ishte i tillë saqë u dha instrukcione deputetëve të vet të mungojnë nga votimi për dërgimin e trupave nga Maqedonia në Irakun e pas-konfliktit. Koment i nxjerrë nga Ambasadori i SHBA-ve, pasiqë shqiptarët rallë lëshojnë rastin për ta shprehë mbështetjen për amerikanët qpë shifen si mirëbërsit e tyre.

[176] Nuk është e qartë vallë Georgievski, Xhaferi dhe Thaçi në fakt do ë largohen nga skena politike. Me dyshimin e prhapur se PDSh-ja ka lidhje me AKSh-në dhe me kriminet të rrezikshëm të organizuar, rekacioni i butë ndërkombëtar është më befasuesi.

[177] I dërguari special i NATO-s ka bërë vërejtje më të ashpra. Për dallim nga shumica e diplomatëve, LSDM-ja dhe PLD-ja lëshuan nnjë kundërshtim të ashpër për sfidën e përbashkët rreth Marrëveshjes së Ohrit. Kryemninistri Cërvenkovski deklaroi se koncepti për ndryshimin e kufijve dhe shkëmbimin e popullates është një "thirje e drejtpërdrejtë për luftë etnike dhe ndarje të vendit" Shih "Ndryshimi i kufijve është thirrje e drejtëpërdrejtë për luftë etnike" MIA, 21 prill 2003. Georgievski dhe Xhaferi refuzuan një orvatje të qartë të Ambasadorit të SHBA-ve t'i takojë ata. Një muaj para iniciativës, ai e quajti Georgievskin "shoku im i mirë". Kryesuesi i misionit të OSBE-së gjithashtu bëri vërejtje intriguese me ngjalljen e sulmeve ndaj Ohrit. Shih "Intervista me Ambasadorin e SHBA-ve Lorens Batler", *Aktuel*, 7 mars 2003.

[178] Intervista me Ambasadorin e SHBA-ve Lorens Batler", *Aktuel*, 7 mars 2003. Batler e ka quajtur Xhaferin "shumë intelegjent" dhe implikon se poqese ne do të ishim të kyçur në AKSH, organizata do të funsiononte më mirë.

[179] Në një intervistë shtypi, Bruns ishte pyetur"a u sqaroi [Xhaferi] çfarë kishte ndër mend kur ai tha se "Marrëveshja Kornizë është e vdekur"? Bruns është përgjigjur: "Ai tha se bëhej fjalë për një keqinterpretim nga mediat dhe sqaroi se ai asnjëherë nuk ka thënë se marrëveshja kornizë është e vdekur" shih "Intervistë: Aleksis Bruns, i Dërguari i posaçëm i UE", *Dnevnik*, 26-28 prill 2003.

[180] Batleri qe cituar gjithashtu të ketë thënë se "[pasiqë] ata nuk marrin pjesë [në parlament për shkak të moratoriumit], është shumë rëndë për to të ndikojnë mbi procesin". *Ditari i Shkupit*, 30 maj 2003. Sa i përket përkrahjes për ndarjen- një fyerje direkte Ohrit dhe tërë procesit paqësor në rajon – Batler tha "Nuk do të tërheqje të re të kufijve, dhe unë jam i dëshpëruar që dikush në vitin 2003 po inicion një gjë të tillë. Ne ia bëmë qartë këtë Xhaferit dhe Georgievskit dhe mendoj se të gjithë tjerët në vend shohin një perspektive tjetër. "Bater ua tërheq vërejtjen Georgievskit dhe Xhaferit për ambiciet kartografike", *Ditari i Shkupit* 7 qershor 2003. Sidoqoftë, Xhaferi përsëri u citua se e përkrah ndarjen, herën e fundit në kontekst të Kosovës: "Nëse serbët e Kosovës e fitojnë të drejtën për vetvendosje ose të shkëputin një pjesë të krahinës dhe t'i bashkangjiten Serbisë, atëherë shqiptarët në Maqedoni dhe në Serbinë jugore do të duhej ta kenë të drejtën e njejtë". Shih storien e MIA "Xhaferi: nëse serbët shkëputin pajesë të Kosovës, shqiptarët duhet ta kenë të drejtën e njejtë [në Maqedoni]".

plotësuar zbraztirën gjeo-strategjike të Ballkanit pas shpartallimit të Perandorisë Otomane dhe asaj Austro-Hungareze janë shtetet (një)etnike"[181] Thaçi ia ka shtuar një mbrojtje kërcënuese: "i përkujtojmë të gjithë ata që premtuan se (Ohri do të zbatohet) deri në shkurt 2004, dhe poqese kjo nuk plotësohet, PDSh-ja do të fillojë aktivitetet drejt zgjedhjes përfundimtare të çështjes shqiptare" (dmth. ndarje dhe "Shqipëria e Madhe").[182]

Sankcionet e mundshme për këso lloj deklaratash ekstremiste janë të pakta por mund të jenë efikase. SHBA-të do të duhej që formalisht t'ia tërheqin vërejtjen kryetarit të PDSh-së, zëvendës kryetarit të PDSh-së Thaçit dhe kryetarit të PDP-së Bexhetit dhe të tjerëve se vazhdimi i mbështetjes publike për ndarje etnike, kundërshtimi i marrëveshjes së Ohrit dhe shoqërimi privat me kriminelët dhe ekstremistët do të rezultojë me futje të shpejtë në listën e saj të vëzhgimit.[183] Grupet politike evropiane do të duhej t'i përjashtojnë politikanët dhe partitë e kyçura në retorikë ekstremiste nga aleancat e tyre në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ku delegatët e PDSh-së dhe VMRO-së janë të ulur tani me grupin e qendrës së djathtë të Demokratëve Evropian dhe tjetërkund.

## H. NIKOLLA GRUEVSKI DHE VMRO-DPMNE "ERE"

Për dallim nga PDSh-ja që ka lëvizur edhe në krahun radikal të spektrit, pasardhësi i Georgievskit, Nikolla Gruevski, me mençuri ka ndërmarrë hapa të shpejtë për kthimin e partisë së tij në qendër. Ditën kur ai u zgjodh për kryetar partie (25 maj 2003), ai u përqëndrua në çështjen kryesore në kokën e shumicës së votuesve- ekonominë- dhe nuk nguli këmbë në qasjen konfrontuese të Georgievskit ndaj komunitetit ndërkombëtar. Duke bërë thirrje për integrim sa më të shpejtë në UE dhe NATO, ai gjithashtu u distancua nga propozimi i Georgievskit për ndarje etnike dhe shkëmbim të territoreve. Sidoqoftë, burim brënda VMRO-DPMNE-së tërheq vërejtjen se për çështjet siç janë pavarësia e Kosovës deri te zbatimi i Ohrit, zëri i Georgievskit do të vazhdojë të dëgjohet nëpërmjet Gruevskit megjithëse kjo do të bëhet brënda këshillave partiakë. Edhepse Gruevski dhe shokët e tij, përfshirë edhe Sekretarin e përgjithshëm Den Donçev, insistojnë se ata janë të pavarur nga Georgievski, burimi partiak thotë se vazhdimi i ndikimit të ish kryeministrit është i siguruar pasiqë ai i kontrollon financat e partisë.

[181] "Xhaferi: ja pse Macedonia duhet të ndahet", *Fakti*, cituar në *Ditari i Shkupit*, 26 maj 2003. Xhaferi më tepër se një herë ia ka përçuar të njejtin qëndrim GNK-së, si edhe vlerësimin thumbues për "Sllavët". Qasja e tij ndaj historisë duket sikur ndalet rreth njëqind vite më parë me rënien e Perandorisë Otomane dhe i injoron zhvillimet ndërkohë.

[182] "PDSh-ja don të drejtën për vetvendosje të shqiptarëve në Maqedoni", *Fakti* cituar në *Ditari i Shkupit*, 8 qershor 2003.

[183] Lista e vLista e vzhgimit (e zezë) doli nga Vendimi Egzakutiv 13219 i 27 Qeshorit 2001 me të cilën Kryetari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës kërkoi nga Ministria e Finansave t të Bashkuara të Amerikës kërkoi nga Ministria e Finansave t blokojn blokojnë pronë pronsinsinë e personave të cilët "kërcënojnë tentimet ndërkombëtare për stabilizim në Bllkanin Perëndimor". Në 29 Maj 2003, Vendimi Egzekutiv u revidua dhe një numër të ish udhëheqësve të UXK-së u larguan nga kjo listë, përfshirë këtu zyrtarët e lartë të BDI-së Ali Ahmeti "që prej atëherë ka mohuar terrorizmin dhe është bashkuar në koalicionin qeveritar", "Xështjet kryesore: Vendimi i Ri Egzekutiv lidhur me Ballkanin", Konferenca për shtyp e Konzulatës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, 30 Maj 2003.

# VII. PËRFUNDIM

Fuqitë Evropiane, në shekullin e njëzet, e filluan angazhimin e tyre në Ballkan me tentimet e tyre ta stabilizojnë gjendjen e sigurisë në provincën Otomane të Maqedonisë duke bërë reforma të policisë që kulminoi në vitin 1903 me marrëveshjen e Mürzsteg-ut ndërmjet Austrisë dhe Rusisë. Elementi më i rendësishëm i krizës së parë Ballkanike në shekullin 21, konflikti i Maqedonisë i vitit 2001, edhe njëherë është shërbimi policor dhe çështja e sigurisë. Por konteksti është krejtësisht i ndryshëm; në vend se fuqitë e mëdha Evropiane të kërkojnë mënyra për ta kontrolluar rajonin dhe t'i eksploatojnë resurset natyrore, komuniteti ndërkombëtar tani dëshiron të zvillojë kapacitete vendore në Maqedoni ashtuqë ajo të mund të bëhet partner i barbartë në integrimet Evropiane. Marrëveshja e Mürzsteg-ut ishte nënshkruar ndërmjet dy ministrive të jashtme që asnjeherë s'e kishin vizituar rajonin, në pauzat e gjuetisë në një shtëpizë pushimi të Habzburgëve ndërsa zbatimi i marrëveshjes iu besua zyrtarëve impotent të perandorisë Otomane; marrëveshja e Ohrit u nënshkrua prej aktorëve vendorë, me angazhim intenziv të zyrtarëve të UE-së dhe SHBA-ve në terren, edhepse ndoshta ka mundur të bëhet më tepër, komuniteti ndërkombëtar ka qenë së paku tërë kohën i pranishëm dhe i angazhuar në procesin e zbatimit.

Derisa perspektiva afatmesme ajo afatgjatë është krejtësisht e ndryhsme prej vitit 1903, problemi afatshkurt i krizës së mundshme ende ngel. Në mungesë të një përpekjeje më të koordinuar për zbatimin dhe pëfshirjen e vërtetë të Ohrit, për të vendosur ligjin dhe rendin, për të luftuar korrupcionin dhe stimuluar ekonominë, qetësia momentale mund të shpartallohet shpejtë. Liderët e Maqedonisë dhe komuniteti ndërkombëtar do të duhet të ballafaqohen me faktin se vendi ende ka nevojë për ndihmë në fushën e sigurisë. Misioni i sukseshëm ushtarak i UE-së "Konkordia" duhet të ngelë derisa policia e Maqedonisë të mund të kryejë operacionet e saj në mënyrë efikase dhe të jetë e aftë ta menaxhojë çdo lloj pasoje politike nga këto operacione. UE-ja duhet gjithashtu të dërgojë mission policor për ndihmë, i disenjuar ashtuqë të merret me mungesat kyçe siç është shkëmbim i pamjaftueshëm i informacioneve zbuluese, komunikimi dhe koordinimi.

Nuk ka alternative reale për Ohrin. Ndarja është me siguri e padëshiruar. Përfundimisht nuk ka konsensus rreth asaj ku do të tërhiqeshin kufijtë e rinj dhe një process i tillë pothuaj me siguri do të hapte rrethin ri të konfliktit. Çdo ndarje e Maqedonisë me shqiptarët do të hapte konflikt mes maqedonasve dhe fqinjëve të tyre sipas të cilës në drejtim të lindjes - Bullgaria ose në veri - jug Serbia dhe Greqia - Shkup do ta aporovonin. Investimi më i mirë i mundshëm për stabilitetin e vendit dhe të rajonit që mund ta bëjë komuniteti ndërkombëtar ngel mbështetja për shtetin e Maqedonisë brënda kufijve të tanishëm ashtuqë të mund të jetë partner i barbartë me fqinjët e saj.

**Shkup/ Bruksel, 23 tetor 2003**

# ANEKSI A:

# KRONOLOGJIA E INCIDENTEVE MË TË MËDHA TË FUNDIT NË FUSHËN E SIGURISË

*25 Dhjetor 2002.* Një bombë e fuqishme shpërthen para një shkolle të mesme në Kumanovë, ku kryesisht mësojnë maqedonas, me çrast u vra një kalimtar rasti. Një vonesë fatlume e lëshimit të nxënësve nga mësimi shpëtoi shumë të tjerë.

*22-23 Janar 2003.* Paramilitarët e armatosur "Luanët" bllokojnë vendkalimin kryesor kufitar për në Kosovë. Ministri i Brëndshëm Kostov dërgoi një njësit special rival "Tigrat" dhe konfrontimi u zbut vetëm pas takimeve të nivelit të lartë ndërmjet përfaqësuesve të Luanëve, kryetarit, kryeministrit dhe ministrit të brëndshëm. Pas kundërshtimit të Kostovit, marrëveshja lejon që rreth 600 Luaj të mbahen në ministrinë e brëndshme dhe të mbrojtjes, sipas kushteve të miratuara, me çka zvogëlohet aftësia e qeverisë t'i plotësojë qëllimet e Ohrit për punësim të shqiptarëve në qeveri.

*24 Janar 2003.* Tre prostituta të huaja u vranë, një shqiptar u plagos ndërsa një tjetër u vra gjatë gjuajtjes me armë në një bordel-café në Dobri Dol, duke nxjerr në pah dhunën e nëntokës kriminele të kyçur në trafikimin me gra. Zyrtarët gjyqësorë janë turpëruar meqë të dyshimtit kryesor janë liruar menjëherë.[184]

*8 Shkurt 2003.* Krimineli i njohur Dilaver Bojku, u kap në një akcion të policisë multietnike, akcion në të cilin zëvendës ministri i brëndshëm Fatmir Dehari, një komandant i ish-UÇK-së, luajti rolin kryesor.

*14 Shkurt 2003.* Një bombë e fuqishme e qëllon ndërtesën e gjyqit në Strugë, afër vendit ku mbahet Bojku.[2] Çuditërisht, nuk është lëshuar fletarrest për organizatorin e mundshëm. Bojku është dënuar me vetëm gjashtë muaj burg pas një gjykimi, që më tepër i ngjante cirkusit, gjykimi ky i karakterizuar me kërcënim të dëshmitarëve kryesorë dhe largimin e vëzhguesve të OSBE-së.

*4 Mars 2003.* Dy pjestarë Polak të forcave të sigurisë së NATO-s "Harmonia Aleate" dhe dy civilë u vranë nga një mine e re në fshatin Sopot, me sa duket qëllim kanë qenë patrullat e armatës së Maqedonisë që kalojnë nëpër atë rrugë.

[184] Ministri i brëndshëm Kostov menjëherë e parashtroi çështjen e lirimit të të akuzuarve para Këshillit Gjyqësor Republikan, mbikqyrja e shtetit mbi kësjhillin e gjykatës.

*17 Mars 2003.* Një bombë shpërthen në vijën hekurudhore ndërmjet fshatrave shqiptare Tabanoc dhe Vaksincë, afër kufirit Serb, pak kohë pasi ka kaluar një tren. Një i akuzuar sipas raporteve ka pranuar se eksplozivin e ka blerë në Shqipëri.

*26 Mars 2003.* Forcat shqiptare dhe maqedonase zhvillojnë ushtrim të përbashkët si pjesë e Manovrave *Përpjekja e fqinjëve 2003* në Krivolak vendtrajnim në Maqedoni nën Partneriteti për Paqe të NATO-s, por mediumet shumë pak e mbuluan këtë ngjarje.

*31 Mars 2003.* "Operacioni Konkordia" i EUFOR-it e merr prej NATO-s një angazhim gjashtëmujor që është angazhimi i parë ushtarak i UE-së. I udhëhequr prej Francës, me vendosmëri po e kapërcen përshtypjen e shqiptarëve për largimin e NATO-s.

*18-19 Prill 2003.* Georgievski dhe Xhaferi, liderë të partive kyçe opozitare, në të vërtetë e tërhoqën mbështetjen e tyre për marrëveshjen e Ohrit dhe haptas kërkuan ndarjen e Maqedonisë. PDSh-ja e Xhaferit shpalli "moratorium" të aktiviteteve politike dhe një zyrtar ndërkombëtar i lartë për çështje të sigurisë vërejti se ky apel i maskuar dobët për dhunë është i përcjellur me një rritje të shpejtë të aktiviteteve ekstremiste.[185]

*5 Maj* 2003 Ministrat e Jashtëm të Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë, të shoqëruar nga Sekretari i Shtetit të SHBA-ve, Pauell, e nënshkruajnë "Kartën e Adriatikut". Ministresha e jashtme e quan nënshkrimin e SHBA-ve "garancë" për sigurinë e Ballkanit.

*10 Maj 2003.* Fshatarët shqiptarë afër Vicës dhe Sellcës (rajoni i Tetovës) të nxitur nga një ish-komandantë të rebeluar të UÇK-së, e bllokuan një delegacion maqedonas të kryesuar nga ministri i brëndshëm Kostov dhe i shoqëruar nga ambasadori i SHBA-ve Batler që të shkojë për një ceremoni komemorative me rastin e pusie kundër forcave maqedonase të sigurisë në vitin 2002.[3] Fshatarët të dëshpëruar me mospërparim e Ohrit, refuzojnë apelet e zyrtarëve të lartë të BDI-së për ta ndërpre bllokadën, gjë që i tërbon maqedonasit. Kishte zëra

[185] Intervistë e GNK-së me zyrtar të lartë ndërkombëtar për çështje të sigurisë.

se tankset ishin ndezur në kazermën e afërme dhe një helikopter fluturoi përmbi, me çka e ngritën tensionet.

*16 May 2003.* Pas ndërmejtësimit delegacioni e viziton Vicën. Trazirat shpërthejnë në afërsi, në Tetovë, kur granata hudhen në një kazermë të armatës dhe një patrullë policore sulmohet. Të rinj shqiptarë dhe maqedonas përleshen në qendër të Tetovës dhe dy shqiptarë plagosen me armë zjarri.

*Mes i Majit 2003.* Ministria e brëndshme konfirmon dhjetë kidnapime në periudhën mars-prill, përkujtues për problemine e pazgjidhur të kriminalitetit të organizuar.[186] Një gazetar lëshon supozimin për lidhje me të mirënjohurin "Klan të Zemunit" në Beograd.

*15 Maj 2003.* 180 nxënës shqiptarë, të shoqëruar nga policia dhe përfaqësues ndërkombëtar u kthyen prapa nga një shkollë e mesme në Kumanovë.

*19 Maj 2003.* Të shqetësuar nga incidenti shkollor, më se 1000 shqiptarë e bllokuan rrugën kryesore për në Kumanovë duke shprehur armiqisinë etnike të hidhur që daton nga viti 2001 dhe e kanë kundërshtuar ndërmjetësimin e OSBE-së. U arrit një marrëveshje por zëvendës ministri i brëndshëm e pranon se është vetëm një masë e përkohshme.

